



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

i mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 30.3.2026, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina (Lidhja e Prishtinës) - kryesues i Kuvendit, Bujar Gashi (LDK), Bekim Gashi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Fadil Aliu (LDK), Egzon Pacolli (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Etnik Mustafa (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Dhurata Jahaj- Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi-Osmani (LDK), Rifadije Sopi (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Agron Canolli (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Ilirik Musliu (PDK), Yll Muriqi (PDK), Granit Geci (PDK), Florian Beka (PDK), Kumrije Shabani- Ramadani (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fjolla Vukshinaj- Reçica (PDK), Trim Sylja (PDK), Mrika Limani- Myrtaj (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Jeta Dida- Bujari (LVV), Berita Abazi- Muhadri (LVV), Çlirim Gërbeshi (LVV), Feim Osmani (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Nexhmije Gjema (LVV), Lumniqe Mikullovc (LVV), Leonora Shabani- Bajraktari (LVV), Enver Redenica (LVV), Kreshnik Smajlaj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Erblina Tahiraj (AAK), Yll Bogaj (AAK), Betim Abdullahu (Lidhja e Prishtinës), Arbentia Murseli- Haxholli (Lidhja e Prishtinës), Teuta Kadiu- Gjinolli (Lidhja e Prishtinës), Besa Shahini (PSD), Endrit Zabërgja (NISMA), Jeton Mehmeti (GUXO), Valbona Ajeti (AAK).

Munguan: Amir Simnica (LDK), Besianë Musmurati (PDK), Plator Gërdovci (PDK).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama – Kryetar i Kryeqytetit, Shkëmb Manaj - nënkryetar i Komunës, Valbona Makolli - drejtore e Drejtorisë së Financave, Arbër Sadiki - drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Florent Maliqi – drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit, Gëzim Kastrati - drejtor i Drejtorisë së Transformimit, Luftar Braha - drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Brahim Mehmetaj - drejtor i Drejtorisë së Pronës, Izet Sadiku - drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Donat Lushaku – drejtor i Drejtorisë së Mobilitetit, Sokol Havolli - drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale, Adelina Sahiti - drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Rrezarta Aliu – drejtore e Drejtorisë së Turizimit, Driton Bardheci- drejtor i Drejtorisë së Administratës, Donat Gashi – drejtor i Drejtorisë së Rinisë, Bekim Brestovci - drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, Kushtrim Mushica - drejtor i Drejtorisë së Sportit, përfaqësues të OSBE-së dhe të mediave.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina kryesues i Kuvendit, ku pas verifikimit të pjesëmarrjes, u konstatua se janë të pranishëm 44 anëtarë, duke siguruar kuorumin e nevojshëm për mbajtjen e mbledhjes, kryesuesi i nftoti për një ndryshim në përbërjen e Kuvendit, ku z. Sokol Havolli nuk është më anëtar për shkak të emërimit në pozitë drejtuese në Komunë. Në vend të tij,

mandatin e asamblistit e merr z. Pëllumb Bajçinovci nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, ku në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, dha betimin solemn dhe zyrtarisht mori detyrën si anëtar i Kuvendit të Komunës.

Kryesusi vazhdon mbledhjen me këtë:

Rend dite:

1. Propozim vendimi për miratimin paraprak të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026.

Brahim Mehmetaj: – drejtor i Drejtorisë së Pronës, prezantoi listën e përditësuar të veçantë për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme komunale, në përputhje me Ligjin nr. 06/L-092 dhe rekomandimet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Ai njoftoi se, lista fillestare ishte kthyer për plotësim për shkak të mungesës së disa të dhënave thelbësore, si destinimi dhe afati i shfrytëzimit. Pas rishikimit të plotë, lista tash përfshin të gjitha elementet e nevojshme, duke përfshirë afatin e shfrytëzimit, të dhënat kadastrale dhe destinimin për secilën pronë. Numri i përgjithshëm i pronave në listën e përditësuar është 3,632. Drejtori kërkoi miratimin e listës, duke theksuar se ajo kontribuon në zhvillim ekonomik, rritjen e të hyrave komunale, krijimin e vendeve të punës dhe menaxhimin më efikas të pronës publike, duke garantuar transparencë dhe përputhje me legjislacionin në fuqi.

Egzon Pacolli: - tha se miratimi i listës së pronave komunale për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026, paraqet një mundësi të rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe urban të Prishtinës. Ai theksoi se aktivizimi i këtyre pronave ndikon në rritjen e investimeve, hapjen e vendeve të reja të punës dhe rritjen e aktivitetit ekonomik, gjithashtu nënvizoi se shfrytëzimi i pronave duhet të bëhet në mënyrë efikase, transparente dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar interesin publik. Pacolli në emër të grupit të asamblistëve të LDK-së, bëri thirrje për miratimin e kësaj liste si një hap drejt një zhvillimi më të qëndrueshëm dhe përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve.

Leutrim Retkoceri:- theksoi se PDK-ja do të vazhdojë të mbështesë proceset që janë në interes të zhvillimit ekonomik dhe publik të Komunës, duke mos u bërë pengesë për iniciativa të tilla. Ai nënvizoi rëndësinë që lista e pronave për dhënien në shfrytëzim të jetë në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe rekomandimet e MAPL-së, duke përfshirë të dhënat kadastrale, destinimin, afatet dhe procedurat e publikimit. Retkoceri konfirmoi mbështetjen për këtë proces, duke theksuar nevojën për transparencë, respektim të ligjit dhe mbrojtje të interesit publik në çdo fazë të zbatimit.

Nora Kelmendi:- paraqiti vërejtje dhe kritika lidhur me listën e veçantë të pronave komunale për dhënie në shfrytëzim, duke theksuar se mangësitë e evidentuara më herët janë konfirmuar edhe nga kthimi i listës nga MAPL. Ajo nënvizoi se dokumentacioni ende nuk është në përputhje të plotë me Ligjin nr. 06/L-092, për shkak të mungesës së të dhënave thelbësore si qëllimi, interesi publik, afati i shfrytëzimit dhe mospërputhje në të dhënat kadastrale dhe certifikatat e pronës, gjithashtu, ajo evidentoi një numër të madh parregullsish dhe mungesash në lista, duke vënë në dyshim transparencën dhe saktësinë e procesit. Nora theksoi nevojën që dokumentacioni të jetë i

plotë, i saktë dhe në përputhje me ligjin, në mënyrë që të sigurohet një proces transparent dhe në interes të qytetarëve.

Betim Abdullahu:- theksoi se Lidhja e Prishtinës sikurse herën e kaluar e përkrah propozimin për miratimin e planifikuar të listës së veçantë të pronave.

Besa Shahini: - shprehu shqetësime serioze lidhur me listën e pronave komunale për dhënie në shfrytëzim, duke theksuar se dokumentacioni përmban paqartësi dhe mangësi që pamundësojnë votimin e saj në këtë fazë. Ajo ngriti çështje konkrete, si parcelat me ndërtime ekzistuese, mungesa e planeve hapësinore për prona të mëdha, përfshirja e zonave të mbrojtura dhe të gjelbërta, si dhe paqartësitë lidhur me destinimin dhe përfitimin ekonomik të pronave, gjithashtu, theksoi se sipas dispozitave ligjore, kjo listë ka pasoja të rëndësishme vendimmarrëse dhe nuk është vetëm një hap formal, ndërsa mungon edhe raportimi për zbatimin e rekomandimeve të auditorit. Besa vlerësoi se, përkundër rëndësisë së shfrytëzimit të pronës komunale, lista aktuale nuk është e gatshme për miratim për shkak të mungesës së qartësisë dhe transparencës.

Endrit Zabërgja:- theksoi se dhënia në shfrytëzim e pronave të kryeqytetit është një proces i rëndësishëm që duhet të bazohet në parimin se këto prona u përkasin qytetarëve. Ai nënvizoi nevojën që ky proces të zhvillohet në mënyrë transparente dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke theksuar edhe rolin mbikëqyrës të Kuvendit gjithashtu ai konfirmoi mbështetjen për listën e propozuar, duke ritheksuar qëndrimin pozitiv të tij.

Jeton Mehmeti:- theksoi se edhe pse lista aktuale e pronave për dhënie në shfrytëzim ka përmirësime krahasuar me versionin e dhjetorit, ende mungojnë disa elemente bazë ligjore dhe ka ngecje në proces. Ai nënvizoi rëndësinë e respektimit të ligjit dhe të bazës ligjore për çdo vendim të asamblesë, duke theksuar se dokumentacioni duhet të jetë i plotë dhe i saktë për të shmangur kthime nga institucionet përkatëse, duke pasur parasysh interesin e komunës dhe të qytetarëve për aktivizimin e pronave dhe përfitimin ekonomik. Mehmeti theksoi se mbështet listën në këtë fazë, me pritshmëri që detajet e nevojshme do të saktësohen në votimet e ardhshme.

Nexhmije Gjema:- theksoi se dhënia e pronave komunale për periudha shumë të gjata, deri në 99 vjet, kërkon transparencë dhe siguri të lartë juridike. Ajo evidentoi mungesë përputhshmërie dhe verifikueshmërie ndërmjet listave të parcelave, kopjeve të planeve dhe certifikatave të pronësisë, si dhe dokumentacion të paplotë dhe të pa përditësuar. Për shkak të këtyre mangësive dhe rreziqeve për menaxhimin afatgjatë të pronës komunale, ajo nuk mund të mbështesë miratimin e vendimit.

Feim Osmani:- theksoi se megjithëse dokumentacioni për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale ishte përmirësuar deri diku pas vërejtjeve dhe ankesave të mëparshme, materiali mbetet i gjatë, i pafiltruar dhe i pamundur për t'u analizuar në mënyrë të plotë brenda kohës së shkurtër që i ishte dhënë asamblesë. Ai vuri në dukje se lista përfshin prona të ndryshme, përfshirë edhe sipërfaqe pyjore dhe gjelbërime, për të cilat nuk është e qartë se cili do të ishte destinimi ose ndikimi në zhvillimin e komuniteteve. Osmani theksoi mungesën e planifikimit afatmesëm dhe afatgjatë për zhvillimin e lagjeve dhe fshatrave të kryeqytetit, duke vënë në dukje se dhënia në shfrytëzim e pronave për periudha deri në 99 vite, pa selektim të kujdesshëm, mund të çojë në tjetërsimin e pronës publike dhe të pengojë realizimin e projekteve të rëndësishme për komunitetin, si parqe, shkolla, çerdhe, spitale apo objekte të tjera publike. Ai kritikoi gjithashtu mungesën e

analizës për përfitimin ekonomik specifik të secilës pronë dhe rrezikun që zyrtarët të keqpërdorin pronën publike pas miratimit të listës. Osmani theksoi se vetëm pronat që nuk i shërbejnë interesit publik dhe nuk parashikohen për nevojat e komunitetit në planifikim afatmesëm duhet të dalin në listën për dhënie në shfrytëzim. Ai bëri thirrje që të ndalet nisma aktuale përpara publikimit të listës dhe të realizohet një planifikim i detajuar i zhvillimit të qytetit, në mënyrë që të ruhet pronësia publike dhe të garantohen hapësira të mjaftueshme për nevojat e ardhshme të qytetarëve të Prishtinës.

Enver Redenica:- vuri në dukje se lista e pronave komunale për shfrytëzim në vitin 2026 ka paqartësi dhe devijime të mëdha nga realiteti në terren, duke ngjallur dyshime për keqpërdorime dhe favore për interesa private. Ai përmendi shembuj konkretë si parcela të uzurpuara në Sofali dhe Velani, hapësira në Gërmi pjesë e parkut, si dhe projekte të premtuara për kënde lojrash dhe hapësira publike që mund të anashkalohe për interesa të tjera. Redenica theksoi se këto probleme nuk janë gabime teknike, por shqetësime serioze që rrezikojnë besimin e qytetarëve në institucionet komunale dhe për këtë arsye, ai nuk mund të mbështesë vendimin dhe kërkoi që lista të tërhiqet, të rishikohet dhe të rikthehet vetëm kur të jetë e saktë, transparente dhe në shërbim të interesit publik.

Çlirim Gërbeshi:- shpreh shqetësim për menaxhimin e pronave publike të Kryeqytetit, duke kritikuar procedurat e nxituara dhe mungesën e transparencës. Ai vë në dukje refuzimet e kryetarit për të dhënë parcela për banesa për çifte të reja, qendra sportive dhe Stadiumin kombëtar, duke akuzuar për përfitime të grupeve të ngushta biznesore. Gërbeshi kërkon që prona publike të ruhen dhe përdoren për parqe, qendra kulturore, rinore dhe sportive, dhe thekson nevojën për një komision të pavarur për vlerësimin e pronave për të garantuar transparencë dhe interes publik.

Gëzim Sveçla:- thekson se lista aktuale për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale të Prishtinës, që përfshin mbi 3,500 prona, nuk plotëson kriteret ligjore dhe nuk ka një orientim zhvillimor të qartë. Ai kritikon mungesën e objektivave të matshme, planifikimit sektorial dhe vizionit strategjik, duke vënë në dyshim pse janë përfshirë të gjitha pronat në zonat kadastrale, kur në praktikë vetëm një numër i vogël mund të jepet në shfrytëzim gjatë vitit. Sveçla argumenton se prona komunale është aset i rëndësishëm që duhet të menaxhohet për të sjellë zhvillim, të hyra dhe përfitim për qytetarët, dhe se dhënia e pronave duhet të shërbejë interesit publik, jo për interesa të veçanta ose grupe të ngushta. Ai kritikon procedurat e nxituara dhe vazhdimësinë e qeverisjes së mëparshme, duke theksuar nevojën për transparencë dhe përgjegjësi për çdo pronë që jepet në shfrytëzim. Sveçla përfundon duke bërë thirrje që çdo dhënie e pronës komunale të jetë e justifikuar, strategjike dhe në dobi të qytetarëve, dhe jo vetëm për të plotësuar kërkesa formale ligjore, duke paralajmëruar se Lëvizja Vetëvendosje nuk mund të mbështesë një listë të tillë që nuk respekton këto parime.

Valbona Vitija-Ajeti:- shpreh përkrahjen e saj për këtë pikë, duke theksuar se menaxhimi i mirë i pronave publike është një detyrim i rëndësishëm. Ajo falenderon drejtorin e pronës dhe stafin e Drejtorisë së Pronës për punën e bërë deri tani në këtë proces.

Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për, 14 kundër, asnjë abstenim u miratua Vendimi për miratimin paraprak të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim në Vitin 2026.

Mbledhja përfundoi në orën 16:05.

**Procesmbajtësi
Skender Tora**

**Kryesues i Kuvendit
Fehmi Kupina**



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



TRANSKRIPT

**I mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më datë
30.3.2026 duke filluar në orën 15:00**

Kryesuesi: - të nderuar anëtarë të Kuvendit të Kryeqytetit, i nderuari Kryetar Rama, nënkryetarë, përfaqësues të ekzekutivit, media dhe ju të pranishëm. Të nderuar kolegë asambleistë me inicimin e Kryetarit të Kryeqytetit sot kemi thirrur mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit që përkon me miratimin paraprak të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës, që planifikohen për dhënien në shfrytëzim në vitin 2026. Ftesa për këtë mbledhje është dërguar me kohë tek të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe bashkë me të janë shpërndarë edhe materialet përkatëse për pikën e rendit të ditës përfshirë edhe dokumentet e pranura nga ekzekutivi. Para se të vazhdojmë me shqyrtimin e rendit të ditës do të bëjmë verifikimin e kuorumit, të konsatojmë se a kemi kuorum për mbajtjen e kësaj mbledhje a po jo. Lus shërbimin e Kuvendit të konstatojë kuorumin, 44. Faleminderit. Konstatoj se kemi kuorum. Pasi që është konstatuar kuorumi ne po fillojmë me mbledhjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe procedurat e përcaktuara për funksionalizimin e Kuvendit të Komunës. Ju njoftoj se kemi një ndryshim në përbërje të këtij Kuvendi. Ju informoj se z. Sokol Havolli nuk është më pjesë e Kuvendit pasi që është emëruar në pozitën e drejtorit në Komunë, në vend të tij në përbërje të Kuvendit të Komunës hyn z. Pëllumb Bajqinovci nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës i cili fiton të drejtën për ushtrimin e funksionit të asambleistit. Si mbas nenit 35, pika 35.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale çdo anëtarë i Kuvendit të Komunës para fillimit të ushtrimit të mandatit është i obliguar të jap betimin solemn si akt formal dhe juridik që konfirmon marrjen e përgjegjësisë dhe obligimeve publike. Në këtë rast ftoj z. Pëllumb Bajqinovci të ngritet në këmbë dhe të përsëris betimin solemn njkohësisht, bashkarisht si mbas tekstit zyrtar të përcaktuar me ligj. Betom se do kryej me nderë, besnikëri pa anime e me ndërgjegje dhe si mbas ligjit detyrat dhe do të ushtroj autorizimet e mija si anëtarë i Kuvendit të Komunës së Prishtinës në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë. Betohem. Konstatoj se betimi është dhënë në përputhje me dispozitat ligjore dhe procedurat përkatëse dhe se z. Pëllumb Bajqinovci nga ky moment fiton të gjitha të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga funksioni i asambleistit të Kuvendit të Komunës. Urime z. Bajqinovci. Vazhdojmë me rendin e ditës. Sot kemi vetëm një pikë të rendit të ditës.

1. Propozim vendimi për miratimin paraprak të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës fjalën ia jap drejtorit të pronës z. Brahim Mehmetaj.

Brahim Mehmetaj: - të nderuar anëtarë të Kuvendit të Kryeqytetit, i nderuar kryesues, i nderuar kryetar, të nderuar nënkryetarë, drejtorë, të dashur qytetarë të kryeqytetit. Në kuadër të procedurave ligjore për administrimin dhe dhënien në shfrytëzim të pronave komunale si dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi është rihartuar dhe proceduar lista paraprake e veçantë për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të kryeqytetit. Në bazë të Ligjit nr. 06 L 092, ku janë përcaktuar qartë obligimet dhe afatet ligjore për publikimin e listës së përgjithshme të pronave të kryeqytetit dhe për votimin dhe miratimin e listës së veçantë për dhënien në shfrytëzim. Ju njoftojmë se lista e përgjithshme e pronave të kryeqytetit është miratuar, është publikuar në faqen zyrtare me datën 19.12.2025, ndërsa lista e veçantë është votuar dhe miratuar në Kuvendin e Kryeqytetit me datë 30.12.2025. Pas shqyrtimit dhe votimit nga Kuvendi Komunal lista është kthyer nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me arsyetim se nuk është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi për shkak të mungesës së disa të dhënave thelbësore si destinimin dhe afatin e dhënies në shfrytëzim, për këtë arsye lista është rishikuar dhe përditësuar në tërësi, duke përfshirë të gjitha elementet e nevojshme si, afati i dhënies në shfrytëzim, fleta poseduese, kopjen e planit, zonën kadastrale, numrin e parcelës dhe destinimin për secilën pronë veç e veç. Për përditësimin e kësaj liste dhe për mbushjen e atyre rekomandimeve janë angazhuar dhe dua t'i falënderojë Drejtorinë e Pronës, së pari zyrtarët në Drejtorinë e Pronës edhe pse herën e parë me keqardhje janë bërë disa gabime, ju kërkujmë falje. Drejtorinë e Kadastrit me drejtorin Gent dhe Drejtorinë e Planifikimit të cilët e kanë pasur një punë të jashtëzakonshme, për shkak se është numri i madh i pronave. Pas përditësimit numri i përgjithshëm i pronave është 3632. Pasi që nga lista e larguar kategoritë të cilat nuk janë objekt i dhënies në shfrytëzim, si rrugë, varreza, institucione publike dhe hapësira të vogla që janë 10-20m². Pas korporimit të të gjitha ndryshimeve dhe plotësimeve të kërkuara nga MAPL, si dhe rekomandimet e disa anëtarëve të Kuvendit, faleminderit Nora dhe të tjerëve. Lista e veçantë është ridërguar në shqyrtim dhe miratim para jush, andaj kërkuj që kjo listë të votohet duke marrë parasysh se kontribuon në zhvillim ekonomik përmes aktivizimit të pronës komunale dhe sigurimit të shfrytëzimit efikas dhe të qëndrueshëm të saj. Gjeneron të hyra për buxhetin komunal përmes inkasimit të qirasë dhe rritjes së të hyrave të tatimit në pronë, krijon vende të reja pune, parandalon degradimin e pronës së kryeqytetit dhe rritë vlerën e saj. Për realizimin e këtij interesi publik, shfrytëzohet si mjet interesi privat, ku ne garantojmë si transparencë në vendimmarrje, konkurrencë të drejtë me përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mbështetje për zbatimin e plotë të kontratave për shfrytëzimin e drejtë të pronës komunale. Duke iu falënderuar për durimin, mirëkuptimin kërkujmë edhe njëherë që të rivitohet kjo listë e rëndësishme. Faleminderit shumë.

Kryesuesi:- faleminderit drejtor. Hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës. Shkojmë me shefat e grupeve. Nga radhët e LDK- së, Egzon Pacolli e ka fjalën.

Egzon Pacolli: - faleminderit z. kryesues. I nderuar kryesues z. Kupina, i nderuar Kryetar z. Rama, të nderuar anëtarë të asamblesë të Kryeqytetit. Miratimi i listës së pronave komunale që planifikohen të jepen për shfrytëzim për vitin 2026, përfaqëson një mundësi të qartë për zhvillim dhe progres për Prishtinën. Investimet që burojnë nga ky proces janë thelbësore për rritjen ekonomike, hapjen e vendeve të reja të punës dhe rritjen e aktivitetit ekonomik dhe

zhvillimit urban të kryqytetit tonë, si dhe për maksimalizimin e vlerës së pronës publike. Shfrytëzimi i mirëfilltë i këtyre pronave nënkupton përdorim racional, efikas dhe në funksion të interesit publik. Çdo hap drejtë aktivizimit të tyre është një hap drejtë fuqizimit të ekonomisë lokale dhe përmirësimit të shërbimeve për qytetarët. Këto prona nuk duhet të mbesin potencial i pa shfrytëzuar por duhet të kthehen në hapësira që krijojnë vlerë, inovacion dhe zhvillim të qëndrueshëm. Jam i bindur se ekzekutivi i Prishtinës në krye me Kryetarin Rama do të bëjnë një planifikim të duhur dhe do t'i paraqes asambleistët propozime që kontribuojnë në zhvillimin dhe transformimin e mëtejme të Prishtinës. Është me rëndësi të theksohet se kjo listë përfaqëson një hap planifikues në përputhje me kornizën ligjore dhe lidhet drejtëpërdrejtë me interesin publik dhe zhvillimin ekonomik të Komunës, si e tillë ajo nuk nënkupton dhënie të drejtëpërdrejtë të pronave, por krijon bazë që çdo vendim i mëtejme të trajtohen në mënyrë të rregullt dhe transparente. Përmes të investimeve të mirëmenaxhuara dhe proceseve transparente ne si asamble në bazë të prëgjegjësisive dhe kompetencave që kemi do të sigurohemi që këto resurse të kontribuojnë drejtëpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve dhe në ndërtimin e një kryeqyteti më modern dhe konkurrues, prandaj ky vendim është një hap i sigurt për një të ardhme më të zhvilluar, më dinamike dhe më të qëndrueshme për të gjithë. Me emër të grupit të asambleistëve të LDK-së, ju ftoj që ta miratojmë këtë propozim dhe t'i japim rrugë qytetarëve që të konkurojnë për të shfrytëzuar pronën publike në mënyrë të drejtë dhe në interes të Prishtinës. Faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit z. Pacolli. Nga radhët e PDK-së, Leutrim Retkoceri e ka kërkuar fjalën.

Leutrim Retkoceri: - faleminderit kryesues. Përsëendetje ekzekutivit. Përsëendetje kolegë asambleistë, të nderuar qytetarë. Partia Demokratike e Kosovës vazhdojë të qëndrojë në të drejtën e saj dhe në qëndrimin siç ka qenë herën e parë në mënyrë që të mos jemë bllokues në procese që janë të rëndësishme për Komunën, të cilët hapin rrugë interesit publik të mirë të arsyetuar, zhvillimit ekonomik, me garancën se propozuesi për ndryshimin e kësaj pike i ka prëfillë në përpikëri ato çka i kërkon ligji në dhënien e pronës në shfrytëzim dhe vlerësimin e ministrisë së pushtetit dhe administratë MAPL-së, pra që këto të dhëna të listës të kenë të dhëna kadastrale të pronës, qellimin, destnimin, datën e publikimit, njoftimit dhe kohën për dhënien në shfrytëzim në afat siç e përcakton ligji. Ne do t'i mbështesim me idenë se këto do të hapin rrugë një zhvillimit ekonomik të komunës gjithmonë duke u përmbajtur në transparencë në sjelljen dhe prezentimin e këtyre projekteve para Kuvendit të Kryeqytetit dhe gjithmonë duke pasur të arsyetuar mirë interesin publik. Faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit z. Retkoceri. Nora Kelmendi ka kërkuar fjalën.

Nora Kelmendi: - faleminderit shumë. Të nderuar të pranishëm, qytetarë. Sot para nesh kemi këtu një listë të veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të ipen në shfrytëzim në vitin 2026. Në mbledhjen e jashtëzakonshme të datës 30.12.2025, ne si grup kemi shprehur mospajtimet dhe kritikën tona lidhur me materialin e mangët që na është dorëzuar dhe i njëjti material u rikthye përsëri për shqyrtim nga MAPL, gjë që e cila dëshmon se vërejtjet tona kanë qenë të qëndrueshme të arsyeshme dhe të bazuara në argumente konkrete. Kjo tregon se ne nuk japim vërejtje për formalitet por ato janë të argumentuara dhe në përputhje me kornizën ligjore duke synuar përmirësimin e procesit si dhe respektimin e ligjit. Nëse e shikoni Ligjin nr. 06 L092 për dhënien në shfrytëzim dhe kembim e pronës së paluajtshme, Komuna duhet të publikojë listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të cilën e keni bërë ju dhe e keni

publikuar, duke arsyetuar interesin publik për zhvillimin ekonomik të Komunës. Lista e pronave të paluajtshme për dhënien në shfrytëzim duhet t'i ketë disa të dhëna, këto janë të dhënat kadastrale të pronave, qellimin, destinimin, datën e publikimit dhe periudhën kohore. Në qoftë se i shikoni dokumentacionin e pranuar, ju askund në dokumentacion nuk e keni cekur qellimin e dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme. Po ashtu në tabelë askund nuk është evidentuar në mënyrë të qartë se cili është interesi publik. Në tabelë i keni kolonat si numri rendor, numri i parcelës, sipërfaqja e parcelës, pronari, zona kadastrale, lloji i njësisë, certifikata e pronësisë, kopja e planit, destinimi si mbas PZHK-së, si mbas PRU-së, ku në të shumtën e rasteve destinimi si mbas PRU-së mungojnë të dhënat si dhe afati për dhënien në shfrytëzim. Kjo tregon një mungesë transparence duke vënë në dyshim qartësinë në vendimmarrjes dhe respektimin e interesit publik. Bazuar në të dhënat e mësipërme konstatohet se dokumentacioni i dorëzuar prap nuk është në përputhje me kornizat ligjore, sepse për të marrë vetëm litsën e veçantë jo edhe listën e përgjithshme si dhe mungojnë disa të dhëna siç është qëllimi dhe interesi publik. Në qoftë se e shikoni tabelën e pjesës të parë të materialit bashkangjitur dhe i krahasoni edhe certifikatat e pronës do të shihni disa mospërputhje të cilat duhet t'i cekni në vazhdim. Zona kadastrale Ballaban, mungojnë certifikatat e pronës për parcelat 1494/0, 1496, 1501, 1502, 1504, 1506, 1507. Në tabelë e keni në numrin rendor 43 deri në numër 49. Zona kadastrale Bardhosh, pra të gjitha i kemi evidentuar. Mungojnë certifikatat e pronës për parcelën 260/0, 261/0. Dabishec mungon certifikata e pronës për parcelën 691/0. Zona kadastrale Dragoc mungojnë certifikatat e pronës për parcelat 781/0, 868/1, si dhe 888/0, po ashtu në zonën kadastrale në Dragoc ekziston certifikata 1261/2, mirëpo kjo nuk është e paraqitur në tabelë. Në zonën kadastrale në Drenoc mungon certifikata e pronës për parcelën 20/1, në Keqekollë mungojnë certifikatat e pronës 3598/2, sipërfaqen e ka gabim, pra nuk e ka sipërfaqen 5848m², por sipërfaqja e saj është 5818m². Në Kolovicë mungon certifikata për parcelën 1273/0. Në Llukar mungon certifikata 190/0, 1022/0. Në Makoc mungojnë certifikatat e pronës 809/0 dhe 812/0. Në Nishec mungon certifikata e pronës për parcelën 22/0. Në Novosellë mungojnë certifikatat për parcelen 63/0, 70/0. Në Prapashticë parcela kadastrale në 810/0, në tabelë ka sipërfaqe 5329 ndërsa në certifikatë të pronës sipërfaqja mungon, ndryshon. Po ashtu mungon edhe certifikata e pronës për parcelën për 1954, në Prishtinë mungojnë disa certifikata të pronës si ajo 684 /1, 785 /19, 1498 /102, 1580 / 0, 1583 / 10, 2861 /0, 2862 / 3, 2864 / 0, 4355 / 1, 4451 / 2, 6022 / 0, 6113 / 6, 6141 / 1, 6141 / 2, 6270 / 0, 7206 / 15 etj. Disa certifikata të pronës së zonës kadastrale në Prishtinë ekzistojnë, por nuk janë të paraqitura në tabelën e dërguar nga ju, këtu janë parcelat 2796 / 0, 2851 / 4, 2851 / 5, 2851 / 6, 3079 / 2, 5977 / 0. Këto janë të gjeturat vetëm nga pjesa e parë e materialit të cilat i keni dorëzuar ju dhe vërehen mospërputhje të theksuara në dokumentacionet sa i përket pronave të listuara në krahasim me certifikatat e pronës. Në disa raste pra mungojnë pronat e paraqitura në tabelë, ndërsa në disa raste mungojnë certifikatat e pronës për pronat e listuara. Në total, në pjesën e parë janë të evidentuara 2218 prona apo parcela të ndara sipas zonave kadastrale. Edhe në pjesën e dytë të materialit i keni të listuara 1378 prona, të cilat gjithashtu në disa raste kanë mospërputhje. Duke marrë parasysh të gjitha këto shqetësime të ngritura nga ne, konfirmojmë se qëndrimet tona janë të qëndrueshme dhe të bazuara mbi interesin publik. Është thelbësore që materialet e ardhshme të jenë të plota, të sakta dhe në përputhshmëri me ligjin, në mënyrë që proceset e pronësisë të jenë transparente dhe të besueshme për të gjithë qytetarët. Ne duhet të vazhdojmë të mbështesim çdo iniciativë e cila siguron drejtësi, përgjegjshmëri dhe efikasitet duke punuar së bashku për një administrim më të mirë të pronave, e cila patjetër duhet të jetë në shërbim të qytetarëve të kryeqytetit. Ju falemnderit.

Kryesuesi: falemnderit znj. Kelmendi. Nga radhët e Lidhjes së Prishtinës.

Betim Abdullahu: përshëndetje për ty kryesues, kryetar dhe gjithë asambleistë. Lidhja e Prishtinës sikurse herën e kaluar e përkrah propozimin për miratimin e planifikuar të listës së veçantë të pronave dhe gjithashtu kërkon një proces transparent dhe në interes të publikut, andaj ne jemi pro votimit, të miratimit të kësaj liste.

Kryesuesi: falemnderit, znj. Besa Shahini ka kërkuar fjalën.

Besa Shahini: falemnderit kryesues, atëherë unë kalova pak kohë me dokumentacionet që i keni dërguar. Falemnderit që i keni dërguar dokumentacionin. Unë mendoj që prapë ka paqartësi shumë të mëdha që pamundësojnë votimin e kësaj liste, ja po i marr vetëm disa shembuj. Një pjesë e parcelave që keni paraparë të jepni në shfrytëzim kanë ndërtime mbi to, tash nëse doni të jepni në shfrytëzim, a i jepni në shfrytëzim personave që tashmë jetojnë aty apo doni t'i hiqni ata persona nga aty dhe t'i jepni në shfrytëzim dikujt tjetër? Nëse i hiqni ata persona që kanë jetuar aty për vite, ku do i vendosni etj. Një parcelë në Kodrën e Trimave është 9 hektarë, por ka vetëm certifikatën e pronësisë, po nuk ka plan të hapësirës, pra është hapësirë shumë e madhe e cila nuk dihet nga Komuna zyrtarisht se ku është. Tash si të jepet në shfrytëzim një pronë aq e madhe? Pse gjeodetët nuk kanë dalë deri tash në terren që të caktojnë kufijtë e një prone 9 - hektarësh? Të gjitha parcelat në Zllatar që figurojnë në listë janë gjelbërime dhe janë jashtë zonës ndërtimore përveç një pjesës që parashikohet të kalojë unaza e jashtme nëpër to. Pse janë dhënë këto në dispozicion për t'u dhënë në shfrytëzim, domethënë kujt i jepen në shfrytëzim parcelat që sot janë gjelbërim dhe nuk parashikohet të ndërtohet në to? E gjithë Novosella, të gjitha parcelat janë zonë e mbrojtur, Gërmia. Tash çfarë është ideja këtu, domethënë paramendoni ose po shpresoni që mundeni të ndryshoni distancën ndërkohë dhe pastaj jepni në shfrytëzim. Nuk po e kuptoj përmbajtjen e listës, kjo listë ka më pak parcela se ato që na keni sjellë në dhjetor. Unë mendoj që ka nevojë të pastrohet tutje dhe të sillen vetëm parcelat që me të vërtetë mund t'i jepen në shfrytëzim nga komuna dhe pastaj të merret një vendim mbi një dokument i cili ka vlerë. Tani ju keni thënë që është vetëm një votim paraprak dhe s'ka lidhje mundemi të votojmë kështu sepse secila pronë do të shtohet edhe njëherë një nga një. Unë do të doja të nënvizoja se nuk është ashtu. Neni i ligjit 9 dhe neni 11 tregojnë që parcelave mund t'u ndryshohet destinimi e para, dhe e dyta që kryetari mbi këtë votim tonin mundet të negociojë pastaj direkt nëse ka interes të madh komuna që të japë një pronë në shfrytëzim, pra mbi këtë votim ne e humbasim pastaj mundësinë që të shohim një proces të dytë ku verifikohet secila parcelë nga e para. Neni 14 i ligjit, të cilin domethënë po thirrremi sot, thotë që duhet të tregohen arsyet edhe qëllimi i dhënies në shfrytëzim të tokës. Tash kjo shkon përtej, më thanë që ka përfitim ekonomik Komuna e Prishtinës, natyrisht që ka përfitim ekonomik dhe duhet të shfrytëzojë këtë mundësi dhe të sigurojë të hyra në komunë. Janë mijëra hektarë tokë të cilat po kërkohet të marrin votim dhe të jepen në shfrytëzim. Ju kemi vlerësuar që kjo ka vlerën 2.3 miliardë euro. Po flasim për një pasuri shumë të madhe. Natyrisht që ka përfitim ekonomik, por duhet të shpjegohet shumë më detajisht se cili është përfitimi ekonomik, specifikisht i parcelave për të cilat po kërkohet votimi. Unë gjithashtu nuk e kam marrë një përgjigje për një kërkesë që e kam bërë në dhjetor. Auditori ka gjetur në shkelje komunën në menaxhimin e tokave që i ka dhënë në shfrytëzim për para duke mosinkasuar të

hyrat dhe duke i bërë dëme shumë të mëdha financiare komunës. Ju keni pasur për me dhënë një raport për planin që keni ndërmarrë për t'i adresuar rekomandimet e auditorit. Këtë nuk e kemi marrë. Komuna duhet të përfitonte prej pronës së vet. Unë kisha dashur që Komuna e Prishtinës të ketë shumë më shumë fuqi financiare, por është e pamundur të votohet me këtë listë e cila ka gjithë këto paqartësi që me të vërtetë e bëjnë gjithë procesin shumë të paqartë.

Kryesuesi: falemnderit znj. Shahini, nga Nisma Endrit Zabërgja.

Endrit Zabërgja: falemnderit kryesues, i nderuar Kryetar Rama, të nderuar kolegë, kabinet qeveritar, iniciativë qytetare e Prishtinës, për të cilët jemi këtu dhe jemi duke trajtuar një prej pikave shumë të rëndësishme të çdo viti, siç është dhënia në shfrytëzim e pronave të kryeqytetit. Ne besojmë që duhet të nisemi nga një parim fillestar. Parimi ynë fillestar është që kryeqyteti i takon qytetarëve të vet dhe patjetër se në këtë parim duhet të bëjmë të mundur ligjërisht si asamble ta kryejmë obligimin tonë ligjor që t'i mundësojmë qytetarëve të Prishtinës t'i shfrytëzojnë pronat e kryeqytetit. Andaj duke pasur parasysh volumin e madh të punës, i falënderoj edhe përfaqësuesit nga Drejtoria e Pronës, të cilët besoj nuk e kanë pasur lehtë, mirëpo patjetër që besoj që këto prona kur të jepen në shfrytëzim duhet të jenë transparente, duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe natyrisht ne si asamble pastaj t'i mbikëqyrim dhe monitorojmë për secilën veç e veç ashtu siç e do detyra, derisa pa dashur të zgjatemi më shumë. Po ne e përsërisim votimin tonë ashtu siç kemi votuar herën e kaluar. E konfirmojmë dhe e mbështesim këtë listë të pronave për t'u dhënë në shfrytëzim. Ju falemnderit.

Kryesuesi: falemnderit z. Zabërgja. Lista Guxo, Jeton Mehmeti.

Jeton Mehmeti: ashtu siç e kemi thënë edhe në dhjetor, në fund të dhjetorit, kur e kishim këtë listë për para vetes dhe kemi thënë që nuk ishin të plotësuara kushtet ligjore, atëherë nuk ishin as minimale, domethënë të plotësuara. Kësaj radhe më vjen mirë, falënderoj drejtorin e pronës, i cili ka bërë një punë goxha të mirë deri diku, por prapëseprapë po shihet që ka ngecje dhe mungesa në procese. Unë po e them shumë sinqerisht që jam ithtar i zbatimit të ligjit dhe kam dëshirë që gjithmonë, kur një dosje vjen për t'u votuar, të paktën vota ime të jetë në harmoni me ligjin. E pavarësisht kësaj, unë e di dhe e shoh interesin e komunës, interesin e qytetarëve, që këto prona, duhet të hynë në proces dhe të vendosen në proces të dhënies me qira, interesi ekonomik i komunës. Prapë po them se mungojnë elemente bazë, elemente bazë ligjore, por duke pasur parasysh që kemi edhe një votim tjetër të radhës kur këto vijnë prapë të specifikuara dhe me distancë, po ashtu me kohë dhe periudhë e kohës e cila do të jepet, kjo na jep një lloj hapësire që të mendojmë edhe herë tjetër dhe të votojmë tamam siç duhet. Ajo çfarë desha unë me shtuar ma tepër është, e kisha lut edhe kryetarin e komunës edhe drejtorët e drejtorive të jenë më të vëmendshëm kur sjellin për propozim dhe votim proceset që duhen votuar në asamble. Asambleja nuk është thjeshtë një organ ligjor që duhet të votojë çdo gjë që vjen, fillimisht për bazë duhet të marrim bazën ligjore. Nëse proceset vijnë pa bazë ligjore, nuk e di se si ndihen kolegët e mi kur votojnë një dokument, ky dokument shkon në instanca tjera dhe kthehen si i paligjshëm. Baza ligjore është baza elementare për të votuar ose për të kryer një proces, unë si asamblist dhe kolegët e mi në asamble. Prandaj po e them shumë sinqerisht, me shumë dilema, po e them se a duhet të votoj apo nuk duhet të votoj këtë listë, por duke pasur

parasysh që interesi i komunës, duhet të shtyhet përpara dhe interesi i qytetarëve të komunës duhet shtyhet përpara nëse ka hapësirë për rregullimin e procesit do të ishte mirë të rregullohej. Nëse nuk ka hapësirë dhe kohë, atëherë unë besoj se duhet ta mbështes këtë listë. Falemnderit.

Kryesuesi: falemnderit z. Mehmeti, Nexhmije Gjema e ka kërkuar fjalën.

Nexhmije Gjema: përshëndetje të nderuar. Prita që sot kjo seancë e jashtëzakonshme do të mbahet, më së pari lidhur me tragjedinë apo fatkeqësinë që ndodhi dje. Prishtina siç e dimë të gjithë po shembet para syve tonë dhe për fat të madh dje nuk pat viktima.

Kryesuesi: ju kisha lutur që të fokusoheni në rendin e ditës.

Nexhmije Gjema: do fokusohem së kjo është hyrja. Për fat të madh dje nuk pat viktima. Zotëri me lejoni sepse kjo duke filluar prej jush dhe secilit prej neve që jemi në sallë, është shumë më brengosëse sesa për tema për të cilën jemi thirrur sot në seancë të jashtëzakonshme sepse ka ndodh dje. Për fat të mirë nuk ka pas viktima dje po ne nuk e dimë a ka me pas sot, nesër, gjatë javës, gjatë muajit apo vitit. Prandaj është dashtë me ia përkushtuar si seancë të jashtëzakonshme pikërisht këtij problemi, por po i kthehem temës sepse kjo po është me rëndësi për ju. Ky vendim nuk është një vendim i zakonshëm teknik, pasi lidhet me dhënien në shfrytëzim të pronës publike për periudha shumë të gjata, deri në 99 vjet. Kjo e bën këtë vendimin me peshë më të madhe për menaxhimin afatgjatë të pronës komunale. Për këtë arsye ky vendim kërkon nivel të lartë sigurie juridike dhe transparencë. Po filloj prej pikës së parë prej Bardhoshit, rastin e Bardhoshit nga shqyrtimi i dokumentacioneve, vërehet mungesë e përputhjes së qartë dhe të verifikueshme ndërmjet listave të parcelave, kopjeve të planeve dhe certifikatave të pronësisë. Nga 39 parcela vetëm 31 janë të evidentuara në kopjet e planit, pra mungojnë 8 prej tyre. Për me tepër në dokumentacion paraqiten kategori të ndryshme juridike, duke filluar si prona shoqërore, prona private edhe posedim individual, duke përfshirë edhe rastet me pronarë individualë Kjo nënkupton qartë se nuk kemi të bëjmë me një bazë të pastër komunale dhe këto prona nuk mund të trajtohen në mënyrë të njëjtë në një vendim të vetëm, (nuk është incizuar)..... Në përputhje serioze ndërmjet evidencës dokumentare dhe asaj digjitale duke e bërë të pamundur verifikimin e saktë të parcelave, ky ishte vetëm një shembull. Në mungesë të të dhënave të përditësuara nuk mundemi me konstatuar nëse ka pasur ndryshime pronësore apo ngarkesa juridike. Nga të gjitha këto del që dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë. Domethënë dokumentacioni nuk është i plotë, nuk është i përditësuar edhe nuk është i verifikuar në mënyrë të pavarur. Në disa raste madje dhe ekzistenca e parcelave nuk mundet me u konfirmuar në sistemet zyrtare. 99 vjet janë një shekull, me i dhënë shfrytëzim 3645 parcela për gati një shekull pa i pasur të dhënat e përditësuara prej 12 vjetëve është pak marre edhe për këtë arsye unë nuk mundem me votuar këtë vendim. Ju falemnderit.

Kryesues: falemnderit shumë. Feim Osmani ka kërkuar fjalën.

Feim Osmani: falemnderit. Përshëndetje për të gjithë. Së pari dua t'ju falënderoj që më në fund pas shumë vërejtjeve e ankesave e keni plotësuar deri diku dosjen me dokumente të nevojshme të cilat do të na mundësonin t'i analizonim pothuajse shumicën e pronave një nga një jo të gjitha

parcelat natyrisht sikur ta kishim në dispozicion edhe kohën e mjaftueshme. Megjithatë edhe ju vetë e dini se pa marrë parasysh që është shumë e nevojshme ta kemi mundësinë sidomos në aspektin kohor t'i shikojmë e t'i analizojmë të gjitha. Ka qenë e pamundur për aq kohë sa kemi pasur në dispozicion ta bëjmë një gjë të tillë ngase lista është shumë e gjatë e pafiltruar mjaftueshëm dhe numri i pronave është aq i madh sa që nevojiten muaj të tërë të analizohen dhe të votohet sigurt pa pasur frikë se po e dëmtojmë interesin publik. Kjo është pjesa kryesore për mua personalisht që më bën të hezitoj të votoj për. Natyrisht që ka të bëjë edhe me pjesën procedurale përveç se me përmbajtje, në këtë kontekst duke pasur parasysh atë që thashë më parë se analizimi i të gjithë materialit ka qenë i pamundur brenda kësaj jave sa na ka ardhur materiali për seancë të jashtëzakonshme. Madje të dashur banorë të Prishtinës, këtë listë ka edhe prona që janë pyje duke futur dhe duke mos i hequr fare nga lista këto sipërfaqe të gjelbëruara dhe këtu shtrohet një pyetje: "Pse duhet hapësirat pyjore të jepen në shfrytëzim çka do të bënin pronarët e rinj me këto prona". Në këtë kontekst duke pasur parasysh atë që thashë edhe më parë se gjithë materiali ka qenë i pamundur të analizohet, mirëpo unë i kam shikuar disa prona që janë më afër lokalitetit ku unë banoj dhe nga ajo çka unë kam parë e kam vënë re se ju si udhëheqës të kryeqytetit nuk e keni pasur parasysh fare zhvillimin e mirëfilltë të lagjeve e fshatrave të kryeqytetit duke mos e paraparë ruajtjen e asnjë prone të vetme për planifikim afatmesëm e as afatgjatë të zhvillimit të shoqërisë sonë. Kjo mënyrë se si po dalin para publikut për dhënien në shfrytëzim këto prona, është e vështirë të besohet se do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e kryeqytetit, mirëpo më shumë ka tendencë që të bëjë probleme, që t'u mundësojë zyrtarëve ta keqpërdorin pronën publike pas votimit. Pra nisur nga ky fakt në asnjë rrethanë nuk do ta kisha paramenduar se sot në vitin 2026 kur ende Prishtina nuk ka as plan zhvillimor e madje as vizion se si do të duket zhvillimi i ardhshme i shtetit të dalin në ankand të gjitha pronat pa përjashtim për t'u dhënë në shfrytëzim madje deri edhe për 99 vite që është tjetërsim total i pronës publike të cilën pronë në rastin kur nesër do të vijë në krye të qytetit një kryetar i cili do të mendojë për qytetin dhe banorët e tij, nuk do të ketë asnjë pronë të vetme në dispozicion, të cilën do ta përdorë për të rregulluar aspektin infrastrukturor e urban të lagjeve e fshatrave, e as për të ndërtuar objektet të interesit publik qoftë park, shkollë, çerdhe, spital, shtëpi për të moshuar, shtëpi kulturore apo edhe objekte të administratës publike, të cilat edhe vetë i keni premtuar e që e dini fort mirë sesa shumë i mungojnë Prishtinës. Madje nesër mund të mos ketë as pronë të lirë publike që do të shërbente për ta shkëmbyer me qëllim të rregullimit të lagjeve, vendbanimeve, qofshin urbane apo rurale pa dallim. Kjo që po bëni ju sot është tentim për privatizim të të gjithë pasurisë të paluajtshme publike pa kriter e pa asnjë lloj analize përmbajtjesore. Për ta sqaruar edhe më në detaje faktin se ju nuk keni menduar fare për interesin publik, madje as për planet afatshkurtra që i keni bërë vetë. Po a kujtoj se shumë projekte që i keni futur në buxhetin e vitit 2026 nuk keni ku t'i ndërtoni ngase nuk ka hapësira publike as sot kur i keni në dispozicion këto prona, e lëre në të ardhmen kur këto prona komunale do të jepen në shfrytëzim për 99 vite për persona privat. A keni menduar për shembull një fushë sportive rekreative që e keni futur në buxhetin e vitit 2026 për fshatin Besi ku do të gjeni lokacionin? E di që nuk keni as ide sepse natyrisht është problem të gjendet lokacioni atje sepse ka pak prona komunale, mirëpo lëre nesër kur të mos i keni më. E di që përgjigja juaj do të jetë se për çdo pronë që ka kërkesë nesër për dhënien shfrytëzim do të votohet prapë në kuvend, por kjo nuk e garanton se të njëjtit që sot nuk po kanë konsideratë për ta seleksionuar para miratimit vetëm pronat që nuk përbëjnë interes publik që të jepen në

shfrytëzim..... Madje pas votimit të kësaj liste ashtu siç është nuk ka më as arsye as të drejtë t' ndalohet kujto që shpreh interes për cilëndo pronë ta fitojë atë dhe të njëjtën ta shfrytëzojë e të mos ta ketë komuna në dispozicion. Pra sot është momenti të rregullohet kjo çështje sepse nesër do të jetë vonë. Ju bëj thirrje më në fund t'i thërrisni mendjes e të mos vazhdoni tutje këtë nismë para se ta publikoni, para se ta planifikoni në detaje se si do të zhvillohet Prishtina e t'i keni llogaritur e planifikuar mirë kahjen e zhvillimit të lagjeve e fshatra të Prishtinës. Vetëm atëherë ta publikoni listën për dhënien shfrytëzim dhe vetëm ato prona që së paku në planifikim afatmesëm nuk i shërbejnë kryeqytetit për nevojat e komunitetit të dalin në listë. E kundërta e kësaj të nderuar asamblistë dhe të dashur banorë të Prishtinës është më shumë mundësi për ta keqpërdorur pronën tonë të përbashkët komunale e cila është tepër e rëndësishme për të ardhmen tonë dhe të pasardhësve tanë. Ne si anëtarë të kuvendit sot do duhej të gjithë bashkë pa dallim.....

Kryesuesi: falemnderit z. Osmani. Enver Redenica ka kërkuar fjalën.

Enver Redenica: - përshëndetje z. Rama, përshëndetje drejtor të drejtroive, të nderuara kolegë assembleist, të gjithë ju të pranishëm në sallë, qytetar të dashurë të Prishtinës. Sot kemi para nesh për herë të dytë edhe në formë të jashtëzakonshme listën e veçant të pronave të paluajtshme, që planifikohen të jepen në shfrytëzim për vitin 2026. Dua të jemë shumë i qartë kjo listë ashtu siç na është paraqitur ka shumë paqartësi në mospërputhje me realitetin në terren edhe elemente që lenë dyshime serioze për keqpërdorim dhe interesa të caktuara grupore dhe individuale, sipas vetëpërmbytjes së vendimit çdo pronë duhet të ketë të dhëna të sakta, numrin e parcelës, sipërfaqen, zonën kadastrale dhe destinimin, por në praktikë këto të dhëna nuk përkojnë me realitetin ka devijime të mëdha dhe sidomos destinimet janë në të shumtën e rasteve të paarsyeshme dhe të pakuptimta dhe nuk ka informata të sakta mbi to për shkak të kohës së kufizuar, do të ndalem vetëm në disa raste konkretë në zonat Sofali dhe në qendër. Rasti i parë në “Sofali” për çudi i takonë zonës qendër me numer kadastral 2451/2, 2452/2, 2459/2, këto parcela ka kohë që janë të uzurpuara dhe të rrethuara të gjitha dhe tash më njëra funksionin si “Rent a Car”. Pyetja është shumë e thjeshtë, si është e mundur që një hapsirë e uzurpuar të futet në listë për të dhënë në shfrytëzim, tani kujt po i jepet në shfrytëzim kjo parcelë ku i mungojn të dhënat e në realitet punohet që disa vite në të. Rasti i dytë parcela pranë ambulancës në “Velani” me numër kadastral 2552/0 zona qendër, për këtë parcelë mungojn të dhënat e qarta për destinim kjo ndodhet mbi ambulant përballë çerdhes dhe në atë zonë ka edhe shumë parcela të tjera pa një planë konkret, tani si mund të miratojm na diçka pa ditur edhe për çka mund të e përdorim, destinime të sakta nuk ka. Rasti i tretë rruga hyrse në “Gërmi” nga “Sofalia” me numër kadastral 0310 zona Sofali kjo është një nga çështjet më shqetësuse bëhet fjalë për një hapsirë që praktikisht është pjesë e parkut që gjendet afër hyrjes së pishinës së Gërmisë ku realisht shumica e tyre parcelave veç se janë të uzurpuara nga vetë komuna për njerëz të fuqishëm që punojn këtu në Komunë. Tani po tentohet që përmesë dhënies në shfrytëzim të krijohen lidhje rrugore për disa toka private, që janë aty sipër kjo nuk është thjeshtë vendim teknik, është ndërhyrje e drejtperdrejt në interesin publik në favore private dhe për këtë dikush duhet të jap përgjegjësi në të ardhmen. Rasti i katërt parcela me shtëpi ekzistuese me numër kadastral 040/0 dhe 039/0, zona Sofali, dy parcela figurojn si në shfrytëzim në realitet aty ka kohë që janë shtëpi të ndërhuara pra nuk po flasim për tokë të lirë

por për një situatë të krijuar dhe të toleruar më parë nga inspekcioni dhe vetë Komuna. Tani a po legalizoni ato shtëpi apo tokën duhet të dini sakt? Rasti i pestë projekti i premtuar në “Sofali”, për kënde lojash me numër kadastral 0496/0 dhe 047/1 para dy vite si lagje e kemi fituar buxhetimin me pjesëmarrjen me vlerë prej 200 mijë euro, për ndërtimin e një këndi lojash dhe parku për fëmijë në ato parcela ky ka qenë premtim i drejtpërdrejt nga Komuna të cilin e kanë fituar si grand, sot në vend të realizimit të këtij projekti qytetarët po dëgjojnë dhe po shihet se njëra hapsirë mund të përdoret për interesa të tjera madje për objektet që nuk kanë asnjë lidhje për interesin publik për personat të cilët kanë ndihmuar Përparim Ramen me vota të zgjedhet si kryetar i Prishtinës. Kjo është zhgënjim edhe mashtrim me qytetarët bile edhe abuzim me tokën publike, të nderuar këto nuk janë gabime të vogla teknike, këto janë probleme serioze, që prekin besimin e qytetarëve në këto institucionet tona, ne nuk jemi këtu për të formalizuar vendimet tona të dyshimta por për të mbrojtur interesin publik, transparencën dhe ligjshmërinë prandaj në këtë formë kjo listë është e papranushme dhe kundër interesave të qytetarëve. Unë si asambleist nuk mund të mbështes një vendim që nuk përputhet me realitetin në terren që mungojnë transparenca dhe që ngre dyshime për favorizime të caktuara të individëve, kërkojë që kjo listë të tërhiqet, të rishikohet në detaje dhe të rikthehet vetëm atëherë kur të jetë e saktë, transparente dhe interes të qytetarit të Prishtinës, faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit z. Redenica, Çlirim Gërbeshi ka kërkuar fjalën.

Çlirim Gërbeshi: - të dashur qytetar, i nderuar ekzekutiv, është shqetësuese dhe për keqardhje mënyra se si mënyra me nguti dhe përmes seancave të jashtëzakonshme po procedohen pika të rendit të ditës të cilat janë shumë të rëndësishme për Prishtinën dhe qytetarët e saj. Bëhet fjalë për çështjet që lidhen me pronat tona të Kryeqytetit të cilat meritojnë një trajtim të veçantë e transparent, Prishtina ka mbetur me më së paku prona publike por gjithashtu Prishtina dhe qytetarët kanë nevojë edhe për parqe edhe hapsira të gjelbërta, për qendra rekreative dhe kulturore, për qendra rinore dhe fusha sportive. Prishtina ka nevojë edhe për banesa për çifte të reja por kryetari ka refuzuar për me nda parcelen dhe nuk ka aplikuar fare në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë që Prishtina të i ketë këto banesa të cilat janë shumë të nevojshme për qytetarët. Kryetari ka refuzuar ta ndaj parcelen edhe për sallën e sporteve për Federatën e Basketbollit dhe gjithashtu ka refuzuar ta ndaj parcelën edhe për Stadiumin nacional, refuzonë dhënie të pronave që janë për nevojat e qytetarëve por listat e pronave për dhënie në shfrytëzim i aporovon, listën e aporovon sepse synimet e tij janë të Klubi i Dostave dhe interesave të ngushta biznesore, të dashur qytetar çfarë po ndodh sot në Kuvendin Komunal të Prishtinës, është edhe një krim i radhës nga ana e Kryetarit Rama, sot këto pak prona të cilat kanë mbetur po sillen tek ne me arsyetimin për dhënie në shfrytëzim, mirpo të gjithë e dijmë që ky është vetëm një orkestrim për shkak se përfituesit potencial tashmë janë paracaktuar nga Kryetari, grupe të ngushta të interesit, e klikat po e shkatrojnë Prishtinën çdo ditë e më shumë, pronat e Kryeqytetit duhet të i ruajm secili prej nesh dhe në këto prona duhet të investohet nga Komuna e Prishtinës e jo nga bizneset që primare kanë përfitimin financiar dhe ndërtimin e pakontrolluar e të egër e plot me beton, dhe një çështje tjetër me rëndësi të veçantë, a mundet drejtori ose Kryetari të na informoj nëse është formuar Komisioni për vlerësimin e pronave? Kjo mbetet çështje thelbësore pasi që si asambleist kemi nevojë për transparenca të plotë dhe informim të sakt lidhur me këto prona të cilat do të jepen në shfrytëzim, faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit z. Gërbeshi, z. Sveçla ka kërkuar fjalën.

Gëzim Sveçla: - të nderuar kolegë asamblesit, anëtar të ekzekutivit nga diskutimet e kolegëve kuptuam që për ndryshim nga herat të tjera sa i përket aspektit administrativ kjo listë është më mirë, sesa që ka qenë por është larg së plotësuari kriteret dhe kërkesat që rrjedhin nga ligji. Për transparencë duhet kujtuar se Ministria gjetëse MAPL-ja vendimin paraprak e ka kthyer gjatë muajit janar. Do të thotë para dy muajve është ditur që lista paraprake është në kundërshtim me ligjin, ndërkohë që ne jemi vetëm një ditë parakalimit të afatit sepse duhet treguar që me 31 mars është afati përfundimtar kur mundet me u miratu kjo listë dhe natyrisht ky afat është si rrjedhojë e proceseve zgjedhore që ka ndodhur sepse normalisht është para vitit parafundit të vitit. Prona komunale është aset i rëndësishëm që e ka një komunë dhe nëse menaxhohet drejtë është instrument që sjell zhvillim, sjell të hyra, planifikim hapësinor dhe i shërben drejtpërdrejt interesit publik. Lista që po kërkohet ta miratojmë sot është një listë e gjerë me shumë prona, mbi 3500 prona, por fatkeqësisht nuk shoqërohet me një logjikë zhvillimore, nuk ka orientim sektorial edhe nuk ka objektiva të matshme. Ne nuk e dimë pse për shembull janë të gjitha ato prona cilësdo qoftë zonë kadastrale. Çka mendon ose çka planifikon komuna, ekzekutivi me bër në ato zona? Pse pothuajse në secilën zonë kadastrale është numri gati i tërësishëm i pronave komunale që janë pjesë e listës. Në asnjë mundësi dhe në asnjë variant gjatë vitit që na kanë mbetur edhe tetë ose nëntë muaj nuk ka mundësi që komuna të jepë shfrytëzim më shumë se një numër simbolik të pronave. Atëherë pse ngutia që kjo listë t'i ketë 3500 prona? Pse s'janë 20 prona, shembull, të cilat komuna planifikon me i dhënë në shfrytëzim, të cilat kanë një interes publik, të cilat i sjellin dobi pasurore komunës. Çka po duam të kamuflojmë me këto 3.500 prona ose cilat janë ato prona? Unë jam i bindur që s'janë shumë. Numërohen në gishtërinjë të dorës, të cilat janë të rëndësishme për ju e që gjenden brenda këtij 3500. Shumë më lehtë kishte me qenë edhe në aspektin teknik edhe procedural që ta përgatitnin një listë me një numër të pronave të cilat me të vërtetë është e mundur të jepën në shfrytëzim gjatë këtij viti në të cilin ndodhemi. Se prona është e rëndësishme jo vetëm kur jepet në shfrytëzim po prona është e rëndësishme për të kujdesur për të gjatë gjithë kohës. Pronë komunale është edhe rruga që u shemb dje e për të cilën unë me të vërtetë nuk i kuptoj kolegët e mi pse hezitojnë me e përmend ose pse kanë frikë pse ulurojnë kur e përmend dikush. Ne këtu jetojmë të gjithë, duhet me i përmendur këto çështje. Duhet me e drejtuar gishtin nga dikush, duhet me u gjetur fajtori për këto është evidente se kjo qeverisje, sepse është vazhdimësi e qeverisjes së mandatit të kaluar, ka dhënë edhe më përpara prona në shfrytëzim. A mund t'i përmendim disa raste ku kjo është tregu si storie e suksesi me thënë e kena dhënë këtë pronë në shfrytëzim. Komuna ka përfituar kaq. Këtë ja kemi arritur, prandaj po duam me përsërit, po duam dikujt tjetër me i dhënë. Çka është ideja veç me plotësuar një kërkesë ligjore që është miratimi i pronës, pa një strategji, pa një vizion, pa një ide se çka po duam të bëjmë. Edhe një lutje për kolegët e mi asambleistë të gjitha subjekteve me u msheh pas kinëse tendencës për mos me e bllokuar qytetin e me votu prona që hapin rrugë për korrupsion nuk i shërbeni qytetit ose tjetra që po e kalojmë kësaj radhe sepse secila pronë ka me ardhë përsëri në Kuvend të keqes duhet me i thënë stop në mundësinë e parë dhe në secilën mundësi kush e din çfarë rrethana kanë me ndodhur kur të vihen prapë cilado qoftë pronë këtu në Kuvend Komunal. Prandaj në situatë të tillë Lëvizja Vetëvendosje nuk mundet me e përkrah një listë të tillë e cila ka aq shumë shkelje që u numëruan nga kolegët parafolës. Me keqardhje them sepse

është evidente se duhet të shfrytëzohet prona komunale, por ne mbështesim shfrytëzimin e pronës komunale kur ajo i shërben interesit publik e jo intereseve të veçanta. Faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit, Valbona ka kërkuar fjalën.

Valbona Vitija-Ajeti: - faleminderit i nderuar kryesues, i nderuar kryetarë, nënkryetarë, të nderuar drejtor. Personalisht e përkrahi këtë pikë duke konsideruar se menaxhimi më i mirë i pronave publike ka detyrim të tillë. E falenderoj në këtë moment drejtorin e pronës dhe zyrtarët e Drejtorisë të Pronës për punën që kanë bërë deri tani për këtë proces. Faleminderit shumë.

Kryesuesi: - faleminderit zonja Ajeti. Dëshiron dikush fjalën? Jo, atëher hapim votimin. Lus regjinë të jetë gati për votim, votojmë tash, faleminderit me 35, Betim Abdullahu se s'po punon ajo, në rregull. Atëherë me 35 vota për, 14 kundër, asnjë abstenim. Kalon edhe kjo pikë, faleminderit shumë. Me kaq edhe po e përfundojmë këtë seancë. Mirupafshim në seancat e radhës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më .2026, miratoi këtë

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR SHËRBIME SOCIALE NË KOMUNËN
E PRISHTINËS, 2026-2028

Neni 1

Miratohet Vendimi i Planit të veprimit për shërbime sociale në Komunën e Prishtinës, 2026-2028.

Neni 2

Qëllimet kryesore të Planit të veprimit për shërbime sociale janë: shërbime sociale të integruara për grupet e cenuara, mbështetje për personat me aftësi të kufizuara (të mitur dhe të rritur), zhvillimi i kapaciteteve dhe burimeve njerëzore, të këshillimit dhe digjitalizimi i bazës së të dhënave dhe mbështetje për strehim për grupet në nevojë për mbrojtje sociale.

Neni 3

Përfitues të këtij Plani të Veprimit janë fëmijët, të moshuarit, fëmijët, të rinjtë në konflikt me ligjin, ata që konsumojnë dhe përdorin alkool dhe droga të tjera, personat me sëmundje kronike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijë dhe të rinjtë me vështirësi në të mësuar ose probleme të shëndetit mendor, dhe ata që janë në rrezik abuzimi dhe/ose neglizhimi që rrjedhin nga trafikimi i qenieve njerëzore dhe dhuna në familje.

Neni 4

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i veprimit për shërbime sociale në Komunën e Prishtinës, 2026-2028.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përgjegjëse.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**Plani i veprimit për shërbime sociale në Kryeqytet
2026 – 2028**

Prishtinë
2025

Tabela e Shkurtesave

Shkurtesa	Përshkrimi
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
COFOG	Classification of the functions of government Klasifikimi i Funksioneve të Qeverisë
DBF	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DPMS	Drejtoria Komunale për Mirëqenie Sociale
DPSF	Departamenti për Politika Sociale dhe Familje
KOMF	Koalicioni i Organizatave për Mbrojtjen e Fëmijëve
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal
LNOB	Leave No One Behind
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MM	Memorandum i Mirëkuptimit
MPFVLÇ	Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
QPS	Qendra për Punë Sociale
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
SOS	SOS Fshatrat e Kosovës
TdH	Terre des Hommes
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
UA	Udhëzim Administrativ

Dokumentet e Referimit

- Analizë e Qendrave për Punë Sociale 2022¹
- Analizë e Situatës, Save the Children, Euro Center for Social Research, 2018,
- Buxheti i miratuar i Komunës së Prishtinës 2025²
- Ligji i Buxhetit 2026³,
- Manuali për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike, ZKM, 2019⁴
- Profili i Komunave të Kosovës, MAPL,
- Raporti i DMS, Komuna Prishtinës 2020⁵,
- Raporti i Institutit GAP/Letërnjoftimi i Komunës së Prishtinës⁶
- Rregullore Komunale për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve⁷
- Rregullore për Ndarjen e Subvencioneve nga Komuna e Prishtinës⁸
- Rregullore për të hyrat vetanake të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës⁹
- Statistikat Sociale 2020, MPMS, ASK, 2021,
- Strategjia dhe Plani Kombëtar për Zhvillim 2030¹⁰
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021, ZKM, 2016¹¹
- Strategjia Sektoriale e MPMS 2018-2022, MPMS, 2018¹²,

¹ <https://komfkosova.org/wp-content/uploads/2023/11/Analiza-shqip-1.pdf>

² <https://prishtinaonline.com/investimet/buxheti>

³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=99639>

⁴ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/manual-per-planifikimin-hartimin-dhe-monitorimin-e-dokumenteve-strategjike-dhe-planeve-te-tyre-te-veprimit.pdf>

⁵ <https://prishtinaonline.com/raportet-e-punes-se-drejtoreve>

⁶ <https://komunat.institutigap.org/reports>

⁷ https://prishtinaonline.com/uploads/draft_rregullorja.pdf

⁸ https://prishtinaonline.com/uploads/6_1_projektregullorja_per_subvencione_1.pdf

⁹ https://prishtinaonline.com/uploads/propozim_rregullorja-per-te-hyrat-vetanake-te-institucioneve-kulturore_diskutim_publik.pdf

¹⁰ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/03/06032023-Strategjia-dhe-Plani-Kombetare-per-Zhvillim-2030.pdf>

¹¹ https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/06/Strategjia_Komb%C3%ABtare_p%C3%ABr_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf

¹² <https://mpms.rks-gov.net/wpdm-package/strategjia-sektoriale-e-ministrise-se-punes-dhe-mireqenies-sociale-2018-2022/>

Përmbledhje ekzekutive

Në të gjitha shoqëritë ka njerëz që kanë vështirësi të kujdesen për veten dhe familjen e tyre, dhe për këtë arsye kanë nevojë për kujdes dhe mbështetje nga të tjerët. Shembujt më të dukshëm janë fëmijët në nevojë, të moshuarit, të varfëritë, mirëpo edhe shumë të rritur, të mirë edukuar e të pasur mund ta gjejnë veten në këtë pozicion.

Në disa situata, ndërhyrjet e mbështetjet nga familjet e tyre, dhe nganjëherë nga miqtë dhe fqinjët janë të mjaftueshme. Shpeshherë këto ndërhyrje nuk mjaftojnë, dhe në shumë situata njerëzve ju duhet të kërkojnë ndërhyrje jashtë familjes së tyre-siç janë institucionet qeveritare të mandatuara ose shërbimeve të ofruara përmes organizatave joqeveritare (OJQ).

Komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria për Mirëqenie Sociale së bashku me OJQ “SOS Fshatrat e Fëmijëve”, Qendrën për Punë Sociale (QPS), si institucioni primar për ofrimin e shërbimeve sociale, si dhe institucionet dhe Organizatat tjera jo-Qeveritare/OJQ-të, bazuar në nevojën për të planifikuar në mënyrë sa më efektive ofrimin e shërbimeve sociale, për tre vitet në vijim, 2026–2028, kanë themeluar grupin punues për hartimin e një plani të veprimit për këto shërbime në Komunën e Prishtinës.

Ky plan i veprimit është hartuar bazuar në hulumtimin e gjendjes në teren, analizës së raporteve që trajtojnë mirëqenien sociale dhe përfshirjen sociale në Komunën e Prishtinës dhe kontributit të stafit nga QPS-ja në Prishtinë dhe stafit nga OJQ të ndryshme në Komunën e Prishtinës. Një mbështetje e pamohueshme në këtë proces është ofruar edhe nga Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, përkatësisht Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare/DPSF dhe SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë.

Hartimi i këtij plani të veprimit dhe temat e përfshira në këtë plan të veprimit janë diskutuar gjatë punëtorive të organizuara me qëllim të hartimit të këtij plani dhe komunikimit të rregullt që është zhvilluar gjatë procesit të hartimit të këtij dokumenti. Procesi i hartimit të këtij plani është përkrahur nga një konsulent i angazhuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë.

Plani Lokal i Veprimit për Shërbimet Sociale në Komunën e Prishtinës 2026–2028 që është në linjë me objektivat e Strategjisë Sektoriale 2018-2022 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ekipi i Hartimit të këtij Plani të Veprimit ka vendosur që në kuadër të këtij plani të përfshihen dhe harmonizohen katër objektiva të ndërlidhura me ato të strategjisë dhe planit të veprimit të nivelit qendror për mirëqenien sociale që përfshijnë këto fusha:

- 1.Shërbime sociale të integruara për grupet e cenuara.
- 2.Mbështetje për personat me aftësi të kufizuara
- 3.Zhvillimi i kapaciteteve dhe burimeve njerëzore, tele-këshillimi dhe digjitalizimi i bazës së të dhënave

4. Mbështetje për strehim, rehabilitim, ri integrim dhe risocializim për grupet në nevojë për mbrojtje sociale

Në pjesën e parë, grupi punues ka përcaktuar: principin e punës për zhvillimin e planit, dokumentet dhe të dhënat bazë që do të përdoren për këtë plan, prioritetet dhe grupet më të cenuara në komunën e Prishtinës dhe në bazë të këtyre janë përcaktuar objektivat strategjike, objektivat specifik, aktivitetet, rezultatet e pritshme, indikatorët/treguesit e ndryshimit të synuar, buxheti për secilin objektiv dhe aktivitet, akterët dhe institucionet e OJQ-të përgjegjëse, hisedarët dhe implementuesit.

Ky plan veprimi mbulon periudhën 2026–2028 dhe do të zbatohet në përputhje me planin e aktiviteteve të parashikuara. Zbatimi i tij do të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me akterët lokalë në nivel komunal, si dhe me institucionet përkatëse dhe organizatat joqeveritare në nivel qendror të Republikës së Kosovës.

Përfitues të këtij Plani të Veprimi janë fëmijët, të moshuarit, fëmijët, të rinjtë në konflikt me ligjin, ata që konsumojnë dhe përdorin alkool dhe droga të tjera, personat me sëmundje kronike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijë dhe të rinjtë me vështirësi në të mësuar ose probleme të shëndetit mendor, dhe ata që janë në rrezik abuzimi dhe/ose neglizhimi që rrjedhin nga trafikimi i qenieve njerëzore dhe dhuna në familje.

Hyrje

Komuna e Prishtinës - Demografia

Prishtina është kryeqyteti i Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht qyteti i saj më i madh si për nga sipërfaqja ashtu edhe për nga popullsia. Ajo është po ashtu qendra kryesore ekonomike, politike, financiare dhe tregtare e Kosovës dhe gjendet në pjesën qendrore të Kosovës. Shumicën dërmuese të popullsisë e përbëjnë shqiptarët, por aty jetojnë edhe pjesëtarë të komuniteteve tjera etnike si romë, boshnjak, serbë, etj.

Komuna e Prishtinës ka 572 km².

Prishtina gjendet në pjesën veriperëndimore dhe shtrihet buzë rrafshnaltës së pëlleshme rrzë maleve të argjendta. Ashtu si dikur Ulpiana, ka pozitë të përshtatshme gjeografike, pasi gjendet në kryqëzimet parësore kontinentale. Komuna e Prishtinës i ka gjithsej 48 fshatra¹³.

Komunitetet që jetojnë në Komunën e Prishtinës janë: Serb, turk, boshnjak, rom, ashkali etj. Sektori i bujqësisë, gjuetisë dhe pylltarisë përshinë 27 biznese. Në sektorin e industrisë nxjerrëse ekzistojnë 16 biznese. Sektori i furnizimit me energji elektrike, gas dhe ujë numëron 5 biznese, ai i ndërtimitarisë me 329 biznese, ndërsa ai i tregtisë me shumicë dhe pakicë 4.203 biznese. Po ashtu edhe biznesi i hotelarisë po avancohet përditë e më shumë dhe kështu në Komunën e Prishtinës aktualisht ekzistojnë 781 restorante dhe hotele. Në biznesin e ndërmjetësisë financiar veprimtarinë e tyre e zhvillojnë 26 biznese, ndërsa në shërbimin e afarizmit ekzistojnë 273 biznese. Administrimi publik dhe mbrojtja e sigurimit social vepron me 10 biznese, ndërsa mbrojtja shëndetësore e sociale me 104 veprimtari. Numri i përgjithshëm i biznesit në Komunën e Prishtinës është 8.412 sish. Në Komunën e Prishtinës ekzistojnë edhe 57 prona shoqërore me 143 biznese shoqërore. Kështu, numri i përgjithshëm i biznesit të regjistruar në Komunën e Prishtinës është 8.735 biznese më 75.089 punëtorë

Sipas Agjencionit të Statistikave të Kosovës, Prishtina ka 227,466¹⁴ banorë. Femra janë 114 882, meshkuj 112 584 Popullsia e Prishtinës ka shënuar rritje prej 9% që nga regjistrimi i popullsisë më 2011. Prishtina është një ndër komunat me densitet mesatarisht të lartë të popullsisë (rreth 385 banorë për kilometër katrorë).

Sa i përket kategorisë së shpenzimeve, pjesa më e madhe e buxhetit të Komunës së Prishtinës shpenzohet për paga dhe mëditje (35%). 22% e buxhetit ndahet për investime kapitale. Kjo shënon rënie të madhe nga vitet e mëhershme kur për investime kapitale është ndarë 51% e buxhetit total.

Më se 1.3% e banorëve të Prishtinës janë në skemën e ndihmës sociale. Numri i nxënësve në Komunën e Prishtinës ka shkuar duke rënë, por kjo rënie (-13%) është relativisht e ulët në krahasim me komunat tjera.

¹³ <https://prishtina.rks-gov.net/historiku/>

¹⁴ https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata__Census%20population__6_Sipas%20vendbanimeve__19%20Popullsia%20e%20komun%20c3%ab%20Prishtin%20c3%ab%20sipas%20vendbanimit/PopSex19.px/table/tableViewLayout1/

Në Komunën e Prishtinës janë aktive mbi 31,000 biznese. Në sektorin privat në Komunën e Prishtinës janë të punësuar 205 mijë persona, kurse në sektorin publik (pa llogaritur nivelin qendror) 4.600 persona.

Bazuar në regjistrimin e fundit të popullsisë në Kosovë, në vitin 2024, Prishtina kishte 227,466 banorë.

Popullsia e Komunës së Prishtinës – Regjistrimi 2024¹⁵

Komuniteti / Gjinia	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Shqiptarë	112,584	114,882	227,466
Serbë	770	—	770
Boshnjakë	356	—	356
Turq	2,138	—	2,138
Romë	57	—	57
Ashkali	427	—	427
Balkan Eryptians (Egyptianë)	17	—	17
Goranë	188	—	188
Tjerë	515	—	515
Gjithsej	—	—	231 934

Institucionet kryesore të shtetit, Presidenca, Qeveria, Kuvendi, ministrinë, Banka Qendrore, etj., edhe fizikisht edhe administrativisht gjenden në Prishtinë, gjë që e bën Prishtinën të jetë më e populluar dhe të ketë mbingarkesë në aspektin e ofrimit të shërbimeve, në të gjitha fushat. Buxheti, për komunën e Prishtinës, për vitin 2026 është i planifikuar në rreth 151 milion euro¹⁶.

Ekonomia

Në korrik të vitit 2021 në Komunën e Prishtinës ishin aktive 30,761 biznese. Përkundër pandemisë, numri i bizneseve në këtë komunë ka shkuar duke u rritur. Në sektorin privat në Komunën e Prishtinës janë të punësuar rreth 206,000 persona. Kjo tregon se bizneset që funksionojnë në Komunën e Prishtinës kryesisht janë biznese të mesme, që punësojnë një deri shtatë persona. Përveç, 206,000 të punësuarve në sektorin privat në territorin e Komunës së Prishtinës, në sektorin publik në këtë komunë janë të punësuar edhe 4,605 persona. Në anën tjetër, numri i kontribut paguesve aktiv nga Prishtina në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trust) është dukshëm më i vogël se sa numri i të punësuarëve. Kjo tregon që në Prishtinë punojnë shumë qytetarë të komunave tjera, për shkak se Prishtina është edhe selia e institucioneve qendrore qeverisëse.

¹⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës

¹⁶ Buxheti i Republikës së Kosovës 2025

Mirëqenia Sociale

Komuna e Prishtinës është ndër komunat që e ka ndarë Drejtorinë e Mirëqenies Sociale nga ajo e Shëndetësisë. Skema e ndihmës sociale në Qershor të vitit 2025 ishin 790 familje me rreth 3 000 anëtarë të familjeve nga Prishtina në skemën e ndihmës sociale.

Sipas raportit të QPS, Prishtinë për vitin 2024, në këtë institucion që ka tri njësi, janë ofruar 64 shërbime të ndryshme, për 49 kategori grupesh të cenushme, për gjithsej 23 088 shërbime sociale dhe 1415 shërbime administrative.

Për mirëqenien sociale në Komunën e Prishtinës institucionet primare janë:

1. Drejtoria për Mirëqenie Sociale dhe
2. Qendra për Punë Sociale
3. Shtëpia për të moshuarit pa përkujdesje familjare

Ndërsa, Qendra për Punë Sociale (QPS) është institucioni kryesor për ofrimin e shërbime sociale në Komunën e Prishtinës, si kryeqytet Prishtina ka edhe një numër të konsiderueshëm të OJQ-ve të licencuara, të cilat ofrojnë shërbime për kategori të ndryshme të personave dhe komuniteteve në nevojë. Me theks të veçantë duhet të përmenden strehimoret për viktimat e dhunës në familje, dhe viktimave të trafikimit me qëndrim rezidencial, si dhe organizatat tjera që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara.

Metodologjia

Hartimi i Planit të Veprimit për Shërbimet Sociale në Komunën e Prishtinës është zhvilluar në përgjigje të nevojës për të forcuar sistemin lokal të mirëqenies sociale dhe për të garantuar mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të grupeve në nevojë. Procesi është udhëhequr nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (Departamenti për Politika Sociale dhe Familje), si dhe me mbështetjen e një konsulenti të jashtëm nga SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë.

Ky dokument është ndërtuar mbi bazën e Kornizës së Planifikimit Strategjik të Republikës së Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit. Ky udhëzim siguron një qasje të unifikuar institucionale dhe procedural për zhvillimin e politikave publike, duke promovuar gjithë përfshirje, koordinim ndër sektorial dhe orientim drejt rezultateve.

Metodologjia e ndjekur ka qenë gjithëpërfshirëse dhe e ndërtuar mbi katër shtylla kryesore:

1. Kërkimi dhe analiza legjislative dhe politike – janë shqyrtuar aktet ligjore dhe nënligjore relevante, si dhe dokumentet strategjike ekzistuese në fushën e mbrojtjes sociale dhe të drejtave të grupeve të marginalizuara.

2. Konsultimi institucional dhe ndër sektorial – janë zhvilluar takime të rregullta me grupin punues ndërinstitucional, i cili përbëhet nga përfaqësues të nivelit qendror dhe lokal, përfshirë Komunën e Prishtinës, Qendrën për Punë Sociale, organizata joqeveritare dhe partnerë ndërkombëtarë.
3. Angazhimi i drejtpërdrejtë i shoqërisë civile dhe komunitetit – janë organizuar punëtori dhe tryeza të hapura me aktorë nga fusha e shërbimeve sociale, përfaqësues të komuniteteve të cënueshme, si dhe organizata të specializuara në mbrojtjen e fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera në rrezik social.
4. Pjesëmarrja aktive e palëve të interesit – procesi është ndërtuar mbi parimin e bashkëpunimit dhe bashkë krijimit. Përfaqësues nga KOMF, SOS Fshatrat e Fëmijëve, HANDIKOS, OFAP, Terre des Hommes në Kosovë, YMCA Kosovo, MVPT, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe organizata të tjera kanë dhënë kontribut të drejtpërdrejtë në përkufizimin e prioriteteve dhe masave të ndërhyrjes.

Kjo qasje e integruar dhe gjithëpërfshirëse ka siguruar që Plani i Veprimit të jetë jo vetëm dokument strategjik, por edhe reflektim i nevojave reale në terren, duke garantuar që politikat e miratuara të jenë sociale në përmbajtje, të zbatueshme në praktikë dhe të ndjeshme ndaj dinamikave të komunitetit.

Konteksti Strategjik

Plani i Veprimit për Shërbime më të mira Sociale në Komunën e Prishtinës është konceptuar si një zgjatim operacional i objektivave të legjislacioni primar dhe sekondar, i zhvilluar në përputhje me realitetin social dhe institucional të kryeqytetit. Ky plan merr parasysh sfidat në rritje që ka para vetes Komuna e Prishtinës, si pasojë e dinamikës demografike, migrimit të brendshëm, emigrimit të vazhdueshëm të të rinjve, si dhe shtimit të rasteve sociale dhe dukurive të ndërlydhura me to, përfshirë varfërinë, dhunën në familje, abuzimin me substanca dhe përjashtimin social.

Në dy dekadat e fundit, Prishtina ka përjetuar një rritje të shpejtë të popullsisë, për shkak të migrimit të brendshëm nga komunat e tjera të Kosovës, çka ka rezultuar në rritje të kërkesave për shërbime publike dhe, në veçanti, për shërbime sociale. Kjo rritje, e kombinuar me tendencën në rritje të emigrimit të të rinjve dhe familjeve të tëra në vendet perëndimore, ka krijuar një boshllëk në fuqinë punëtore dhe një presion shtesë mbi mekanizmat ekzistues të mbështetjes sociale.

Për më tepër, kapacitetet institucionale për përballje me këto sfida kanë mbetur të kufizuara. Qendra për Punë Sociale në Prishtinë, si institucioni kryesor për zbatimin e politikave të mirëqenies sociale në nivel lokal, vazhdon të përballlet me mungesë të stafit profesional, mbingarkesë me raste dhe resurse të pamjaftueshme për të ofruar shërbime gjithëpërfshirëse dhe cilësore.

Si pjesë e përgjigjes ndaj këtyre zhvillimeve, ky Plan Veprimi synon jo vetëm adresimin e sfidave ekzistuese, por edhe ndërtimin e kapaciteteve të qëndrueshme në fushën e shërbimeve sociale. Kjo përfshin forcimin e rolit të Qendrës për Punë Sociale, ngritjen profesionale të punonjësve socialë, si dhe përfshirjen aktive të organizatave të shoqërisë civile dhe ofruesve të tjerë të licencuar të shërbimeve në nivel komunitar.

Konteksti Ligjor

Sistemi i mbrojtjes dhe përfshirjes sociale në Republikën e Kosovës bazohet në një kornizë të gjerë ligjore, e cila është ndërtuar gradualisht në dy dekadat e fundit në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare për të drejtat sociale. Ky sistem synon të garantojë qasjen e qytetarëve në shërbime sociale cilësore, të përcaktojë përgjegjësitë institucionale dhe të promovojë mbrojtjen e grupeve të cenueshme.

Ligjet dhe aktet nënligjore mbulojnë një spektër të gjerë të fushave – nga mbrojtja e fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, viktimave të dhunës dhe trafikimit me qenie njerëzore, deri te të drejtat e azilkërkuesve, personave pa shtetësi dhe të huajve. Po ashtu, korniza ligjore rregullon çështje të drejtësisë për të mitur, shëndetit mendor, statusit dhe përkujdesjes për persona paraplegjikë e tetraplegjikë, si dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore. Një rol të rëndësishëm luajnë edhe udhëzimet administrative dhe rregulloret e Qeverisë, të cilat detajojnë procedurat për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve, funksionimin e qendrave për mbrojtje dhe rehabilitim, si dhe standardet për strehim e përkujdesje.

Kjo kornizë është pjesërisht e harmonizuar me Acquis Communautaire të BE-së dhe pasqyron parimet e Kartës Sociale Evropiane dhe Konventës për të Drejtat e Fëmijës. Ajo ofron bazën juridike për funksionimin e shërbimeve sociale edhe në nivel lokal, përmes marrëveshjeve ndër-institucionale që përcaktojnë rolin e komunave, përfshirë Komunën e Prishtinës, në zbatimin praktik të tyre.

Megjithëse legjislativi është gjithëpërfshirës, sfida kryesore mbetet implementimi. Mungesa e burimeve financiare, kapaciteteve profesionale dhe mekanizmave të fortë të monitorimit pengon zbatimin efektiv të ligjeve. Kjo situatë nënvizon nevojën për forcimin e institucioneve, përmirësimin e koordinimit ndër sektorial dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik për të drejtat sociale. Në këtë kuptim, Komuna e Prishtinës ka mundësi të zhvillojë plane veprimi më konkrete e të integruara, duke u mbështetur në këtë bazë ligjore për të ofruar shërbime sociale të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për qytetarët e saj.

Analiza e gjendjes në nivel vendi

Në nivel vendi, sistemi i mbrojtjes dhe përfshirjes sociale në Republikën e Kosovës vazhdon të përballet me sfida të thella dhe të vazhdueshme që prekin drejtpërdrejt jetën e qytetarëve, veçanërisht të atyre që i përkasin grupeve më të cenueshme, si familjet në varfëri, fëmijët pa përkujdesje prindërore, gratë viktime të dhunës, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet në rrezik social.

Rezoluta e Parlamentit Evropian B7-0004/2014 për procesin e integritimit të Kosovës në BE ka theksuar shqetësime të thella në lidhje me përhapjen e varfërisë, mbulimin e kufizuar të shërbimeve të mbrojtjes sociale dhe varësinë e lartë nga shpenzimet vetjake për kujdes shëndetësor. Raporti bën thirrje për rishikim të politikave të ndihmës sociale, me fokus të veçantë në mbrojtjen e fëmijëve dhe grupeve të tjera të marginalizuara, përmes krijimit të skemave të posaçme mbështetëse.

Në Kosovë, përgjegjësia për politikë bëjnë dhe ofrim të shërbimeve sociale është e ndarë ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal. Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës

Çlirimtare (MPFVLÇ) përmes Departamentit për Politika Sociale dhe Familje ka pasur historikisht rolin udhëheqës në zhvillimin e politikave të mbrojtjes sociale dhe mbikëqyrjen e sistemit. Kjo ministri ka marrë përgjegjësinë për institucionalizimin, licencimin dhe mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve sociale profesionale, përfshirë strehimoret, qendrat për viktimat e trafikimit dhe institucionet për mbrojtjen e fëmijëve në situata të rrezikut.

Ky zhvillim ka për qëllim të rrisë llogaridhënien, profesionalizmin dhe sigurinë ligjore të shërbimeve të specializuara në mbrojtjen sociale dhe penale, si dhe të sigurojë koordinim më të mirë ndërmjet sistemit të drejtësisë dhe atij social në trajtimin e rasteve të ndjeshme.

Nga ana tjetër, në nivel lokal, ofrimi i shërbimeve sociale vazhdon të jetë përgjegjësi e komunave, përmes Drejtorive Komunale për Mirëqenie Sociale dhe Qendrave për Punë Sociale (QPS), bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të vitit 2009 ndërmjet MAPL, MF dhe MPMS. QPS-të mbajnë një rol qendror në identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e rasteve sociale dhe familjare në komunitet.

Megjithëse decentralizimi i shërbimeve synonte të përmirësonte qasjen dhe efikasitetin, përvoja në praktikë tregon se komunat nuk janë pajisur me burime të mjaftueshme, qoftë financiare, profesionale apo infrastrukturore, për të realizuar mandatin e tyre në mënyrë të plotë. Kjo ka çuar në mbingarkesë të QPS-ve, mungesë të punonjësve socialë të kualifikuar, ndërprerje të shërbimeve në raste kritike dhe rrezik për cenimin e të drejtave të përfituesve.

Për më tepër, dukuritë sociale negative si emigrimi masiv i të rinjve, rritja e dhunës në familje, abuzimi me substanca dhe marginalizimi i fëmijëve dhe të moshuarve pa përkujdesje adekuate e thellojnë nevojën për një qasje sociale të koordinuar dhe të shumëfishtë. Kjo kërkon jo vetëm forcim të kuadrit institucional dhe ligjor, por edhe ndërtim të vazhdueshëm të kapaciteteve humane dhe profesionale në çdo nivel të ofrimit të shërbimeve.

Në këtë kontekst, rritja e bashkëpunimit ndërinstucional, veçanërisht ndërmjet MPFVLÇ, Ministrisë së Drejtësisë, MAPL, MF, komunave dhe organizatave të shoqërisë civile, është kyçe për të krijuar një sistem të qëndrueshëm dhe të drejtë të mbrojtjes sociale në Republikën e Kosovës.

Papunësia

Tregu i punës në Kosovë karakterizohet nga një shkallë të ndërthurur të papunësisë së lartë, aktivitetit të ulët ekonomik dhe pabarazive të theksuara gjinore – që reflektohen edhe në nivelin lokal, duke përfshirë Komunën e Prishtinës.

Sipas të dhënave të fundit (TM4 2024) nga ASK, në:

- 12,9% – ishte shkalla e papunësisë së përgjithshme (për të gjithë popullsinë 15+), duke u rritur me 0.2 pikë përqindjeje krahasuar me TM4 2023¹⁷.
- 7,7% – shkalla e papunësisë për meshkujt dhe 17,6% për femrat, duke nxjerrë në pah një pabarazi konkurrimi gjinor.
- 18,4% – ishte shkalla e papunësisë të të rinjtë (15–24 vjeç), një ulje modeste nga 16.7% në vitin paraprak, por që vazhdon të mbetet në nivele të larta.

¹⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës

- 38,8% – ishte shkalla e punësimit (15–64 vjeç) dhe 56,4% fuqia joaktive, tregues ky i uljes së pjesëmarrjes aktive në tregun e punës.

Planifikimet kryesore:

- Papunësia vazhdon të mos zbrësë nën nivelin 10%, me një tendencë të luhatjes së lehtë në tremujorin e fundit.
- Pabarazitë gjinore janë të ndjeshme: dyfish më shumë femra të papuna sesa meshkuj (17.6% vs. 7.7%).
- Të rinjtë mbeten grup me më shumë rrezik, 1 në 5 është i papunë.
- Fuqia punëtore është ende e kufizuar: më shumë se gjysma e moshës së punës është joaktive.

Në kontekstin e Prishtinës, si kryeqendër që përqendron popullsi nga e gjithë Kosova, këto fenomene mund të jenë edhe më të theksuara për shkak të urbanizimit, emigrimit të të rinjve dhe mungesës së mundësive për punësim formal.

Shqetësimi social kryesor është se përtej papunësisë, rritet edhe fenomeni i të rinjve që nuk punojnë, nuk studiojnë e as nuk trajnohen (NEET), potencialisht duke krijuar një brezi me perspektiva të kufizuara dhe pasiguri ekonomike në të ardhmen. Gjithashtu, pabarazitë gjinore theksojnë nevojën për politika aktive për punësim dhe barazi në tregun e punës.

Ndihmat Sociale

Skema e Ndhmës Sociale është mbështetje dhe ofrim i ndihmës së përkohshme financiare për familjet që jetojnë në varfëri. Kjo Skemë rregullohet me Ligjin Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë dhe me Ligjin Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë. Pagesa mujore e përfituesve të kësaj Skeme bëhet sipas numrit të anëtarëve të familjes. Shuma minimale është 70 euro për familjet me një 1 anëtar, ndërsa shuma maksimale është 250 euro për familjet me 15 anëtarë. Për çdo fëmijë të moshës 0-16 vjeçar shpërndahen edhe shtesat për fëmijë 30 euro për fëmijët deri 2 vjeç dhe 20 euro për fëmijët deri në moshën 16 vjet, me qëllim të nxitjes së arsimimit dhe përmirësimit të shëndetit. Numri total i qytetarëve në SNS në komunën e Prishtinës për vitin 2025 ishte rreth 3000 anëtar. Numri i familjeve përfituese nga skema e ndihmës sociale, secilin vit shënon një rënie të lehtë.

Bazuar në të dhënat zyrtare, rreth 1.3% e popullatës së përgjithshme të Prishtinës janë pjesë e skemës së ndihmës sociale.

Shërbimet Sociale

Me Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr. 08/1-255, është e përcaktuar dhe rregulluar një listë e personave në nevojë për mbrojtje sociale dhe përfshin fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët me sjellje asociale, delikuent të mitur, marrëdhëniet e çrregulluara familjare, sëmundje trupore ose aftësi të kufizuara fizike, aftësi të kufizuara mendore, sëmundje mendore, rrezik nga shfrytëzimi apo abuzimi, dhuna në familje, trafikimi njerëzor, varësi nga alkooli ose droga,

fatkeqësitë natyrore ose të shkaktuara ose emergjencat, ose shkaqe të tjera që i bëjnë personat nevojtarë. Ky ligj përcakton dhe rregullon edhe roli dhe përgjegjësitë e MPFVLÇ, Komunës, QPS, Sektorit Jo-Qeveritar dhe Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Shërbimet sociale ofrohen kryesisht në nivel lokal. Komponentët kryesorë të sistemit të ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në nivel lokal përfshijnë Drejtoritë Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Qendrat për Punë Sociale (QPS), institucionet rezidenciale, si dhe rrjetin e OJQ-ve të zhvilluara për të mbështetur grupet e cenueshme.

Komuna e Prishtinës që nga viti 2021 e ka ndarë Drejtorinë për Mirëqenie Sociale (DMS) nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS). Sipas organogramit të Komunës së Prishtinës QPS-ja është renditur nën përgjegjësinë e Drejtoratit Komunal për Mirëqenie Sociale (DMS).

Buxheti i planifikuar i komunës së Prishtinës sipas kategorive ekonomike: 36% të buxhetit të përgjithshëm shpenzohet për paga dhe mëditje; 23% Mallra dhe Shërbime; 2% Shpenzime komunale; 5% Subvencione; 31% Shpenzime kapitale dhe 3% Rezerva.

Në krahasim me komunat tjera, Komuna e Prishtinës ndanë më së paku buxhet për kategorinë e pagave dhe mëditjeve, çfarë mundëson që buxheti të orientohet më shumë për investime.

Infrastruktura

Për ofrimin e shërbimeve sociale ekziston një rrjetë kombëtar i Qendrave për Punë Sociale (QPS), me pajisje fizike të dedikuara dhe staf me përvojë. Kjo paraqet një platformë të fortë mbi të cilën mund të tutje të zhvillohet dhe ndërtohet infrastruktura e ardhshme për shërbime sociale. Kjo është një përparësi pozitive për ngritjen dhe zhvillimin e shërbimeve të mira sociale në vend.

Gjithsej 38 QPS-të e shpërndara nëpër 38 komunat e Kosovës sigurojnë mbulimin gjeografik të tërë vendit. Edhe Komuna e Prishtinës ka QPS-në (me 3 njësi funksionale) që mbulon tërë territorin e komunës. QPS-të përveç tjerave, bëjnë vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve pas pranimit të kërkesës për asistencë apo shërbim sociale.

QPS është e pajisur me inventar të zyrës, pajisje kompjuterike dhe automjete për kryerjen e punëve ditore dhe shërbimeve sociale. Mirëpo me ngritjen e problemeve sociale dhe nevojës për trajtimin e çdoherë më shumë rasteve sociale, këto burime në dispozicion nuk janë të mjaftueshme dhe ka shumë disproporcion të numrit të profesionistëve që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare në krahasim me numrin e klientëve dhe kërkesave për shërbime, dhe e njëjta vlen edhe për numrin e automjeteve në dispozicion të QPS në Prishtinë. Andaj, në të ardhmen do të duhet siguruar financim më i qëndrueshëm dhe përmirësim i kësaj infrastrukture dhe mirëmbajtja e saj, në mënyrë që QPS të mund të u përgjigjet kërkesave të qytetarëve në nevojë.

Komuna e Prishtinës tani ka filluar ndërtimin e objektit të ri të Qendrës për Punë Sociale, ku planifikohet të fuzionohen tri njësitë aktuale.

Buxheti

Ligji për Financimin e Pushtetit Lokal siguron një alokim të bazuar në formulë të transfereve qendrore për të siguruar parashikueshmërinë e të ardhurave komunale, si dhe një masë barazimi mes komunave. Ky ligj i ndan transferimet në komuna në tri grante kryesore:

- një grant i përgjithshëm;
- një grant specifik për arsimin dhe
- një grant specifik për shëndetësinë.

Nga kjo ndarje buxhetore po ashtu mund të konstatohet se mënyra e përgatitjes së buxhetit bëhet ende në mënyre historike dhe jo e bazuar në nevojat reale.

Burimet Njerëzore

Në tërë territorin e Kosovës, QPS-të punësojnë një numër prej 411 punëtorëve. Në QPS Prishtinë janë të punësuar 18 zyrtar të shërbimeve sociale, një psikolog, tre shefa të njësive, ë udhëheqës të shërbimeve sociale profesionale, tre udhëheqës të skemës së ndihmës sociale, katër zyrtarë në administratë dhe arkiva. Staf i QPS-së në përgjithësi ka përvojë administrative nga pesë deri në dhjetë vjet dhe ekspertizë në ofrimin e shërbimeve sociale. Sidoqoftë, për shkak se shumë njerëz janë të mbingarkuar me detyra të shumëllojshme, nevojitet planifikim i mëtejshëm i burimeve njerëzore dhe staf shtesë. Përpos nevojës për ngritjen e numrit të punëtorëve social, qoftë duke rritur numrin në QPS, qoftë duke punësuar punëtor social përmes formës së kontraktimit të shërbimeve është më se e nevojshme që punëtorët social të trajnohen dhe të profilizohen për shërbime më të mira sociale.

Bashkëpunimi

Në punën e tyre të përditshme, punëtorët social dhe Qendrat për Punë Sociale bashkëpunojnë përpos me palët e tyre, edhe me shumë akter tjerë të përfshirë në çështjet e palëve të ndërlidhura me QPS, siç janë edhe OJQ-të, organizatat e ndryshme si dhe bashkëpunon ngushtë me Policinë e Kosovës, Prokurorinë dhe Gjykatën.

Vizioni i planit të veprimit për shërbime sociale

Vizioni ynë është ndërtimi i një sistemi të shërbimeve sociale gjithëpërfshirëse, të barabarta, të arritshme dhe të qëndrueshme, që reflekton nevojat reale të qytetarëve dhe komuniteteve në Komunën e Prishtinës. Ky sistem do të ofrojë shërbime të ndjeshme ndaj individit, të bazuara në të drejtat e njeriut, solidaritet dhe dinjitet, nëpërmjet një qasjeje bashkëpunuese ndërmjet institucioneve publike, sektorit joqeveritar dhe vetë përfituesve të shërbimeve sociale.

Objektivat Strategjikë

- Bashkëpunim i ngushtë me komunitetin lokal;
- Fokus në parandalim dhe ndërhyrje të hershme;
- Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve;
- Ofrim i shërbimeve sa më afër qytetarëve, përfshirë edhe në shtëpi;

- Zhvillim i kapaciteteve profesionale të punëtorëve socialë;
- Krijimi i një sistemi të integruar dhe të monitoruar mirë.

Vlerat Themelore

Vlera	Përshkrimi
Respekti	Shërbimet mbështeten në dinjitetin dhe vlerën e çdo individi.
Partneriteti	Bashkëpunim i ndërsjellë me akterët institucionalë dhe komunitetin.
Llogaridhënia	Transparencë, përgjegjësi dhe etika në ofrim dhe mbikëqyrje.
Drejtësia Sociale	Qasje e barabartë për të gjithë, pa diskriminim.
Ambicia Sociale	Përkushtim për përmirësim të vazhdueshëm dhe rezultate të larta.

Shtyllat tematike të ndërhyrjes

1. Parandalimi
2. Përkrahja
3. Intervenimi i Hershëm
4. Mbrojtja
5. Përkujdesja
6. Monitorimi, Vlerësimi dhe Kontrolli

Misioni i planit të veprimit për shërbime sociale

Misioni i këtij Plani të Veprimit është të ndërtojë dhe forcojë një sistem të shërbimeve sociale dhe familjare që është i drejtë, gjithëpërfshirës dhe njerëzor, i cili i respekton dhe fuqizon qytetarët më të cenusshëm të shoqërisë, përfshirë fëmijët, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, gratë, dhe komunitetet në rrezik, pa asnjë lloj diskriminimi gjinor, etnik apo socio-ekonomik.

Ky mision synon të garantojë qasje të barabartë dhe në kohë në shërbime sociale, aty ku nevojiten më shumë, duke vënë në qendër dinjitetin njerëzor, parandalimin e marginalizimit dhe promovimin e të drejtave themelore për çdo individ.

Përmes këtij Plani, synohet:

- Bashkërendimi efektiv i veprimeve ndërmjet Qendrës për Punë Sociale (QPS), institucioneve komunale dhe partnereve të shoqërisë civile;
- Zbutja e varfërisë dhe përjashtimit social;
- Promovimi i drejtësisë sociale, barazisë dhe të drejtave të njeriut;
- Parandalimi dhe trajtimi i dukurive sociale si dhuna në familje, braktisja e shkollës, delikuenca e të rinjve, keqtrajtimi i fëmijëve dhe neglizhenca ndaj të moshuarve;
- Fuqizimi i punonjësve socialë dhe ofruesve të shërbimeve për të ofruar ndërhyrje profesionale, humane dhe të bazuara në nevoja reale.

Për ta realizuar këtë mision, Komuna e Prishtinës angazhohet të:

- Ndërtojë kapacitete institucionale të qëndrueshme;
- Sigurojë burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare;
- Konsolidojë partneritetin ndërmjet sektorit publik, OJQ-ve dhe komunitetit;
- Zbatojë mekanizma të qartë për monitorim, vlerësim dhe llogaridhënie në shërbimet sociale.

Ky plan është një thirrje për veprim, bashkëpunim dhe transformim të qëndrueshëm, që synon të kthejë sistemin e mbrojtjes sociale në një shtyllë thelbësore të mirëqenies komunitare dhe dinjitetit njerëzor në Prishtinë.

Objektivat Strategjike të Planit të Veprimit për Shërbime Sociale

Në përgjigje të sfidave aktuale sociale, administrative dhe institucionale me të cilat përballen shërbimet sociale në Komunën e Prishtinës, janë përcaktuar katër objektiva kryesore strategjike, të shoqëruara me nën-objektiva konkrete, që synojnë forcimin e sistemit të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale për të gjitha grupet e cenusshme.

Objektivi 1: Ofrimi i shërbimeve të integruara dhe gjithëpërfshirëse për grupet e cenusshme

Ky objektivi synon zhvillimin e një qasjeje ndër sektoriale për ofrimin e shërbimeve që përfshijnë bashkërendim midis arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, për një përgjigje të koordinuar dhe të efektshme.

Commented [RK1]: Te lutem objektivat kryesore te vendosen ne plan- materix para objektivave specifike

Nën-objektiva:

- 1.1 Shërbime të integruara për fëmijët në situatë rreziku dhe për familjet e tyre;
- 1.2 Zhvillimi i shërbimeve të përshtatura për të moshuarit në komunitet;
- 1.3 Ofrimi i masave parandaluese për fëmijët, të rinjtë dhe të moshuarit në rrezik social.

1. Zhvillimi i programeve dhe shërbimeve parandaluese
2. Shërbime të integruara cilësore për qytetarët në nevojë sociale
3. Shërbime të integruara për të moshuarit

Commented [RK2]: Keto objektiva te hijezuara jane sipas planit.

Objektivi 2: Mbështetje gjithëpërfshirëse për personat me aftësi të kufizuara dhe forma alternative të përkujdesjes

Ky objektivi ka për qëllim fuqizimin e shërbimeve të posaçme për personat me aftësi të kufizuara, duke promovuar përfshirjen e tyre në shoqëri dhe mbështetjen e formave të mbrojtjes alternative për fëmijët pa përkujdesje prindërore.

Nën-objektiva:

- 2.1 Zhvillimi i shërbimeve për të rritur me aftësi të kufizuara;
- 2.2 Ofrimi i shërbimeve cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- 2.3 Rritja e mirëqenies sociale për të gjitha grupet në nevojë, përmes qasjeve gjithëpërfshirëse;
- 2.4 Nxitja dhe përkrahja e modeleve të strehimit familjar si alternativë ndaj institucionalizimit.
4. Shërbime të integruara për personat me aftësi të kufizuara
5. Zhvillimi i banimit social

Commented [RK3]: Keto objektiva te hijezuara jane sipas planit ne matrix

Objektivi 3: Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe modernizimi teknologjik i shërbimeve

Ky objektivi ka për qëllim të avancojë cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve sociale përmes investimit në burimet njerëzore dhe infrastrukturë teknologjike.

Nën-objektiva:

- 3.1 Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve profesionale, materiale dhe infrastrukturore të QPS-ve;
- 3.2 Krijimi dhe mirëmbajtja e bazave të të dhënave digjitale për përfituesit dhe rastet;
- 3.3 Themelimi i një njësie për telekëshillim dhe këshillim online, për të përmirësuar qasjen në shërbime në distancë.
7. Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, materiale e infrastrukturore
8. Digjitalizimi i bazës së të dhënave

Commented [RK4]: Keto objektiva jane ne plan- matrix

Objektivi 4: Sigurimi i strehimit të mbrojtur për grupet në nevojë

Objektivi synon të garantojë qasje të barabartë në strehim të sigurt dhe të përshtatshëm për grupet më të cënueshme të shoqërisë, në përputhje me standardet për mbrojtje dhe dinjitet njerëzor.

Nën-objektiva:

- 4.1 Ofrimi i strehimit emergjent dhe afatshkurtër për gratë dhe fëmijët viktime të dhunës në familje;
- 4.2 Strehimi i përkohshëm për fëmijët në nevojë për mbrojtje;
- 4.3 Krijimi i shtëpive me bazë në komunitet për të moshuarit (strehim afatgjatë);
- 4.4 Zhvillimi i strehimoreve të dedikuara për komunitetin LGBTIQ+;
- 4.5 Sigurimi i qëndrueshmërisë për strehimoren e viktimave të trafikimit;
- 4.6 Mbështetja për strehimin e përkohshëm dhe të përshtatur për fëmijët pa përkujdesje familjare.

Commented [RK5]: Kjo objektive nuk eshte e paraqitur ne plan!

Për shërbime më cilësore sociale

Shërbimet sociale janë themeli i një shoqërie të drejtë dhe të përfshirë. Ato përfaqësojnë një ndërhyrje të strukturuar për të mbështetur individët, familjet dhe komunitetet në përballje me sfida të ndryshme sociale, ekonomike dhe psikologjike. Përmes këtyre shërbimeve synohet jo vetëm zbutja e varfërisë dhe marginalizimit, por edhe promovimi i barazisë, dinjitetit dhe pjesëmarrjes aktive në jetë publike.

Këto shërbime i drejtohen një game të gjerë përfituesish:

- fëmijëve me aftësi të kufizuara,
- të miturve në rrezik,
- grave dhe fëmijëve viktime të dhunës në familje,
- të rinjve dhe të rriturve me varësi nga substancat,
- personave me sëmundje kronike,
- të moshuarve pa përkujdesje familjare,
- fëmijëve pa kujdes prindëror,
- personave në konflikt me ligjin,
- viktimave të trafikimit dhe abuzimeve seksuale,
- dhe kategorive të tjera në rrezik social.

Roli i punonjësve socialë

Punonjësit socialë janë në pararojë të mbrojtjes sociale, duke mbështetur çdo ditë individët më të cënueshëm të shoqërisë. Ata nuk janë vetëm zbatues të shërbimeve, por janë edhe mbrojtës të të drejtave të njeriut, ndërmjetësues të paqes sociale dhe faktorë kyç për fuqizimin e individëve në komunitet.

Me profesionalizëm dhe ndjeshmëri, ata përballen me situata komplekse që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, vendimmarrje të ndërlikuara dhe balancim të interesit të individit me atë të sigurisë publike. Ata mbrojnë fëmijët nga abuzimi, përkrahin familjet në krizë, ndihmojnë të moshuarit që jetojnë të vetmuar dhe fuqizojnë gratë që dalin nga dhuna.

Sfidat aktuale në ofrimin e shërbimeve sociale

Pavarësisht rolit të tyre kritik, shërbimet sociale në Kosovë – dhe posaçërisht në nivelin komunal, përballen me sfida të mëdha strukturore.

Këto sfida përfshijnë:

- Decentralizim i paqartë dhe i pa konsoliduar, që ka shkaktuar ngatërresa në ndarjen e përgjegjësiave ndërmjet nivelit qendror dhe lokal;
- Mungesë e burimeve të qëndrueshme financiare, që e pengon ofrimin e shërbimeve bazë për grupet më në nevojë;
- Mungesë e punonjësve socialë të kualifikuar, shpesh me ngarkesë të madhe pune dhe pa përkrahje profesionale të mjaftueshme;
- Vëmendje e pamjaftueshme institucionale, ku puna sociale nuk shihet si përparësi politike dhe nuk promovohet në mënyrë të qëndrueshme;
- Mungesa e strehimeve të sigurta dhe mbrojtëse për viktimat e dhunës, trafikimit apo fëmijët në situata emergjente.

Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në pamundësinë për të garantuar mbrojtje efektive dhe të barabartë për të gjithë qytetarët, veçanërisht për ata që jetojnë në margjinat sociale dhe ekonomike të shoqërisë.

Çfarë kërkohet për përmirësim?

- Rritje e përkushtimit institucional dhe politik për investime në mirëqenie sociale;
- Zhvillim i një kuadri të qartë funksional ndërmjet nivelit lokal dhe qendror;
- Rritje e kapaciteteve profesionale dhe kushteve të punës për punonjësit socialë;
- Zgjerim i infrastrukturës për strehim dhe kujdes të specializuar për grupet më të rrezikuara;
- Forcim i partneritetit ndërmjet institucioneve, OJQ-ve dhe komunitetit për një qasje më gjithëpërfshirëse dhe efektive.

Për buxhetim efektiv dhe infrastrukturë të përshtatshme për Shërbime Sociale dinjitoze Ndërsa përgjegjësitë për ofrimin e shërbimeve sociale janë transferuar në nivelin komunal, mbështetja financiare për realizimin e këtyre përgjegjësiave ka qenë e pamjaftueshme, duke krijuar një boshllëk të madh ndërmjet nevojave të qytetarëve dhe kapacitetit real të Qendrave për Punë Sociale (QPS) për t'iu përgjigjur këtyre nevojave.

Mungesa e buxhetimit adekuat dhe të qëndrueshëm për QPS-të prek drejtpërdrejt cilësinë, qasjen dhe ndikimin e shërbimeve sociale, veçanërisht për grupet më të cenueshme si fëmijët, gratë në situata të dhunës, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit pa përkujdesje. Shërbimet janë të fragmentuara, shpesh të vonuara, dhe jo të mjaftueshme për të adresuar në mënyrë të denjë emergjencat sociale me të cilat përballen qytetarët.

Punonjësit socialë në QPS-të përballen çdo ditë me sfida të rënda operacionale:

- Detyrohen të mbulojnë shpenzime nga xhepi i tyre, si për ushqim apo produkte higjienike për përfituesit në raste emergjente;
- Marrin pjesë në vizita në terren me vështirësi për transport, pa kompensim për kohën ose rreziqet që bartin;
- Përballen me rrezik për mirëqenien e tyre personale, veçanërisht në raste që përfshijnë dhunë familjare, abuzim me substanca, ose largim të fëmijëve nga familja;
- Nuk kanë mbështetje të mjaftueshme për zhvillim profesional të vazhdueshëm, licencim apo trajnime të specializuara në fusha kritike si trauma, mbrojtja e fëmijëve dhe ndërhyrjet në krizë.

Për më tepër, mungesa e investimeve në infrastrukturë, si ambiente pune të sigurta dhe të pajisura, sisteme digjitale funksionale, dhe logjistikë për shërbime në terren, e bën edhe më të vështirë realizimin e misionit të mbrojtjes sociale në mënyrë profesionale dhe njerëzore.

Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare

Punonjësit socialë janë shtylla themelore e sistemit të mbrojtjes sociale, duke punuar çdo ditë me individët dhe familjet më të cenueshme në shoqëri. Ata promovojnë të drejtat, barazinë dhe pavarësinë, ndërsa ndërhyjnë në situata të ndërlikuara që prekin mirëqenien e fëmijëve, të rriturve, të moshuarve, dhe personave me aftësi të kufizuara.

Si mbrojtës të drejtpërdrejtë të interesit më të mirë të fëmijës, të mbijetuarve të dhunës, apo viktimave të trafikimit, punonjësit socialë janë në vijën e parë të ndërhyrjes dhe mbrojtjes, shpeshherë në rrethana të rrezikshme, stresuese dhe emocionalisht të ngarkuara. Për këtë arsye, puna e tyre kërkon jo vetëm kompetenca profesionale, por edhe mbështetje të strukturuar dhe të vazhdueshme institucionale.

Sfidat që kufizojnë fuqizimin profesional të punonjësve socialë:

- Mungesa e vëmendjes institucionale dhe përkushtimit politik, që reflektohet në mungesën e buxhetit të dedikuar për zhvillim profesional dhe përmirësim të kushteve të punës;
- Numër i pamjaftueshëm i stafit në QPS, që bën që një punonjës social të menaxhojë shumëfishin e rasteve të rekomanduara nga standardet minimale profesionale;
- Nevoja e thellë për staf të specializuar, përfshirë psikologë, sociologë, zyrtarë ligjorë, pedagogë, dhe personel mbështetës si shoferë dhe ndihmës teknikë;
- Mungesë e trajnimeve të strukturuar dhe mbikëqyrjes profesionale, që pengon zhvillimin cilësor të praktikës sociale dhe rritjen e kapaciteteve për trajtimin e rasteve komplekse.

Qasja e rekomanduar për zhvillim të qëndrueshëm të kapaciteteve:

Për të adresuar këto sfida, është përcaktuar një objektivi specifik brenda Planit të Veprimit që synon:

- Ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore në QPS dhe strukturat e tjera ofruese të shërbimeve;
- Rekrutimin e stafit të ri me profile profesionale të nevojshme, në përputhje me standardet ndërkombëtare të shërbimeve sociale;
- Ofrimin e trajnimeve të detyrueshme dhe të vazhdueshme për të gjitha kategoritë e stafit, me fokus në ndërhyrje të bazuar në prova, qasje të ndjeshme gjinore dhe të drejtat e njeriut;
- Krijimin e njësive për mbikëqyrje dhe këshillim profesional, për të siguruar që puna sociale të jetë jo vetëm teknike, por edhe e reflektuar dhe etike;
- Nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet komunës, shoqërisë civile, universiteteve dhe partnerëve ndërkombëtarë për të ndërtuar një ekosistem të qëndrueshëm zhvillimi profesional për punonjësit socialë.

Treguesit për matjen, monitorimin dhe vlerësimin e progresit në ngritjen e kapaciteteve profesionale janë të përfshirë në Kornizën e Treguesve të Performancës, në fund të këtij dokumenti, dhe do të përdoren për të siguruar transparencë, përgjegjësi dhe progres të matshëm në ndërtimin e një shërbimi social dinjitoz dhe të besueshëm për qytetarët e Komunës së Prishtinës.

Monitorimi i Zbatimit të Planit të Veprimit për Shërbime Sociale

Për të qenë efektiv dhe me ndikim të qëndrueshëm, procesi i planifikimit dhe zbatimit të shërbimeve sociale kërkon një sistem të mirëfilltë të monitorimit dhe vlerësimit. Monitorimi nuk është thjesht një aktivitet teknik – ai është një mjet kyç për llogaridhënie sociale, transparencë institucionale dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve që u ofrohen qytetarëve.

Në kuptimin më të gjerë, monitorimi përfshin mbledhjen sistematike dhe të rregullt të të dhënave, analizimin e rezultateve dhe përdorimin e tyre për të ndjekur progresin kundrejt objektivave të planit të veprimit, për të identifikuar ngeçjet, për të zbuluar modelet e performancës dhe për të siguruar që veprimet të përputhen me standardet ligjore, profesionale dhe etike.

Sfidat dhe nevoja për një sistem të sofistikuar të monitorimit social

Aktualisht, një nga sfidat kryesore në ofrimin e politikave sociale cilësore është mungesa e një sistemi funksional, gjithëpërfshirës dhe të informatizuar të monitorimit dhe vlerësimit. Mungesa e të dhënave të qëndrueshme, të krahasueshme dhe të analizuueshme e bën të vështirë përcaktimin e ndikimit real të masave sociale.

Pa monitorim të strukturuar dhe të përdorshëm, vështirësohet:

- të matet ndikimi i ndërhyrjeve sociale në jetën e qytetarëve,

- të përcaktohet nëse burimet janë përdorur në mënyrë të drejtë dhe efektive,
- të evidentohet cilësia e ulët e shërbimeve dhe të ndërmerren masa për përmirësim,
- të sigurohet angazhim më i mirë i stafit për të reflektuar mbi punën e tyre dhe për të mësuar nga praktikatat.

Masa konkrete për ngritjen e një sistemi efektiv të monitorimit:

Për të ndërtuar një sistem të qëndrueshëm, të thjeshtë për përdoruesit dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare për menaxhimin e performancës sociale, do të ndërmerren këto hapa:

- Themelimi i Grupit të Monitorimit për zbatimin e Planit të Veprimit, me përfaqësim ndërsektorial dhe ndërinstytucional;
- Organizimi i takimeve të rregullta tre-mujore të grupit monitorues për të shqyrtuar progresin dhe adresuar çështjet prioritare;
- Përpilimi i raporteve të monitorimit, me fokus në:
 - rezultate konkrete dhe të matshme,
 - vlerësimin e zbatueshmërisë së masave,
 - evidentimin e sfidave dhe vonesave,
 - propozime për rregullime dhe hapat e ardhshëm;
- Zhvillimi i një platforme të digjitalizuar për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, që do të mundësojë krahasime ndër vite dhe monitorim të vazhdueshëm në kohë reale;
- Përfshirja e zërit të qytetarëve dhe përfituesve në procesin e vlerësimit të shërbimeve, përmes mekanizmave të ankesave, sondazheve dhe konsultimeve publike.

Kultura e përmirësimit të vazhdueshëm

Përmirësimi i vazhdueshëm duhet të jetë filozofi e përbashkët në të gjitha nivelet e ofrimit të shërbimeve sociale. Çdo institucion, çdo profesionist dhe çdo strukturë duhet të jetë në gjendje:

- të raportojë për rezultatet e arritura,
- të mësojë nga dështimet dhe sukseset,
- dhe të angazhohet për inovacion dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Vetëm përmes monitorimit të mirë-strukturuar, të sinqertë dhe të qëndrueshëm, shërbimet sociale mund të avancojnë në përmbushjen e misionit të tyre për të ndihmuar, mbrojtur dhe fuqizuar qytetarët në nevojë.

Në kuadër të procesit të hartimit të Planit të Veprimit, është ngritur një grup punues gjithëpërfshirës, i përbërë nga përfaqësues të nivelit komunal dhe të shoqërisë civile. Pjesëmarrja e tyre siguron një qasje të balancuar, transparente dhe gjithëpërfshirëse në planifikimin dhe zbatimin e politikave që adresojnë nevojat e komunitetit. Anëtarët e këtij grupi janë përzgjedhur duke u bazuar në ekspertizën e tyre, rolin institucional dhe angazhimin në çështje me rëndësi publike, me qëllim të garantimit të një procesi bashkëpunues dhe efektiv. Më poshtë paraqiten emrat e pjesëmarrësve në këtë grup punues:

Grupi Punues nga Komuna e Prishtinës:

1. Adelinë Sahiti-Drejtorja e Mirëqenies Sociale Komuna e Prishtinës;
2. Fetije Azemi – Drejtorja e Financave Komuna e Prishtinës
3. Premtim Fazliu- DMS Komuna e Prishtinës;
4. Besarta Morina - DMS Komuna e Prishtinës;
5. Fatmir Bilalli- Drejtorja e Emergjencave, Komuna e Prishtinës;
6. Bajram Shala - Qendra për Punë Sociale, Komuna e Prishtinës;
7. Naim Gashi- Qendra për Punë Sociale, Komuna e Prishtinës;
8. Naime Azemi - Qendra për Punë Sociale, Komuna e Prishtinës

Grupi punues mbështetës:

1. Donjeta Kelmendi - KOMF
2. Baki Gimolli - Institucioni i Avokatit të Popullit
3. Remzije Krasniqi - SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë
4. Mjellma Luma - SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë
5. Ariana Shala - SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë
6. Nita Luzha - SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë
7. Arjeta Rexhaj - SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë
8. Ibadete Krasniqi – OFAP
9. Albana Hoti, OFAP
10. Teuta Abrashi - Qendra MVPT
11. Fjolla Hoxha Terre de Hommes
12. Dorina Lluka Davis – YMCA Kosovo
13. Sebahate Hajdini Beqiri Sindrom Down
14. Rukije Gashi – Shoqata e të shurdhërve
15. Aferdita Gashi - HANDIKOS
16. Gresa Stublla - HANDIKOS
17. Vebi Mujku - facilitues i procesit.

Matrica e planit të veprimit: si dokument i ndarë.

**MATRICA – PLANI I VEPRIMIT PËR SHËRBIME SOCIALE E FAMILJARE
KOMUNA PRISHTINË**

2026-2028

OBJEKTIVA SPECIFIKE 1	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONI MBËSHTETËS	IMPLEMENTUESI	PLANI KOHOR	BUXHETI	INDIKATORI
1. Zhvillimi i programeve dhe shërbimeve parandaluese	1.1. Themelimi dhe funksionalizimi i këshillimores familjare	DMS	Kabineti i Kryetarit	QPS/Këshillimorja	2026-2027	200 000 Euro	Funksionalizimi i këshillimores familjare
	1.2 Zhvillimi i programeve psiko-sociale bazuar ne nevojat e identifikuar te zbatueshme ne kuadër te këshillimores familjare	DMS	OJQ	Këshillimorja	2027	10 000 Euro	Programe te zbatueshme të trajnuar
	1.3. Harmonizimi dhe grumbullimi i materialeve dhe programeve nga OJQ e ndryshme	DMS	DKA, DMS, DSH, OJQ	DMS DKA;OJQ	2026	1 000 Euro	Programi me module 2
	1.4 Organizimi i sesione informative parandaluese në institucione përkatëse për dukuritë negative	DKA DMS DSH Policia Media	DMS; OJQ; QMF; Shkollat	OJQ; DKA	2026-2028	1 000 Euro	Së paku 50 sesione-2026 Së paku 50 sesione-2027 Së paku 50 sesione-2028
	1.5. Fushata vetëdijesuse për grupet e cenushme	DMS	DKA;OJQ	DKA;OJQ	2026-2028	2 000 Euro	Së paku 5 fushata për vit
	1.6 Trajnime për prindërim pozitiv	DMS	QPS, OJQ, Shkolla, QMF	Qendra për Këshillim Familjar / OJQ	2026-2028	1 000 Euro	Së paku 200 përfitues
	1.7. Shërbim mobil informues për komunitetet rurale	DMS	KLSP, QMF, QPS, Komuna, OJQ, polici i lagjes, bashkësitë lokale, bashkësitë fetare, shoqatat,	Ekip mobil i profesionistëve socialë	2026-2028	1 000 Euro	Së paku 200 përfitues
2. Shërbime të integruara cilësore për qytetarët në nevojë sociale	2.1 Ofrimi i shërbimeve sociale, arsimore, shëndetësore, cilësore në familje në nevojë sociale, nëpërmjet OJQ kontraktuese dhe donatoreve te ndryshëm	DMS	MD, Drejtoritë komunale përkatëse	QPS,OJQ-të	2026-2028	500.000 Euro (2026) dhe donatorët, OJQ-të e kontraktuara	20.000 direkt për vit; 30.000 indirekt për vit
	2.2 Ofrimi i shërbimeve sociale cilësore ditore për fëmijë, dhe të rritur në nevojë sociale	DMS	QPS,OJQ	QPS, OJQ	2026-2028	350.000 Euro	1 000 përfitues për vit

	2.3 Ofrimi i shërbimeve sociale cilësore rezidenciale, për fëmijë dhe të rritur, në nevojë sociale	DMS	QPS, OJQ	QPS,OJQ	2026-2028	350.000 Euro	1 000 përfitues për vit-
	2.4. Themelimi dhe funksionalizimi i shtëpisë me bazë në komunitet	Komuna, MFPT, OJQ	DMS	DMS	2028	250 000 Euro	20 përfitues
	2.5 Themelimi dhe funksionalizimi i shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve	Ministria përkatëse; DMS	Komuna	Shtëpia e Fëmijëve dhe institucionet tjera përgjegjëse	2026-2028	152.500 Euro 2026 215 000 Euro 2027 215 000 Euro 2028	50 përfitues
	2.6 Ofrimi i shërbimeve për jetesë të pavarur të fëmijëve pa kujdes prindëror pasi mbushin 18 vjet deri 26 vjet	DMS/QPS	OJQ; Qendrat e karrierës brenda shkollave	QPS; OJQ	2026-2028	20 000 Euro	Së paku 5 përfitues p
	2.7 Mbështetja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në strehim familjar	DMS/QPS	OJQ	QPS	2026-2028	20 000 Euro	5 për vit, 2026-2028
	2.8 Mbështetja financiare për fëmijët dhe të rinjtë e strehuar në familje strehuese dhe strehim emergjent	DMS	QPS, DKA	QPS, OJQ	2027	30.000 Euro	20 për vit-2026-2028
3. Shërbime të integruara për të moshuarit	3.1 Ofrimi i strehimit, kujdesit dhe shërbimeve për të moshuarit pa kujdes familjar	DMS	Komuna, MD paneli për vendosje	Shtëpia për të moshuar	2026-2028	900.000 Euro2026 1 000 000 Euro 2027 1 000 000 Euro 2028	65 klient për vit
	3.2 Aktivitete rekreative, kulturore dhe mbështetëse për të moshuarit në qëndrim ditor	DMS	QPS, OJQ, DKA	DMS, OJQ	2026-2028	350.000 Euro	500 përfitues për vit-2

3.3 Ofrimi i shërbimeve në shtëpi për të moshuarit përmes njësisë mobile dhe përmes vullnetarëve	DMS	QPS;QMF	OJQ-të	2026-2028	10.000 Euro	2000 përfitues -2026-
3.4 Zhvillimi i mjetit për monitorim e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare për të moshuarit në shërbimin rezidencial ashtu edhe në atë ditorë.	DMS	DMS	DMS	2026-2028	5 000 Euro	Së paku 50 monitorim
3.5 Kontroll rutinore nga mjeku familjar (matja e tensionit, diabetit).	DMS/SHMPPF	DMS, DSH, QKMF	QKMF	2026 - 2028	1 000 Euro	Së paku 12 herë gjatë
3.6 Ngritja e kapaciteteve të stafit që ofrojnë shërbime.	DMS	DMS,SHMPKPF	DMS, OJQ	2026 - 2028	5 000 Euro	Në përputhje me stan
3.7 Rritja e numrit të të punësuarve të profileve adekuate	Komuna	DMS	DMS	2026 - 2028	20 000 Euro	Në përputhje me stan
3.8 Kartela sociale për pensionistet e cila mundëson a) organizim te vizitave turistike brenda vendit pa pagese	DMS	DMS, Shoqata	DMS	2026 - 2028	5 000 Euro	Secili përfitues do të p sociale
3.9 Qendra te reja ditore për aktivitete rekreative dhe sociale ne lagje	DMS	DMS, OJQ	OJQ	2026 - 2028	100 000 Euro	Hapja e 2 qendrave di
3.10 Dizjanimi dhe zhvillimi i Programi “Jetojmë me dinjitet” – asistence shtëpiake për të moshuarit që jetojnë vetëm.	DMS	OJQ, Partneret	Partnerët	2026	100 000 Euro	Programi i dizjanuar Së paku 1 000 përfitu

Shërbimet Sociale dhe Familjare		Ndërlidhja me Plane Tjera				
OBJETKIVA SPECIFIKE II	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONI MBËSHTETËS	IMPLEMENTUESI	PLANI KOHOR	BUXHETI
4.Shërbime të integruara për personat me aftësi të kufizuara	4.1 Furnizimi me pajisje ndihmëse dhe materiale didaktike dhe vizuale për personat me aftësi të kufizuara	DMS	Donatorët; OJQ	DMS	2026-2028	500.000 Euro
	4.2 Përmirësimi dhe sigurimi i qasjes dhe infrastrukturës për persona me aftësi të kufizuara në objektet publike dhe hapësira publike	Komuna	Drejtoritë përkatëse	Drejtoritë përkatëse	2026-2028	20 000 Euro
	4.3 Ekipi mobil për ofrim të përkujdesjes sociale dhe shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara	DMS	OJQ	OJQ	2026-2028	30.000 Euro
	4.4 Themelimi i qendrës ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara.	DMS	OJQ	OJQ	2026-2028	100 000 Euro
	4.5. Pajisja e gjitha institucioneve komunale me mjete dhe material në gjuhen e shenjave	Komuna		OE	2026- 2028	20 000 Euro
	4.6 Sigurimi i pajisjeve dhe qasjes në shërbime përmes mjeteve asistive për PAK	Komuna	DMS, Drejtoria e Administrate	OE	2026 – 2028	20 000 Euro
5.Zhvillimi i banimit social	5.1 Hartimi i planit 3 vjeçar të banimit social	Kabineti i Kryetarit	Drejtoria e Pronës	DMS, Drejtoritë përkatëse	2026-2028	10 000 Euro

5.2 Ofrimi i ndihmës për mbulimin e kostos së qirasë	DMS	DMS	DMS	2026-2028	120.000 Euro
5.3. Mbështetja në banim për personat që dalin nga kujdesi alternativ, dhe në nevojë për jetesë të pavarur të mbikëqyrur 18 deri 26 vjeç	DMS	DMS, QPS, OJQ	QPS	2026 – 2028	20 000 Euro
5.4 Mbështetja financiare për viktime të dhunës në familje për banim	DMS	DMS	DMS	2026-2028	150.000 Euro

Shërbimet Sociale dhe Familjare		Ndërlidhja me Plane Tjera				
OBJETKIVA SPECIFIKE III	AKTIVITETI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONI MBËSHTETËS	IMPLEMENTUESI	PLANI KOHOR	BUXHETI
6. Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, materiale e infrastrukurore	7.1 Rritja e numrit të stafit profesional (punëtorë social, psikolog) në QPS	Komuna e Prishtinës; QPS; Sektori i Burimeve Njerëzore	MD MFPT MAPL	DMS	2026-2028	320 000 Euro
	7.2 Ngritja e kapaciteteve profesionale	DMS, DKA	QPS	OJQ dhe institucionet e akredituara dhe licencuara; Këshilli i	2026-2028	50.000 Euro

<p>përmes pjesëmarrjes aktive në trajnime të stafit të komunës dhe OJQ-ve</p> <p>7.3. Trajnimi i stafit të DKA-se, QPS-së, DMS-së i modulit të integruar për shërbime sociale</p> <p>7.4. Ndjekja e trajnimeve, retreat, vizita studimore, vlerësim i nevojave për stafin e SHPMPF-se</p> <p>7.4.1 Super vizion, në parandalimin e djegies profesionale</p>			Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale dhe Familjare; IKAP		
7.5 Rigjenerimi i hapësirave të SHPMPF-së dhe Qëndrimeve ditore për të moshuarit	DMS	Komuna e Prishtinës; Donatorët e huaj;	Drejtoria e Urbanizmit dhe Kadastrat dhe drejtoritë dhe njësitë e tjera komunale; Kompanitë e kontraktuara;	2026-2028	100.000 Euro
7.6 Financimi për shtëpinë me bazë në komunitet	DMS	Drejtoria për Investime kapitale dhe të tjera	DMS	2026-2028	630.000 Euro
7.7 Renovime të qendrave të ndryshme sociale (Qëndrimet ditore për të moshuar, QPS, etj).	DMS	DMS	NPB	2026 - 2027	200 000 Euro
7.8 Financimi i shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve në situatë emergjente	DMS	MFPT, Drejtoria e urbanizmit, drejtoria e planifikimit, drejtoria e investimeve kapitale, sektori i prokurimit publik, DMS		2026-2028	735 000 Euro
7.9 Inventarizimi i shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve	DMS			2028	100 000 Euro
7.10 Sigurimi i fondit për raste emergjente që trajtohen nga QPS (veshmbathje, ushqim, etj.);	DMS	QPS	QPS	2026-2028	30.000 Euro

7.Digjitalizimi i bazës së të dhënave	8.1. Krijimi teknik i data bazës dhe mirëmbajtjes	DMS	DA	OE	2026-2028	200.000 Euro
	8.2 Mbledhja e të dhënave aktuale, strukturimi, unifikimi dhe integrimi i të dhënave dhe qasje integrale data bazat e organizatave që ofrojnë shërbime direkte	QPS	Shtëpia e të moshuarve; shtëpia e fëmijëve	QPS	2026-2028	10 000 Euro
	8.3 Trajnim i stafit për përdorim të bazës të dhënave;	DMS	QPS; Shtëpia e të moshuarve; shtëpia e fëmijëve	OE	2026 – 2028	10 000 Euro

Narrativa e Planit të Veprimit për Shërbimet Sociale dhe Familjare në Komunën e Prishtinës 2026–2028

Plani i Veprimit për Shërbimet Sociale dhe Familjare për periudhën 2026–2028 në Komunën e Prishtinës paraqet një përgjigje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse ndaj nevojave në rritje për mbrojtje sociale, përkrahje familjare dhe integrim social të grupeve të cenueshme. Ky plan është hartuar në përputhje me prioritetet e zhvillimit social të komunës, standardet nacionale dhe ndërkombëtare të shërbimeve sociale, si dhe me qasjen e decentralizimit të shërbimeve.

Në qendër të Planit qëndron krijimi i një sistemi efikas dhe të qëndrueshëm të shërbimeve sociale, të cilat synojnë jo vetëm trajtimin e rasteve ekzistuese, por edhe parandalimin e problemeve sociale dhe promovimin e mirëqenies në komunitet. Plani është ndërtuar mbi tri shtylla kryesore:

1. Parandalimi dhe Promovimi i Mirëqenies Familjare

Në kuadër të këtij objekti, synohet ngritja e qendrës këshilluese për familje dhe zhvillimi i programeve psiko-sociale të orientuara drejt grupeve në rrezik. Aktivitetet përfshijnë:

- Themelimi dhe funksionalizimi i këshillimores familjare.
- Zhvillimi i programeve të bazuara në nevojat psiko-sociale të komunitetit.
- Organizimi i sesioneve informuese dhe fushatave vetëdijësuese kundër dukurive sociale negative.
- Trajnime për prindërim pozitiv dhe krijimi i shërbimeve mobile për informim në zonat rurale.

Qëllimi është të promovohet një qasje proaktive dhe edukative në adresimin e çështjeve sociale, duke e vënë theksin tek mbështetja për familjen si njësi themelore e komunitetit.

2. Ofrimi i Shërbimeve të Integruara dhe Cilësore për Grupet në Nevojë

Kjo shtyllë fokusohet në forcimin e sistemit të shërbimeve për fëmijë, të rritur, të moshuar, persona me aftësi të kufizuara dhe viktime të dhunës. Aktivitetet përfshijnë:

- Shërbime ditore, rezidenciale dhe shtëpiake për fëmijët dhe të rriturit në nevojë.
- Themelimi i shtëpive mbrojtëse dhe qendrave ditore për grupet e marginalizuara.
- Mbështetje për jetesë të pavarur për të rinjtë pas përfundimit të kujdesit institucional.
- Shërbime për të moshuarit, përfshirë strehim, aktivitete ditore dhe kujdes mjekësor në shtëpi.
- Mbështetje për personat me aftësi të kufizuara përmes pajisjeve ndihmëse, qasjes në infrastrukturë dhe ofrimit të përkujdesjes nga ekipet mobile.

Ky dimension përfaqëson angazhimin e komunës për t'u siguruar që askush të mos mbetet prapa, dhe që çdo individ të ketë qasje të barabartë në shërbime humane dhe të personalizuar.

3. Ngritja e Kapaciteteve Njerëzore, Infrastrukturore dhe Digjitale

Ky komponent i Planit ka për qëllim rritjen e kapaciteteve të institucioneve për të ofruar shërbime të standardizuara dhe të qëndrueshme. Aktivitetet përfshijnë:

- Zgjerimi i stafit profesional (psikologë, punëtorë socialë) në Qendrat për Punë Sociale.
- Trajnime të specializuara për stafin komunal dhe të OJQ-ve.
- Investime në infrastrukturën e objekteve sociale si rigjenerimi i qendrave ekzistuese dhe ndërtimi i qendrave të reja.
- Digjitalizimi i të dhënave dhe krijimi i një baze të integruar për menaxhimin dhe koordinimin e rasteve.

Përmes kësaj shtylle synohet rritja e profesionalizimit dhe efikasitetit të shërbimeve, për të ofruar ndihmë në kohë dhe të mbështetur në evidenca.

Përfundim

Ky Plan Veprimi i strukturon ndërhyrjet në mënyrë strategjike për të siguruar një sistem të fuqishëm dhe reagues të shërbimeve sociale në Komunën e Prishtinës. Ai mbështetet në

parime të barazisë, gjithë përfshirjes, respektit për dinjitetin njerëzor dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Përmes bashkëpunimit ndërinstytucional, përfshirjes së sektorit joqeveritar dhe aktivizimit të komunitetit, ky plan synon ta shndërrojë Prishtinën në një komunë me politika sociale të avancuara dhe të ndjeshme ndaj nevojave të qytetarëve të saj.

Verifikimi i rekomandimeve për zhvillimin e Planit të Veprimit për Shërbimet Sociale në Komunën e Prishtinës 2026-2028, bazuar në hartëzimin social

Rekomandimet për zhvillimin e Shërbimeve Sociale në Komunën e Prishtinës

Rekomandimet për zhvillimin e shërbimeve sociale në Komunën e Prishtinës janë rezultat i Hartëzimit Social LNOB (“Pa lënë askënd pas”) dhe i hartimit të politikave të bazuara në evidenca, të realizuara nga nëntori 2023 deri në shkurt 2024. Popullata e synuar për këtë studim janë personat e moshuar që jetojnë në Komunën e Prishtinës, me theks të veçantë te gratë.

Në nëntor u mbajt takimi fillestar me Komunën, gjatë të cilit përfaqësuesit komunalë u informuan mbi metodologjinë e hartëzimit social, qëllimet dhe rezultatet e pritura të saj. Gjatë muajit dhjetor u zhvilluan grupe fokusi me palë të ndryshme të interesuara në komunë. Në të njëjtën kohë, pyetëtori i hartëzimit social u redaktua dhe u përshtat sipas kontekstit lokal. Trajnimi i intervistuesve u realizua në fund të dhjetorit. Grumbullimi i të dhënave u bë në janar, me pjesëmarrjen e 200 të anketuarve, ndërsa analiza dhe raportimi u kryen në muajin shkurt.

Hartëzimi social përfshiu si zonat urbane ashtu edhe ato rurale të Komunës së Prishtinës. Fillimisht u organizuan dy grupe fokusi me një numër më të gjerë të palëve lokale të interesuara, për mbledhjen e të dhënave shtesë dhe për verifikimin e gjetjeve fillestare të identifikuar nëpërmjet hulumtimit në tavolinë. Në zonat urbane, vëmendja u përqendrua në katër lagje ku ndodhen qendrat ditore për të moshuarit: Tophane, Ulpiana, Aktash dhe Pejton.

Analiza u udhëhoq nga tregues të lidhur me faktorët e rrezikut, si statusi socio-ekonomik, pozita gjeografike, qeverisja, diskriminimi dhe cenueshmëria ndaj fatkeqësive natyrore. Kjo ka mundësuar një kuptim më të thellë të nevojave konkrete të grave të moshuara dhe të prioritetëve për ndërhyrje të përshtatshme sociale.

Grupet e Cenueshme – Popullsia e Moshuar në Prishtinë

- Të moshuarit që jetojnë vetëm – përballen me rreziqe nga izolimi social, që shpesh çon në probleme shëndetësore fizike dhe mendore.
- Të moshuarit me të ardhura të kufizuara – sidomos ata me më pak se 200 euro në muaj.
- Të moshuarit me probleme shëndetësore – përfshirë ata që kërkojnë pajisje mbështetëse dhe kujdes të specializuar.
- Të moshuarit me lëvizshmëri të kufizuar – që jetojnë në ndërtesa pa ashensorë ose me kushte të papërshtatshme.
- Gratë e moshuara – përballen me sfida shtesë për shkak të mungesës së shërbimeve të dedikuara.

- Të moshuarit pa rrjete mbështetëse sociale – të cenueshëm ndaj vetmisë dhe depresionit.
- Të moshuarit pa qasje në kujdes shëndetësor – pa mundësi për vizita mjekësore apo trajtim në shtëpi.
- Të moshuarit me qasje të kufizuar në shërbime sociale – si qendra ditore, mensa sociale dhe transport.

Grupet më të Cenueshme në Fokus

- Gratë e moshuara që jetojnë vetëm apo përballen me probleme shëndetësore.
- Të moshuarit me lëvizshmëri të kufizuar që jetojnë në banesa të paarritshme.
- Të moshuarit me të ardhura të ulëta, sidomos ata që mbështeten vetëm në pension.
- Individët e moshuar të izoluar nga rrjetet familjare apo shërbimet komunitare.

1. Tabela e Shërbimeve Sociale - Komuna e Prishtinës

Faktori i Rrezikut	Grupi në Objektiv	Shërbimi Social Ekzistues	Nevoja për Zhvillimin e një Shërbimi të Ri Shoqëror	Mënyra	Numri i Parashikuar i Përdoruesve	Territori / Zbatimi	Vlera Totale e Projektit (në EUR)	Burimet Financiare	Bartësi	Partnerët
Statusi socio-ekonomik	Të moshuarit	Nuk ka	Programe të Ndihmës Financiare	Krijimi i një Programi Komunal të Subvencionimit për shpenzime bazë si ushqimi dhe energjia	100	Prishtinë	500 €/muaj qira Renovim 5000 € (jo nga komuna) Ushqimi dhe energjia do të mbulohen nga donatorët	Donatorët, Komuna	Komuna	OJQ-të
		Nuk ka	Mundësi Punësimi me orar të Pjesërishëm	Krijimi i një nisme Komunale për punësim në komunitet	Ndërmarrje sociale – 25 gra në rrobaqepësi, 50 gra	Prishtinë	24,200 €	OJQ-të, AKM, NALAS	Komuna	OJQ-të
		Shërbime shtëpiake për të moshuar përmes njësive	Shërbim Shëndetësor i qasshëm dhe me Cilësi	Sigurimi i pajisjeve ndihmëse si lupa dhe aparate presioni për të	6000 kontrolle në QMF/klinika	Prishtinë	NA	Komuna, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies	Komuna	OJQ

		mobile dhe vullnetarëve		moshuarit përmes subvencioneve						
		Aktivite rekrutative, kulturore dhe mbështetëse për të moshuarit në qendrat ditore	Ndërveprim dhe mbështetje sociale	1. Themelimi i qendrave ditore, klubeve sociale, dhe mensave 2. Sigurimi i pajisjeve si makina qepëse, mjete kopshtarje etj.	500/muaj	Prishtinë	200,000 €	Biznes privat, OJQ		OJQ
		Nuk ka	Mirëqenie psikosociale	Ofrimi i këshillimit psikosocial në shtëpi për të moshuarit	20	Prishtinë	5500 €	OJQ, AKM	Komuna	OJQ, AKM

2. Tabela e Shërbimeve Sociale sipas Gjeografisë – Komuna e Prishtinës

Faktori i Rrezikut	Grupi në Objektiv	Shërbimi Social Ekzistues	Nevoja për Zhvillimin e një Shërbimi të ri Shoqëror	Mënyra	Numri i Parashikuar i Përdoruesve	Territori / Zbatimi	Vlera Totale e Projektit (në EUR)	Burimet Financiare	Bartësi	Partnerët
Gjeografia	Të moshuarit	Nuk ka	Transport i qashtë në zonat rurale	Zhvillimi i shërbimeve të organizuara të transportit për të adresuar	NA	Prishtinë	Në bashkëpunim me drejtorinë	Komuna	Komuna	Komuna

				sfidat e mobilitetit (zgjerimi i linjave urbane – tashmë i realizuar)			tjera të Komunës			
		Pjesërisht	Sigurimi i qasjes në strehim	Ndërtimi i rampave dhe shtigjeve të qasshme për banesat e të moshuarve (aktualisht në proces)	Të gjithë	Prishtinë	1,500,000 €	Investime kapitale	Komuna	OJQ, Komuna, NPB
		1. Strehim, kujdes dhe shërbime për të moshuarit pa përkujdesje familjare 2. Ndihmë njëherësh për mbulimin e qirasë 3. Inventar i banesave me qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm	Shërbime Mbështetëse për Strehim të Përbalueshëm	Nisja e një Programi të Ndihmës për Strehim, përfshirë subvencione qiraje dhe përmirësime në qasjen e banesave (Programi tashmë ekziston, por jo specifikisht për të moshuarit; kosto aktuale 175 €/muaj, me	20	Prishtinë	60,000 €	Komuna	Komuna	

				qëllim rritje në 300 €)						
--	--	--	--	-------------------------	--	--	--	--	--	--

3. Tabela e Qeverisjes – Shërbime Sociale për të Moshuarit në Prishtinë

Faktori i Rrezikut	Grupi në Objektiv	Shërbimi Social Ekzistues	Nevoja për Zhvillimin e një Shërbimi të Ri Shoqëror	Mënyra	Numri i Parashikuar i Përdoruesve	Territori / Zbatimi	Vlera Totale e Projektit (në EUR)	Burimet Financiare	Bartësi	Partnerët
Qeverisja	Të moshuarit	Diskutime publike – vlerësim i nevojave	Politika të synuara për nevojat e të moshuarve	Krijimi i këshillave lokale këshillëdhënëse për të moshuarit, integrimi i nevojave të tyre në politikat komunale dhe nisja e programeve komunitare për të nxitur pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje	Të konfirmohet nga raporti	Prishtinë	NA	Komuna	Komuna	N/A

4. Tabela për Diskriminimin – Shërbime Sociale për të Moshuarit në Prishtinë

Faktori i Rrezikut	Grupi në Objektiv	Shërbimi Social Ekzistues	Nevoja për Zhvillimin e një Shërbimi të Ri Shoqëror	Mënyra	Numri i Parashikuar i Përdoruesve	Territori / Zbatimi	Vlera Totale e Projektit (në EUR)	Burimet Financiare	Bartësi	Partnerët
Diskriminimi	Të moshuarit	Nuk ka	Fushata për rritjen e vetëdijes për të luftuar diskriminimin në bazë moshe	Zbatimi i iniciativave komunale për të edukuar publikun, veçanërisht të rinjtë, mbi vlerën dhe kontributin e të moshuarve	NA	Prishtinë	NA	Komuna	Komuna	N/A

5. Tabela për Cenueshmërinë ndaj Krizave – Shërbime për të Moshuarit në Prishtinë

Faktori i Rrezikut	Grupi në Objektiv	Shërbimi Social Ekzistues	Nevoja për Zhvillimin e një Shërbimi të Ri Shoqëror	Mënyra	Numri i Parashikuar i Përdoruesve	Territori / Zbatimi	Vlera Totale e Projektit (në EUR)	Burimet Financiare	Bartësi	Partnerët
Cenueshmëria ndaj krizave	Të moshuarit	1. Strehim, kujdes dhe shërbime për të moshuarit pa përkujdesje familjare 2. Ofrimi i	Përgatitje dhe mbështetje për emergjenca	Zhvillimi i sistemeve gjithëpërfshirëse të gatishmërisë për emergjenca, përfshirë ndihmën financiare,		Prishtinë	Buxheti i Prishtinës 2025	Komuna	Komuna	N/A

		shërbimeve në shtëpi përmes njësisë mobile dhe vullnetarëve		mbështetjen psikologjike dhe shërbimet sociale për të rritur qëndrueshmërinë e të moshuarve gjatë krizave si pandemia apo fatkeqësitë natyrore (përmes Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave)						
--	--	---	--	---	--	--	--	--	--	--

Ligjet, udhëzimet dhe rregulloret kryesore që përbëjnë bazën juridike të sistemit të mbrojtjes sociale në Kosovë përfshijnë, por pa u kufizuar:

- Kodi nr. 06/1-006 i Drejtësisë për të Mitur
- Kodi nr. 06/1-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës
- Ligji nr. 02/1-118 për Emrin Personal
- Ligji nr. 03/1-006 për Procedurën Kontestimore
- Ligji nr. 03/1-007 për Procedurën Jokontestimore
- Ligji Nr. 03/1-037 për Dokumentet e Udhëtimit
- Ligji nr. 04/1 – 092 për Personat e Verbër
- Ligji nr. 04/1-003 për Gjendjen Civile
- Ligji Nr. 04/1-215 për Shtetësinë e Kosovës
- Ligji nr. 04/1-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit
- Ligji Nr. 05/L -025 për Shëndetin Mendor
- Ligji Nr. 05/L -067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik
- Ligji nr. 06/1- 026 për Azil
- Ligji nr. 06/1-084 për Mbrojtjen e Fëmijës
- Ligji nr. 08/1-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore
- Ligji Nr. 03/L-022 për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme
- Ligji nr. 08/1-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare
- Ligji Nr. 2004/32 Ligji për Familjen i Kosovës
- Rregullore (MPB) nr. 03/2018 për Funksonimin e Qendrës për Azil
- Rregullore (QRK) - nr. 18/2024 për përcaktimin e Procedurave Efektive për Identifikimin, Raportimin dhe Referimin ndaj Shfrytëzimit, Neglizhimit dhe Abuzimit të Fëmijës si dhe për Mbrojtjen e Fëmijës në Situatë Rruge
- Rregullore (QRK) - Nr. 23/2023 për Procedurat e Punës në Tryezat Multidisiplinare për Ndihmë në Menaxhimin e Rastit
- Rregullore (QRK) nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve
- Rregullore (QRK) nr. 23/2024 për Procedurat dhe Kriteret e Vlerësimit dhe Njohjes së Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë
- Rregullore (QRK) Nr.07/2024 për Organizimin dhe Fushëveprimin e Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijës
- Rregullore QRK Nr 15/2014 për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave në Republikën e Kosovës
- Rregullore (QRK) Nr.16/2023 për Funksonimin dhe Punën në Qendrën për Strehimin, Mbrojtjen DHE Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore, në Nivel të Mesëm dhe të Lartë të Rrezikshmërisë
- Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 02/2019 për Procedurat dhe Standardet e Shqyrtimit dhe Marrjes së Vendimit lidhur me aplikacionin për Mbrojtje Ndërkombëtare
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 05/2015 për Procedurën dhe Kriteret e Përcaktimit të Statusit të Personit pa Shtetësi, Mënyra e Fitimit të Shtetësisë për Personin pa Shtetësi dhe Personin me Status të Refugjatit

- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 06/2019 për Procedurën e Humbjes së Shtetësisë së Kosovës me Lirim dhe Privim
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr.01/2022 për Dokumentet e Gjendjes Civile
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr.06/2018 për Procedurat e Pajisjes me Pasaportë
- Udhëzim Administrativ (QRK) - Nr. 02/ 2024 për Parandalimin dhe Ndalimin e Formave të Rrezikshme të Punës së fëmijëve në Kosovë
- Udhëzim Administrativ (QRK) - Nr. 04/2023 për Trajtimin Mjekësor dhe Psikologjik, të Fëmijës Viktimë e Abuzimit, për t'i Ndhimuar në Rehabilitim dhe për t'u Ri integruar në Shoqëri
- Udhëzim Administrativ (QRK) -Nr. 02/2021 për Zbatimin e Drejtësisë Mike ndaj Fëmijës në Procedurën Penale, Civile dhe Administrative
- Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 04/2022 për Masat për Mbrojtjen e Fëmijës Kundër Faqeve të Internetit me Përmbajtje Pornografike dhe të atyre që Dëmtojnë Shëndetin dhe Jetën e Fëmijës
- Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 06/2023 për Masat e Duhura Parandaluese dhe Mbrojtëse për Ndalimin e Pjesëmarrjes së Fëmijëve në Klubet e Natës dhe Hapësira të tjera të Ngjashme
- Udhëzim Administrativ (QRK) Nr.05/2024 Edukimi për Mbrojtjen e Fëmijës
- Udhëzim administrativ (QRK)-nr. 01/2021 për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve kryerës të veprave penale nën moshën e përgjegjësisë penale
- Udhëzim Administrativ (QRK)-Nr. 05/2023 Masat për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijës nga Abuzimi me Narkotikë
- Udhëzim Administrativ (QRK)-Nr. 07/2022 për Autoritetet për të Drejtat e Fëmijës
- Udhëzim Administrativ MD - nr. 03/2025 për Strehimin Rezidencial
- Udhëzim Administrativ MD-nr. 08/2020 për lejimin e pushimit vjetor për të miturit
- Udhëzim Administrativ nr. 01/2014 për Identifikimin e Hershëm të Viktimave të Trafikimit me Njerëz nga Shërbimet Konsullore, Policia Kufitare dhe Inspektorati i Punës
- Udhëzim Administrativ QRK - nr. 10/2017 për listën e treguesve për identifikimin zyrtar të viktimave të trafikimit me njerëz
- **Memorandumi i Mirëkuptimit** ndërmjet MAPL, MFPT dhe komunave, që përcakton ndarjen e përgjegjësisë për ofrimin e shërbimeve sociale në nivel lokal.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), neneve 19, 22 dhe 28 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për administratë të hapur në komuna, nenit 32, pika **c** dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më .2026, merr këtë

V E N D I M
PËR LËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

1. Miratohet fillimi i procedurave për lënie në diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01-110/1205 (K.Pr.) për shërbimin e transportit me "Merimangë" për territorin e komunës së Prishtinës.
2. Organizimi i diskutimit publik do të bëhet sipas Udhëzimit administrativ (MAPL), nr. 04/2023 për administratë të hapur në komuna.
3. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, diskutimi publik do të zgjatë 15 ditë kalendarike, nga data e shpalljes së njoftimit publik për mbajtjen e konsultimeve.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit, respektivisht zyrtari përgjegjës për koordinimin e konsultimit publik.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Kryeqytetit.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
.2026

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në mbështetje të nenit 12, paragrafit 2, shkronja c, nenit 17, shkronja f, dhe të nenit 40, paragrafit 2, shkronja a të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/04 qershor 2008), të nenit 15, shkronja a dhe f të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27/03 qershor 2008), të nenit 7, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.338/shtator 2016, Prishtinë), të nenit 7 të Ligjit Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor si dhe nenit 15, paragrafit 15.1, shkronja f, nenit 33, paragrafit 33.1, shkronja a të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, datë 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur me datë ____/____2025, miratoi këtë:

RREGULLORE (K.Pr) NR. ____/2025
PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E
RREGULLORES 01-030/01-236535/23 (K.PR) PËR ORGANIZIMIN DHE
SHFRYTËZIMIN E PARKINGJEVE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është plotësimi dhe ndryshimi i rregullores 01-030/01-236535/23 (K.Pr) për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve në Komunën e Prishtinës (në tekstin e mëtejshëm: rregullorja), me qëllim të harmonizimit me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës P.A.nr.02/2025 dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 2

Neni 1 i rregullores ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve dhe kriterëve të vendparkimeve publike dhe private, për caktimin e zonave, mënyrat e pagesës, çmimet dhe llojet e biletave për vendparkim, procedurën për krijimin dhe operimin e parkingjeve publike dhe private, mënyrën e shfrytëzimit dhe mbikëqyrjes së tyre, si dhe rregullimi i përgjithshëm i parkimit të automjeteve në gjithë territorin e Prishtinës (më tutje: kryeqyteti). Mënyra e pagesës për shfrytëzimin e vendparkimeve publike do të ofrojë alternativa të shumta dhe të qasshme për të gjithë përdoruesit, përfshirë pagesën përmes telefonit, shitjen e biletave të parashtypura të parkimit nëpër kioska dhe tek operatorët e

tjerë, kartelave bankare, dhe apo përmes formave tjera të përshtatshme dhe pagesën me para të gatshme tek operatorët e kontraktuar nga NPL “*Prishtina Parking*” SH.A., përmes biletës fizike, në mënyrë që të sigurohet barazi në qasje dhe mosdiskriminim, në përputhje me të drejtat e konsumatorëve dhe standardet e shërbimeve publike.

Neni 3

Paragrafi 1 i Nenit 8 të rregullores, riformulohet si në vijim:

8.1. Hapësira rezidenciale - është hapësirë e parkimit e përcaktuar për banorët rezidentë të adresës specifike. Vetëm banorët e adresës përkatëse, të regjistruar pranë ndërmarrjes “*Prishtina Parking*” mund të parkohen në këto hapësira. Personat tjerë mund të përdorin këto vendparkime vetëm deri në orën e përcaktuar nga NPL “*Prishtina Parking*” SH.A. Njoftimi i orëve të kufizuara për vizitorë vendoset në tabelën vertikale në hyrje të parkimit rezidencial. NPL “*Prishtina Parking*” SH.A., përmes analizave numerike e përcakton orarin e ndalimit të parkimit për vizitorë. “*Prishtina Parking*” SH.A., brenda 6 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, përmes akteve të brendshme, të cilat duhet të jenë publike, e përcakton metodën dhe kushtet e shfrytëzimit të parkimit për vizitat familjare të banorëve rezidentë.

Neni 4

Paragrafi 1 i Nenit 12 të rregullores, riformulohet si në vijim:

12.1. N.P.L. “*Prishtina Parking*” SH.A. është përgjegjëse për dëmet e shkaktuara në automjetet e parkuara në vendparkimet që i menaxhon, vetëm në rastet kur dëmet ndodhin si rezultat i neglizhencës, mungesës së mirëmbajtjes ose moszbatimit të standardeve të sigurisë nga ana e stafit të N.P.L. “*Prishtina Parking*” SH.A. Në të gjitha rastet tjera, lidhur me dëmin, stafi i N.P.L. “*Prishtina Parking*” SH.A." ka për obligim vetëm të njoftoj organet kompetente.

Neni 5

Paragrafi 9 i nenit 12 të rregullores, plotësohet dhe ndryshohet si në vijim:

12.9. Në rast të gabimeve teknike gjatë pagesës që nuk janë rezultat i veprimit të qëllimshëm të qytetarit, N.P.L. “*Prishtina Parking*” SH.A. është e obliguar të realizojë rimbursimin brenda afatit prej 15 ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës. Mënyra dhe detajet për gabimet teknike dhe mënyra e rimbursimit përcaktohet me aktin e brendshëm të nxjerrë nga N.P.L. “*Prishtina Parking*” SH.A.

Neni 6

Neni 14 i rregullores, riformulohet si në vijim:

Neni 14

Mënyra e pagesës

14.1. Pagesa për shfrytëzimin e vendparkimeve publike mund të bëhet përmes këtyre mënyrave alternative:

- a) përmes aplikacioneve të miratuara për pajisje mobile;
- b) përmes pagesës me para të gatshme te operatorët e kontraktuar nga NPL "Prishtina Parking" SH.A., përmes biletës fizike, apo në vend tjetër të përshtatshëm;
- c) përmes kartelave bankare në pikat e autorizuara;
- d) përmes ueb-platformës së ndërmarrjes publike për parkim.

14.2. Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" SH.A. ka për obligim të garantojë ekzistimin dhe funksionalitetin e të paktën dy mënyrave të ndryshme të pagesës në çdo zonë të parkimit.

14.3. Mënyrat e pagesës dhe funksionaliteti i tyre duhet të jenë të afishuara në mënyrë të dukshme në të gjitha lokacionet ku operon N.P.L. "Prishtina Parking" SH.A.

14.4. Mosfunksionimi i pajisjeve për pagesë, konsiderohet si pamundësi objektive për pagesë dhe nuk mund të rezultojë në shqiptimin e tarifave shtesë ndaj shfrytëzuesve.

14.5. Mënyrat dhe detajet e pagesës së parkimit të menaxhuar nga N.P.L. "Prishtina Parking" SH.A. përcaktohen përmes aktit të brendshëm të nxjerrë nga N.P.L. "Prishtina Parking" SH.A.

Neni 7

Neni 15 i rregullores, riformulohet si në vijim:

Neni 15

Çmimi për shfrytëzimin e parkingjeve

Shfrytëzuesit e parkingjeve në Komunën e Prishtinës do të paguajnë për shfrytëzimin e parkingjeve në pajtim me çmimet e përcaktuara në Aneksin 1 Çmimorja e Parkingjeve në Komunën e Prishtinës, pjesë e bashkëngjitur e rregullores.

Neni 8

Paragrafi 1 i Nenit 22 të rregullores, riformulohet si në vijim:

22.1. Në rast të moskryerjes së pagesës brenda 15 minutave pas parkimit, për shfrytëzuesin do të zbatohet tarifë shtesë sipas dispozitave të kësaj rregullore. Bllokimi i automjetit mund të bëhet nga ana e stafit të NPL "Prishtina Parking" SH.A., vetëm me urdhërin e Policisë apo Inspektorit përkatës dhe vetëm në rastet kur shfrytëzuesi ka shkelur detyrimet për pagesë dhe pas paralajmërimit të dukshëm në automjet.

Neni 9

Paragrafi 8 i nenit 22 të rregullores, ndryshohet si në vijim:

22.8. Bartja dhe zhvendosja e automjeteve që janë parkuar në mënyrë të kundërligjshme në zona të paautorizuara bëhet vetëm me urdhër të Drejtorisë së Inspeksionit dhe me asistencë të Policisë së Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 10

Paragrafi 9 i nenit 22 ndryshohet si vijon:

22.9. Bllokimi, deblokimi i automjeteve bëhet me urdhëresë të lëshuar nga Drejtoria e Inspeksionit Komunal, ndërsa N.P.L. "Prishtina Parking" SH.A. asiston vetëm në mbështetje teknike dhe logjistike. Ndërsa, bartja dhe zhvendosja e automjeteve bëhet vetëm me urdhër të Drejtorisë së Inspeksionit dhe me asistencë të Policisë së Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 11

Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

1. Të gjitha aktet e brendshme të N.P.L. "Prishtina Parking" SH.A. duhet të harmonizohen me këtë Rregullore brenda afatit prej 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore.
2. Obligohet N.P.L. "Prishtina Parking" SH.A. që tu mundësoj palëve pagesa me para kesh tek operatorët e kontraktuar nga NPL "Prishtina Parking" SH.A. përmes biletës fizike, brenda periudhës prej 7 ditësh nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.
3. Për format tjera të pagesave të përcaktuara me këtë Rregullore, obligohet N.P.L. "Prishtina Parking" SH.A. që të bëjë funksionalizimin e sistemeve brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**), të Ligjit nr. 03/L - 40, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d**) e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 13.6.2024, merr këtë

V E N D I M
PËR FORMIMIN E FORUMIT PËR TRANSPARENCË KOMUNALE NË
KOMUNËN E PRISHTINËS

1. Formohet Forumi për Transparencë Komunale në Komunën e Prishtinës me këtë përbërje:
 1. Elmire Nikçi-Rexha, anëtare,
 2. Gresa Lahu, anëtare,
 3. Endrit Zabërgja, anëtar,
 4. Agim Kuleta, anëtar,
 5. Alba Zogaj, përfaqësues nga ekzekutivi, anëtar,
 6. Donat Lushaku, përfaqësuese nga ekzekutivi, anëtar,
 7. Arlinda Kastrati, përfaqësuese nga ekzekutivi, anëtare,
 8. Gresa Deda, përfaqësuese nga sektori i TI.
2. Forumi për transparencë komunale ka për qëllim ngritjen e nivelit të transparencës , llogaridhënës, pjesëmarrjen dhe gjithë përfshirjen e qytetarëve për të kontribuar në fuqizimin dhe përmirësimin e qeverisjes së mirë në komunën tonë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-020/04-77931/24, më 18.6.2024

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Adresa: Rr. UÇK- 2;10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://ecë.prishtina-komuna.org>

RAPORT KONSOLIDUES I PERFORMANCËS FINANCIARE DHE OPERATIVE

Periudha 2024, 2025 dhe Tremujori i Parë 2026

Përmbledhje ekzekutive

Nëse viti 2024 mund të përshkruhet si një vit i konsolidimit, zgjerimit dhe investimit, atëherë viti 2025 duhet lexuar si një vit i sprovës reale për qëndrueshmërinë e Ndërmarrjes Publike Lokale “Prishtina Parking”. Viti 2024 u mbyll me performancë të lartë në realizimin e objektivave, me avancim të dukshëm të infrastrukturës së shërbimeve dhe me një nga zhvillimet më të rëndësishme strategjike të ndërmarrjes, fillimin e procesit të digjitalizimit. Ky proces synonte të shënonte kthesë në mënyrën e ofrimit dhe administrimit të shërbimeve, duke synuar modernizimin e operimit, rritjen e efikasitetit dhe krijimin e një standardi më bashkëkohor të menaxhimit të hapësirave publike të parkimit në Kryeqytet.

Në këtë drejtim, investimet gjatë asaj periudhe arritën edhe kulmin e tyre. Në kuadër të bashkëfinancimit me Komunën e Prishtinës, në projektin e digjitalizimit dhe modernizimit të shërbimeve janë angazhuar gjithsej rreth 2 milionë e 423 mijë euro, ku Komuna e Prishtinës ka participuar me 1.5 milion euro, ndërsa pjesa tjetër, mbi 900 mijë euro, është mbuluar nga vet ndërmarrja. Nga obligimet e ndërmarrjes që burojnë nga kjo kontratë, afërsisht dy të tretat janë përmbushur, ndërsa një pjesë e mbetur vazhdon të mbetet detyrim financiar i hapur, në rrethana që nuk janë krijuar nga mungesa e planifikimit apo e vullnetit për realizim, por nga zhvillimet që pasuan në vitin vijues. Një pjesë e këtyre detyrimeve lidhet pikërisht me projektin e digjitalizimit, për të cilin ndërmarrja kishte investuar në rritjen e kapaciteteve dhe modernizimin e shërbimeve, por kthimi normal financiar i këtyre investimeve u vështirësua pas kufizimeve operative të krijuara më vonë.


Ky momentum pozitiv u ndërpre brutalisht gjatë vitit 2025. Pikërisht në kohën kur ndërmarrja po hynte në një fazë ku investimet pritej të përktheheshin në stabilitet më të madh operacional dhe financiar, ajo u përball me një zhvillim juridik që ndryshoi rrënjësisht kushtet e funksionimit të saj. Viti 2025 ka qenë vit me sfida të shumta dhe rrethana të veçanta për ndërmarrjen, edhe për faktin se në pjesë e dytë të muajit mars kam marrë detyrën si U.D. i Kryeshefit Ekzekutiv. Vetëm pak muaj më pas, në maj 2025, ndërmarrja pranoi aktvendimin e Gjykatës Supreme, i cili ndikoi drejtpërdrejt në mënyrën e operimit të saj dhe kufizoi rëndë aktivitetin bazë të inkasimit. Si pasojë, u krijua një hendek i menjëhershëm financiar, ndërsa aftësia e ndërmarrjes për të realizuar të hyrat e veta u godit në momentin kur ajo kishte nevojë më së shumti për stabilitet, për të përballuar detyrimet e marra në kuadër të investimeve të mëdha të viteve paraprake. Sipas vlerësimeve të brendshme, kufizimi i operimit pas këtij vendimi ka sjellë rënie të inkasimit deri në rreth 70 për qind apo në vlerë monetare rreth 1.2 milion euro dhe ka prodhuar humbje të konsiderueshme të të hyrave potenciale, duke e ngarkuar rëndë ndërmarrjen me probleme likuiditeti dhe me detyrime të akumuluar.

Përkundër kësaj, viti 2025 dhe tremujori i parë i 2026 nuk janë periudhë e dorëzimit, por e menaxhimit të përgjegjshëm në rrethana jashtëzakonisht të vështira. Prioriteti ynë ka qenë ruajtja e stabilitetit institucional, vazhdimësia e funksionimit të ndërmarrjes dhe garantimi i rregullt i pagave për punonjësit, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Ky raport synon t'i paraqesë Komunës së Prishtinës një pasqyrë të përmbledhur të punës dhe zhvillimeve të ndërmarrjes gjatë viteve 2024, 2025 dhe tremujorit të parë të vitit 2026, pikërisht në një moment kur ndërmarrja ka nevojë më shumë se kurrë për mbështetjen e aksionarit të saj, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit financiar, vazhdimësisë operative dhe rikthimit të plotë të kapaciteteve të saj zhvillimore. Kapacitete këto, tashmë të dëshmuara.

1. Të hyrat sipas shitjeve në kategorive dhe kuptimi i ndryshimit 2024–2025-TM1_2026

Kategoria	2024 (€)	2025 (€)	2026 – TM1
Të hyrat nga shërbimet	1,458,870.05	1,240,780.53	281,209.23
Numrat e shkurtër / SMS	992,244.65	639,592.83	194,305.00
Gjoha / bllokada	827,680.00	263,595.00	194,280.00
Banorët rezidentë	138,967.97	83,812.71	/
Të hyra tjera	506.30	596.00	120.3
TOTALI	3,418,268.97	2,228,377.07	634,784.53


Struktura e të hyrave sipas kategorive
2024, 2025 dhe TM1 2026



Shënim: Për kategorinë 'Banorët rezidentë' në TM1 2026, në tabelë paraqitet '/' dhe është lënë si vlerë jo e raportuar.

Rënia prej afro 1.2 milion euro ndërmjet viteve 2024 dhe 2025 nuk është e shpërndarë në mënyrë të barabartë. Goditja më e madhe bie mbi kategorinë e gjobave dhe bllokadave, me ulje prej 564,085 euro. Kjo tregon qartë se modeli i vjetër i arkëtimit ishte i varur në masë të madhe nga zbatimi në terren. Kategoria e SMS-ve ra gjithashtu me më shumë se 352 mijë euro. Kjo është logjike: kur bie intensiteti i kontrollit, bie edhe pagesa vullnetare. Kategoria e shërbimeve ra më pak dhe kjo flet për rezistencën relative të parkingjeve me laura, të biletave fizike dhe të kanaleve të tjera të pagesës. Nga pikëpamja menaxheriale, ky është sinjal i rëndësishëm për modelin e ardhshëm të biznesit.

Hendeku ndërmjet kompensimit të pritur dhe të hyrave reale shtator 2025 - mars 2026



Grafiku paraqet qartë hendekun mes asaj që do të duhej të ishte përfituar nga Ndërmarrja “Prishtina Parking” për shërbimin e kryer dhe asaj që është realizuar realisht në periudhën shtator 2025 – mars 2026. Po të zbatohej modeli i paraparë i kompensimit prej 15 euro për secilën nga 44,630 gjobat e shqiptuara, ndërmarrja do të duhej të kishte realizuar 669,450.00 euro të hyra. Në praktikë, vlera totale e gjobave të inkasuara ka qenë 194,280.00 euro, ndërsa nga kjo shumë ndërmarrjes deri më 31 mars 2026 i janë kthyer vetëm 55,185.00 euro. Kjo tregon se ndërmarrja jo vetëm që nuk është kompensuar sipas shërbimit të ofruar, por edhe në raport me vlerën e gjobave të inkasuara ka përfituar vetëm një pjesë shumë të vogël. Në thelb, grafiku e dëshmon qartë dëmin financiar që i është shkaktuar ndërmarrjes nga mungesa e një mekanizmi të qëndrueshëm dhe të drejtpërdrejtë të inkasimit, duke e lënë atë të varur nga arkëtimi i pjesshëm dhe i pasigurt i gjobave.

Brenda vitit 2025, parkingjet me laura u shndërruan në bazën kryesore të qëndrueshmërisë. Raporti 2025 thekson se mbi 90% e fluksit financiar të Departamentit për Planifikim/Zgjerim dhe Laura vinte pikërisht nga kjo infrastrukturë. Për klientin, mesazhi duhet të jetë i qartë: nuk mjafton të rikthehet vetëm rendi në parkingje, por duhet të forcohen instrumentet që prodhojnë të hyra më të parashikueshme, më pak të cenueshme nga kontestet ligjore dhe më të mbështetura në marrëdhënie kontraktuale, abonime dhe sisteme të mbyllura.

2. Shpenzimet e kategorizuara dhe presioni i kostove fikse

Përshkrimi	2024	2025	TM1 2026
Shpenzimet e zyles	7,131.88	4,592.49	1,030.59
Shpenzimet operative	10,856.66	6,465.50	956.36
Shpenzimet e shitjes	151,881.31	184,320.76	4,389.38
Furnizim me material per zyre	4,472.25	2,043.06	110.74
Shpenzimet e asistimit te policise se Kosoves	213,188.80	76,046.50	0.00
Shpenzimet e internetit per dixhitalizim	0.00	49,619.18	3,828.00
Shpenzimet e Internetit/IT	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet e telefonit	14,173.24	11,719.43	2,354.54
Shpenzimet e rrymes	6,428.88	16,941.07	8,690.26
Furnizim me uje	1,117.12	1,260.03	310.17
Furnizim me Termo leter per laura (tiketa)dhe bileta fizike	13,204.83	0.00	1,455.51
Furnizim me marerial higjenik dhe dezinfektues	1,987.17	1,183.82	343.26
Shpenzimet e qirase	266,206.47	189,477.40	42,008.45
Shpenzimet e sigurimit te objekteve	1,618.67	516.66	0.00
Kompenzim per aksident ne pune	216.90	0.00	0.00
Shpenzimet juridike dhe te auditimit	1,121.99	8,750.41	204.59
Shpenzimet e derivateve	30,673.60	16,329.00	1,152.45
Shpenzimet e pagave	1,732,083.16	1,678,691.46	422,523.18
Shpenzimet e kontributeve pensionale	86,515.91	83,848.33	21,126.20
Shpenzimet e abonimit per arka dhe printer fiskal	1,779.25	1,009.80	202.72
shpenzimet e programi i kontabilitetit	1,200.00	600.00	0.00
Shpenzimet e ngritjes profesionale	7,350.06	1,181.44	480.00
Mirmbajtja e automjeteve	386.51	562.28	22.88
Shpenzimet e mirmbajtjes se vendparkingjeve	5,6057.34	11,410.44	812.43
Shenjezim/Sinjalistike dhe investime ne lagje	28,887.64	9,384.91	0.00
Shpenzimet e mirmbajtjes se bicikletave	0.00	481.26	0.00
Shpenzimet e provizioneve bankare	2,412.03	1,566.05	276.63
Shpenzimet e reklames Marketing	1,961.85	90.00	0.00
Shpenzimet e reprezentacionit	16,681.90	6,149.60	540.2
Shpenzimet e udhetimit jasht vendit	3,925.90	0.00	0.00
Shpenzimet e Byfes	293.33	286.09	82.80
Uniforma	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet per reklam ne gazeta	1,000.59	269.00	0.00
Shpenzimet e lizingut automjete	85,794.00	67,899.25	6,594.93
Shpenzimet e zhvleresimit	77,605.02	283,834.56	120,600.06
Shpenzimet kontigjente	8,362.30	245.56	827.92
TOTALI	2,836,576.56	2,716,775.34	640,924.25

Tabela 2. Zërat kryesorë të shpenzimeve

Nëse viti 2025 analizohet vetëm nga të hyrat, humbet kuptimi i plotë i presionit financiar. Problemi themelor është se shpenzimet nuk mund të ulen me të njëjtin ritëm me të cilin bien të hyrat. Pagat dhe kontributet pensionale mbeten bërthama e kostos. Qiratë, shpenzimet e shitjes, zhvlerësimi, interneti për digjitalizim, lizingu dhe mirëmbajtja nuk mund të eliminohen pa cenuar operimin bazë. Kjo e kthen 2025-n në vit tipik të ekspozimit ndaj kostove fikse, ku ndërmarrja humbi një pjesë të madhe të qarkullimit, por mbeti me detyrimin për të financuar bazën e plotë operative.

Kjo do të thotë se gjendja e dobësuar financiare e vitit 2025 nuk duhet të interpretohet si pasojë e shpenzimit të pakontrolluar. Përkundrazi, arsyeja kryesore qëndron në mospërputhjen midis goditjes juridike mbi të hyrat dhe ngurtësisë së strukturës së kostove. Në raportin final, kjo duhet të artikulohet qartë si problem rregullativ me pasoja financiare, jo si dështim i menaxhimit të brendshëm.

3. Viti 2025, arsyetimi i gjendjes së dobësuar financiare

Viti 2025 duhet përshkruar si vit i ndërprerjes së modelit të mëparshëm të operimit. Deri në muajin maj, ndërmarrja operoi sipas modelit të zakonshëm të zonave komerciale dhe rezidenciale. Pas aktvendimit të Gjykatës Supreme, kontrollorët vazhduan të ishin në terren, por për një periudhë prej më shumë se 4 muaj nuk mund të ushtronin kompetencat klasike të shqiptimit të biletave 24-orësh dhe bllokimit. Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës u pezullua në maj.

Raporti 2025 tregon se operimi rifilloi pjesërisht në shtator, përmes modelit të gjobave mandatore të lëshuara në emër të Drejtorisë së Inspektionit. Kjo ndihmoi të rikthehej rendin, por nuk e riktheu peshën financiare të modelit 2024. Vetëm kategoria e gjobave ra me 68%. Biletat fizike në zonën 1 ranë rreth 72%, ndërsa në zonën 2 rreth 51.7%. Aplikacioni ra 47% dhe SMS 35%. Në të kundërt, pagesat mujore tek njësia me laura mbetën stabile.

Nga këndvështrimi i fitimit apo humbjes, arsyetimi duhet dhënë në tri shtresa. Së pari, arsye juridike: pezullimi i bazës rregullative uli kapacitetin për arkëtim. Së dyti, arsye operative: mungesa e ndëshkimit në terren uli disiplinimin e përdoruesve dhe rriti ankesat. Së treti, arsye financiare: shpenzimet fikse mbetën të larta. Kjo treshe e bën 2025-n vit tranzicioni dhe jo thjesht vit me rezultat negativ. Raporti final duhet ta ruajë këtë nuancë: ndërmarrja nuk u përball me dështim funksional, por me ndryshim të papritur të rregullave të lojës.

4. Të punësuarit sipas departamenteve dhe funksionet

	2024	2025	TM1 2026
Aksionarët	3	3	3
Bordi I drejtorëve	4	4	3
Kabineti I KE	5	5	5
Sekretari	0	1	1
Dap. i financave	10	9	9
Dep. I Prokurimit	1	2	2
Dep. Ligjor	5	6	6
Dep. IT-së	5	6	5
Dep. Administratës	10	13	13
Dep. Zhv. Biznesit	51	2	2
Dep. Për Planifikim dhe Laura	2	52	52
Dep. Operimeve	82	79	78
Dep. I Personelit	7	5	6
Dep. Auditimit të Brendshëm	2	2	2
Divizioni për Komunikim Publik	4	3	2
Divizioni për Menaxhim të Bëçikletave	2	2	2
Çertifikues	1	1	1
Zyrtar për Mbrojtjen e të Dhënave	1	1	1
Zyrtar për Siguri dhe Shëndet në Punë	1	1	1
TOTALI për vite	196	197	194

Struktura e stafit sipas njësive organizative tregon qartë se Departamenti i Operimeve mbetet njësia më e ngarkuar në kuadër të ndërmarrjes, për shkak të natyrës së drejtpërdrejtë dhe të përditshme të shërbimeve që ofron. Në këtë departament përfshihen sportelet e shërbimit ndaj qytetarëve, qendra e thirrjeve (call center), si dhe kontrollorët dhe bllokuesit e parkingjeve të hapura, pra funksione që kërkojnë angazhim të vazhdueshëm në terren dhe kontakt të drejtpërdrejtë me përdoruesit e shërbimeve. Për këtë arsye, ky departament mban edhe barrën kryesore operacionale të ndërmarrjes.

Ndërkaq, Departamenti për Planifikim, Zgjerim dhe Laura mbulon një segment tjetër të rëndësishëm të aktivitetit të ndërmarrjes, pasi në të përfshihen zyrtarët, përkatësisht inkasantët, të angazhuar në parkingjet me laura. Organizimi i stafit në këtë departament reflekton nevojën reale të funksionimit të këtij shërbimi në terren. Në këtë drejtim, ndërmarrja ka arritur të ruajë një qasje të shëndoshë të rekrutimit, duke i përshtatur kapacitetet njerëzore me nevojat konkrete të punës, pa krijuar mbingarkesë të panevojshme në strukturën e përgjithshme të stafit.

Po ashtu, është me rëndësi të theksohet se numri aktual i punonjësve për TM1 2026 duhet lexuar edhe në raport me gjendjen faktike të angazhimit në punë. Aktualisht, 3 punonjëse janë në pushim të lehonisë, ndërsa rreth 4 punonjës janë në pushim pa pagesë, që do të thotë se në praktikë janë rreth 7 punonjës më pak nga numri aktual i evidentuar. Rrjedhimisht, ngarkesa reale e punës për stafin aktiv është edhe më e lartë sesa mund të kuptohet vetëm nga paraqitja numerike e strukturës së punonjësve.

5. Investimet kapitale, zgjerimi i aktiviteteve dhe gjendja momentale

Investimet kapitale janë ndër pjesët më të forta të narrativës së këtij raporti. Viti 2024 shënon vendosjen e rreth 2,000 pajisjeve për digjitalizim të vendparkingjeve në qendër, Dardani, Ulpianë dhe Breg të Diellit. Po ashtu, janë realizuar ndërhyrje urgjente infrastrukturore në rrugët Elez Geci dhe 2 Nëntori, me 127 respektivisht 80 vendparkime të reja. Ka vazhduar shenjëzimi horizontal dhe vertikal, duke përfshirë edhe hapësirat për persona me aftësi të kufizuara. Këto investime tregojnë se ndërmarrja nuk operon vetëm si inkasues i tarifave, por si menaxhues real i hapësirës publike urbane. Edhe në vitin 2025, pavarësisht presionit financiar, linja strategjike e digjitalizimit dhe e mirëmbajtjes nuk u ndërpre. Raporti përmend implementimin e mëtejshëm të sistemeve të menaxhimit, përgatitjen teknike për Divizionin e B biçikletave, riaktivizimin e sistemit të gjobave dhe SMS-ve në shtator, si dhe planin për zgjerim të kapaciteteve në 2026. Kjo tregon se gjendja momentale financiare duhet përshkruar si fazë rikuperimi të menaxhuar. Ndërmarrja nuk hyn në 2026 me shenja të tkurrjes strukturore, por me bazë operacionale të ruajtur, me infrastrukturë ekzistuese funksionale dhe me plan të qartë zgjerimi. Në përmbledhje, viti 2024 duhet lexuar si vit i konsolidimit dhe i investimeve, 2025 si vit i goditjes juridike dhe i presionit financiar, ndërsa 2026 shpresojmë të jetë si vit i parë i rimëkëmbjes së modelit të ri.

6. Struktura e detyrimeve financiare

Si rezultat i kufizimeve operative, rënies së theksuar të inkasimit dhe bartjes së obligimeve të krijuara nga investimet dhe funksionimi i rregullt i ndërmarrjes, aktualisht N.P.L. “Prishtina Parking” bart një borxh total prej rreth 900,000.00 euro, i strukturuar si në vijim:

- Rreth 300,000.00 euro janë obligime të papaguara që lidhen me projektin e digjitalizimit.
- Rreth 190,000.00 euro janë obligime për sistemin operativ në të cilin funksionon ndërmarrja, borxh i akumuluar pjesërisht edhe nga viti 2024, për shkak se operatori përkatës nuk ka faturuar deri në pjesën e dytë të vitit 2025.
- Rreth 150,000.00 euro janë detyrime nga qiratë, përfshirë zyrat dhe parkingun në rrugën “Rinia”.
- Rreth 100,000.00 euro janë detyrime ndaj Policisë së Kosovës.
- Rreth 60,000.00 euro janë obligime ndaj stafit të ndërmarrjes, për pjesën e mbetur të pagës së muajit gusht 2025.
- Rreth 60,000.00 euro janë detyrime për sigurim shëndetësor, të papaguara që nga muaji gusht 2025.
- Pjesa tjetër përbëhet nga detyrime ndaj operatorëve dhe kontraktorëve të ndryshëm.

7. Kërkesa për subvencion

Duke pasur parasysh gjendjen aktuale financiare të ndërmarrjes, nivelin e obligimeve të papaguara dhe nevojën për ruajtjen e funksionimit të pandërprerë të shërbimit publik, **kërkesa për subvencion ndaj aksionarit është në vlerë prej 700,000.00 euro**. Kjo shumë kërkohet si masë e domosdoshme për tejkalimin e situatës së krijuar, stabilizimin financiar të ndërmarrjes dhe krijimin e kushteve minimale për vazhdimin e operimit deri në stabilizimin e plotë të saj.

Vlera e kërkuar do të përdoret për **mbulimin e kostove që burojnë nga obligimet e papaguara të ndërmarrjes**, për menaxhimin e ngarkesës aktuale financiare dhe për ruajtjen e likuiditetit të nevojshëm për funksionimin e rregullt. Në këtë mënyrë, subvencioni nuk paraqet një mbështetje për zgjerim të shpenzimeve, por një ndërhyrje të nevojshme për ruajtjen e qëndrueshmërisë bazë të ndërmarrjes dhe shmangien e thellimit të mëtejshëm të vështirësive financiare.

Njëkohësisht, ndërmarrja e rithekson se do t'i shfrytëzojë **të gjitha potencialet e saj operative**, me përkushtim të plotë për të rikthyer stabilitetin dhe për të kaluar në operim pozitiv sapo të krijohen kushtet e nevojshme rregullative dhe financiare. Në këtë kuptim, ndërmarrja shpreh gatishmërinë dhe zotimin që, brenda një periudhe prej **një (1) viti**, këto mjete të kthehen përmes operimit pozitiv, duke rikthyer qëndrueshmërinë financiare të saj dhe duke mundësuar kthim për aksionarin përmes **dividendës**.

Përfundim

Periodha 2024, 2025 dhe tremujori i parë i vitit 2026 e dëshmojnë qartë një gjë: N.P.L. “Prishtina Parking” Sh.A. ka kapacitet institucional, kapacitet operativ dhe staf të përgatitur për të ofruar shërbim publik me rëndësi për Kryeqytetin. Viti 2024 ishte vit i performancës së lartë, i investimeve dhe i zgjerimit të kapaciteteve, ndërsa viti 2025 dhe TM1 2026 e vunë ndërmarrjen përballë një prove shumë më të rëndë, asaj të mbijetesës financiare dhe institucionale në kushte të kufizuara operimi. Edhe në këto rrethana, ndërmarrja ka vazhduar punën, ka ruajtur funksionimin bazë, ka mbajtur stafin aktiv dhe ka garantuar vazhdimësinë e shërbimeve në masën që e kanë lejuar rrethanat.

Megjithatë, ky raport konfirmon po ashtu se pa një bazë të qartë dhe të qëndrueshme rregullative, nuk mund të ketë stabilitet të qëndrueshëm financiar për ndërmarrjen. Ndërmarrja nuk mund të funksionojë në mënyrë stabile pa një Rregullore që ia mundëson inkasimin e mjeteve të veta në mënyrë të drejtpërdrejtë. Çdo model tjetër, sado që mund të ndihmojë përkohësisht, mbetet i brishtë dhe i pamjaftueshëm për të garantuar siguri financiare, planifikim afatmesëm dhe përmbushje të rregullt të obligimeve. Bashkëpunimi me Drejtorinë e Inspektionit ka qenë korrekt, institucional dhe në nivel shumë të lartë, por forma e tërthortë e gjenerimit të të hyrave nuk e zëvendëson dot një model të qëndrueshëm të inkasimit vetanak.

Këtë e dëshmojnë edhe të dhënat konkrete të periudhës së bashkëpunimit me Komunën. Nga shtatori 2025 deri në fund të marsit 2026 janë shqiptuar rreth 46 mijë gjoba. Megjithatë, sipas marrëveshjes në fuqi, ndërmarrja përfiton 15 euro vetëm për ato gjoba që arrijnë të inkasohen realisht, jo për numrin e përgjithshëm të gjobave të shqiptuara. Problemi thelbësor qëndron pikërisht këtu: niveli i arkëtimit nuk e kalon 30% të totalit. Kjo do të thotë se edhe kur ndërmarrja dhe stafi i saj janë të angazhuar në terren, edhe kur puna operacionale kryhet, të hyrat reale mbeten të pasigurta, të vonuara dhe të varura nga faktorë që ndërmarrja nuk i kontrollon vetë. Me këtë logjikë, ndërmarrja nuk mund të ndërtojë stabilitet.

Për më tepër, kjo gjendje ndikon drejtpërdrejt edhe në mundësinë e ndërmarrjes për të mbuluar detyrimet ekzistuese dhe për të ruajtur ritmin normal të zhvillimit. Një ndërmarrje publike që nuk e kontrollon në mënyrë të drejtpërdrejtë gjenerimin dhe inkasimin e të hyrave të veta, në praktikë mbetet e ekspozuar ndaj mungesës së likuiditetit, vonesave në pagesa dhe pamundësisë për të planifikuar me siguri investimet, kontratat dhe shpenzimet operative. Kjo është arsyeja pse çështja e rregullores nuk është vetëm çështje procedurale, por çështje e vetë funksionalitetit të ndërmarrjes.

Stabilizimi i plotë i N.P.L. “Prishtina Parking” kërkon vendimmarrje të shpejtë dhe të qartë nga aksionari përmes **subvencionimit në vlerë prej 700,000.00 €**, si ndërhyrje direkte për stabilizim financiar dhe menaxhim të detyrimeve kritike, si dhe përmes miratimit të kornizës rregullative që i jep ndërmarrjes të drejtën dhe mekanizmin për inkasim të drejtpërdrejtë të mjeteve të veta me çmime që reflektojnë realitetin e tregut dhe sigurojnë qëndrueshmëri të ndërmarrjes. Pa këtë hap, çdo zgjidhje tjetër mbetet e përkohshme. Me këtë hap, ndërmarrja jo vetëm që mund të stabilizohet, por mund të rikthehet në trajektoren e zhvillimit që e kishte nisur me sukses në vitin 2024.

Në fund, ky raport duhet të lexohet edhe si dëshmi se ndërmarrja nuk ka dështuar. Përkundrazi, ajo ka vazhduar të funksionojë edhe në rrethana të pafavorshme, ka ruajtur shërbimin, ka mbajtur barrën operative dhe ka treguar qëndrueshmëri. Tani nevojitet që kësaj qëndrueshmërie t’i përgjigjet edhe mbështetja institucionale që i takon. Vetëm kështu “Prishtina Parking” mund të kalojë nga një fazë e menaxhimit të krizës në një fazë të rikthimit të plotë të stabilitetit dhe zhvillimit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/ L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës“, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më _____, merr këtë

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR NDËRMARRJEN
“PRISHTINA PARKING”

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për ndërmarrjen “ **Prishtina Parking**” për stabilizimin financiar të ndërmarrjes.

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 700,000.00 € (Shtatëqind mijë euro), shumë kjo e siguruar nga -----.

III.

Qëllimi i këtij Vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, për ndërmarrjen “**Prishtina Parking**” të cilat Komuna e Prishtinës i ndan si mbështetje financiare për stabilizimin financiar të ndërmarrjes dhe shmangien e një rreziku real për paralizim të funksionimit të saj.

IV.

Pjesë e këtij vendimi është kërkesa, e ndërmarrjes “ **Prishtina Parking**”

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë e tjera relevante.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditën pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Për:	z. Përparim Rama, Kryetar i Komunës së Prishtinës
Nga:	z. Amir Kozmaqi, U.D. i Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Prishtina Parking"
Lënda:	Kërkesë për subvencionim urgjent në mbështetje të stabilizimit financiar të ndërmarrjes
Datë:	23.05.2026

I nderuar Kryetar i Prishtinës, z. Përparim Rama,

Po ju drejtohem në cilësinë e U.D. të Kryeshefit Ekzekutiv të N.P.L. "Prishtina Parking" Sh.A. me një kërkesë të drejtpërdrejtë për subvencionim urgjent në vlerë prej **700,000.00 €**, me qëllim stabilizimin financiar të ndërmarrjes dhe shmangien e një rreziku real për paralizim të funksionimit të saj.

Ndërmarrja ka performuar mirë në vitet e fundit. Ka rritur të hyrat, ka zgjeruar shërbimet dhe ka vendosur një standard të ri të menaxhimit të hapësirave publike në kryeqytet. Megjithatë, inkasimi real i këtyre të hyrave është ndërprerë në mënyrë të menjëhershme si pasojë e vendimit të Gjykatës Supreme, i cili për rreth pesë muaj e ka kufizuar rëndë operimin dhe ka krijuar një hendek financiar që sot reflektohet në detyrime të akumuluar dhe mungesë të likuiditetit.

Në periudhën rreth pesë mujore pas këtij vendimi, ndërmarrja ka pësuar rënie të inkasimit deri në rreth **70%**, duke humbur rreth 1.2 milion € potencial të të hyrave (sipa një analize të brendshme) nga maji 2025 e deri më tani. Kjo humbje ka shkaktuar një ndërprerje të ciklit financiar që ka prodhuar pasoja të drejtpërdrejta në qëndrueshmërinë e ndërmarrjes.

Përkundër kësaj, kemi mbajtur një vijë të qartë menaxheriale: kemi garantuar pagesat e punonjësve dhe bashkarisht me ju kemi ruajtur funksionalitetin bazë të ndërmarrjes. Bashkëpunimin me komunën e kemi shumë të mirë, por edhe pse si ndërmarrje po asistojmë në gjoba, nuk po i marrim këto të hyra dhe vështirësitë më të mëdha po janë në realizimin e tyre. Deri më tani kemi inkasuar vetëm 1/3 e mjeteve financiare.

Nga maji 2025 e deri më sot, kemi arritur të menaxhojmë situatën përmes komunikimit dhe mirëkuptimit me operatorët dhe partnerët, duke e shtyrë në kohë një pjesë të detyrimeve dhe duke shmangur masa të menjëhershme ndaj ndërmarrjes. Në disa raste, edhe përkundër procedurave përmbartimore të fituara nga operatorët, kemi arritur të menaxhojmë situatën përmes angazhimit të drejtpërdrejtë dhe marrëveshjeve praktike, duke mbajtur funksionimin aktiv. Kjo po kërkon investim të kohës e gjithë potencialit personal vetëm që të kemi mirëkuptimin e tyre.

Megjithatë, kjo qasje nuk është më e qëndrueshme.

Sot, ndërmarrja bart një **borxh total prej rreth 900,000.00 €**, i strukturuar si vijon:

- Rreth **300,000.00 €** janë obligime të papaguara që lidhen me projektin e digjitalizimit. Ndërmarrja, në bashkëfinancim me Komunën, ka investuar

rreth 1 milion € në digjitalizimin dhe furnizimin me internet të Smart City, nga të cilat rreth 700,000.00 € janë paguar tashmë, ndërsa pjesa e mbetur ka mbetur si detyrim. Praktikisht, ndërmarrja ka investuar në mënyrë të drejtë për të rritur kapacitetet dhe për të modernizuar shërbimet, por ndërhyrja e vendimit të Gjykatës ka pamundësuar realizimin normal të kthimit financiar të këtyre investimeve. Kjo e ka bërë shumë të kushtueshme këtë pjesë të investimit.

- Rreth 150,000.00 € janë detyrime nga qiratë (zyra dhe parkingu në rrugën "Rinia").
- Rreth 100,000.00 € janë detyrime ndaj Policisë së Kosovës.
- Rreth 55,000.00 € janë detyrime për sigurim shëndetësor, të papaguara që nga muaji gusht 2025.
- Pjesa tjetër përbëhet nga detyrime ndaj operatorëve dhe kontraktorëve të ndryshëm.

Këto janë rrjedhojë direkte e ndërprerjes së inkasimit dhe jo e menaxhimit të dobët.

Paralelisht, ndërmarrja po përballet edhe me një problem shtesë: për rreth 7 muaj, përkundër faturimit të rregullt ndaj Komunës për shërbimet e kryera, bashkëpunimit korrekt dhe koordinimit me Drejtorin e Inspektionit, si dhe duke ju përmbajtur rregullave nga të dyja palët inkasimi nga komuna ka qenë minimal, vetëm rreth 56,000.00 € për muajt janar–shkurt 2026, ndërsa për muajt shtator – dhjetor të vitit 2025 mbesin rreth 105,000.00 € të pa inkasuara, edhe pse janë faturuar. Kjo po krijon jo vetëm mungesë likuiditeti, por edhe detyrime shtesë tatimore, përfshirë TVSH-në.

Në këto rrethana, rreziku është konkret dhe i menjëhershëm. Bllokimi i llogarive nga një operator do të nënkuptonte:

- ndërprerjen e shërbimit të pagesave përmes SMS dhe shërbimit të kontrollave,
- pamundësi për të ekzekutuar pagat,
- dhe paralizim të plotë të funksionimit të ndërmarrjes.

Pra, kjo përbën një rrezik sistemik për vet funksionin e ndërmarrjes dhe ofrimin e shërbimit ndaj qytetarëve.

Në këtë kontekst, vlerësojmë se stabilizimi i ndërmarrjes kërkon tri masa të menjëhershme dhe të koordinuara:

1. **Procesimin e pagesave të faturuara nga ndërmarrja ndaj Komunës**, në mënyrë që të rikthehet një pjesë e likuiditetit të munguar;
2. **Subvencionimin në vlerë prej 700,000.00 €**, si ndërhyrje direkte për stabilizim financiar dhe menaxhim të detyrimeve kritike;
3. **Miratimin e rregullores** që lejon Ndërmarrjen të inkasoj mjetet e veta dhe çmime që reflektojnë realitetin e tregut dhe sigurojnë qëndrueshmëri të ndërmarrjes.

Edhe njëherë, theksojmë që ndërmarrja nuk e ka humbur kapacitetin për të operuar. Përkundrazi, e ka dëshmuar atë. Ajo që mungon sot është një ndërhyrje e shpejtë për të tejkaluar një situatë të krijuar nga faktorë jashtë kontrollit të saj.

Duke e njohur bashkëpunimin tonë dhe qasjen tuaj ndaj ndërmarrjeve publike, po e parashtroj këtë kërkesë me bindjen se do të vlerësohet drejt urgjenca dhe pesha e saj.

Jam në dispozicion për çdo sqarim shtesë.

Me respekt,
Amir Kozmaqi
U.D. Kryeshef Ekzekutiv
N.P.L. "Prishtina Parking" Sh.A.





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008"), nenit 21 të Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10/2019"), nenit 5, paragrafi 1, pika 1.2, lidhur me nenin 24 dhe nenin 25 të Rregullores (QRK) nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së Paluajtshme të Komunës, kërkesës me nr. 13-353/01-142581/25, dt. 17.9.2025, nenit 34, paragrafi 34.1, pika (d) e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më _____, merr këtë

VENDIM

Për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim NP "Termokos", SHA.

1. Miratohet vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës NP "Termokos", SHA;
2. Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim sipas pikës 1 të këtij vendimi është:
 - Pjesa e parcelës kadastrale, me nr. P-71914059-06118-1, në sipërfaqe prej 37 m²
 - Pjesa e parcelës kadastrale, me nr. P-71914059-06119-3, në sipërfaqe prej 98 m².
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën 2 të këtij vendimi, është dhënia në shfrytëzim e pronës komunale e cila është kërkuar nga NP "Termokos", SHA, për ndërtim të Stacionit pompues për projektin Solar 4 Kosova;
4. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 2 të këtij vendimi, është në afat për 10 vjet, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike;
5. Prona e paluajtshme sipas pikës 2 të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim;
6. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të objektit do të caktohen me kontratë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit.

7. Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës;
8. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës;
9. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:
 - Kërkesa,
 - Kopja e planit dhe certifikata e pronës.
10. Ky Vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

Arsyetim

N.P. "Termokos" Sh.A, Prishtinë, përmes shkresës me numër 13-353/01-142581/25, të datës 17.09.2025, ka kërkuar nga Drejtoria e Pronës që të procedohet me dërgimin e propozimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, konkretisht:

- pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-71914059-06118-1, në sipërfaqe prej 37 m²
- pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-71914059-06119-3, në sipërfaqe prej 98 m²

Në Zonën Kadastrale Prishtinë, për qëllim të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në favor të N.P. "Termokos" Sh.A., Prishtinë.

Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është dhjetë (10) vjet, duke ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste të veçanta. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës do të përcaktohen me kontratë, e cila do të lidhet ndërmjet Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe shfrytëzuesit.

Në bazë të dispozitave ligjore të përmendura në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe dokumentacionit përkatës të lëndës, u vendos si në dispozitiv të këtij propozimi.

17-09-2025

13-353/01-142581/26 Nr. 2203 Dt. 17.09.25

Për:	z. Brahim Mehmetaj – Drejtor i Drejtorisë së Pronës pranë Komunës së Prishtinës
Kopje:	z. Perparim Rama - Kryetarë i Komunës së Prishtinës z. Shkemb Manaj - Nënkyetarë i Komunës së Prishtinës z. Florian Dushi- Nënkyetarë i Komunës së Prishtinës
Nga:	z. Driton Hyseni, - Drejtor i Dep. Për Zhvillim dhe Investime Kapitale- N.P Termokos Sh.a
Referencë:	Kerkese per shfrytëzim te pronës së komunës (nr Ref.13-343/01-28385/25)
Subjekti:	Kerkese per shfrytëzim te pronës /ndërtim te Stacionit pompues per projektin Solar4Kosovo
Data:	17.09.2025

I nderuar z. Mehmetaj,

Në emër të N.P "Termokos" SH.A, si Agjencisë Ekzekutuese e Projektit *Solar4Kosovo*, duke iu referuar edhe shkresës sonë të datës 22.11.2024 (nr Ref.13-343/01-28385/25), në konsultim me stafin e juaj profesional, ju drejtohem i përsëri me kërkesën për mundësimin e shfrytëzimit të parcelave në pronësi të Komunës së Prishtinës, të nevojshme për ndërtimin e stacionit pompues në kuadër të këtij projekti (i cili është ridizajnuar).

N.P. "Termokos" sh.a, si ndërmarrje publike e Komunës së Prishtinës, është duke zbatuar projekte të rëndësishme investive me mbështetje të donatorëve ndërkombëtarë, si Banka Gjermane KfW, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), si dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Këto projekte zhvillohen mbi bazën e marrëveshjes së datës 11.12.2023 të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Financave dhe N.P. "Termokos" për zbatimin e projektit *Solar4Kosovo*, si dhe marrëveshjes së veçantë të financimit me vlerë prej 53.1 milionë euro nga KfW, 23.2 milionë euro nga BERZH, dhe 4.4 milionë euro kontribut nga vetë N.P. "Termokos".

Bazuar në Raportin Fillestar (rev.02) të dorëzuar më 04.06.2024 dhe miratuar më 19.11.2024 nga KfW, si dhe në Raportin e Planifikimit dhe Projektimit të Projektit (rev.03) të dorëzuar më 21.10.2024 dhe miratuar më 29.10.2024 nga KfW, është paraparë ndërtimi i një stacioni pompues pranë stadiumit, në rrugën e tubacionit të ri të transmetimit të ngrohjes qendrore.

Ky stacion është i domosdoshëm për të siguruar presionin e nevojshëm në pikën më të lartë të rrjetit në Rrugën "Stambolli" / Rrugën "Toni Bleri" në lagjen Dragodan.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PROPOZIM

Në bazë të nenit 58, shkronjës h të ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr.10/03 prill 2019), nenit 26, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 të Rregullores QRK nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 52 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01.Nr. 110-391, dt. 25.02.2010, dhe kërkesës me nr.13-353/01-142581/25, dt. 17.09.2025, në cilësi të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, me datën: 19.03.2026,

PROPOZIJ

I. Kuvendit të Komunës së Prishtinës, propozim miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, në shfrytëzim N.P “Termokos” Sh.A.

II. Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim, e cekur në pikën I të këtij propozimi, është:

1. Pjesa e parcelës kadastrale me nr. P-71914059-06118-1, në sipërfaqe prej 37 m².
2. Pjesa e parcelës kadastrale me nr. P-71914059-06119-3, në sipërfaqe prej 98 m².

III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është dhënia në shfrytëzim e pronës Komunale e cila është kërkuar nga N.P. “Termokos” Sh.A, për ndërtim te Stacionit pompues për projektin Solar 4 Kosova.

IV. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është në afat për 10 vite, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike.

V. Prona e paluajtshme e cekur në pikën II të këtij propozimi jepet në shfrytëzim pa kompensim.

VI. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të objektit, do të caktohen me kontratë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit.

VII. Ky propozim hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e marrjes së tij.

Arsyetim

N.P. "Termokos" Sh.A, Prishtinë, përmes shkresës me numër 13-353/01-142581/25, të datës 17.09.2025, ka kërkuar nga Drejtoria e Pronës që të procedohet me dërgimin e propozimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, konkretisht:

- pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-71914059-06118-1, në sipërfaqe prej 37 m.
- pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-71914059-06119-3, në sipërfaqe prej 98 m².

Në Zonën Kadastrale Prishtinë, për qëllim të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në favor të N.P. "Termokos" Sh.A., Prishtinë.

Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është dhjetë (10) vjet, duke ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste të veçanta. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës do të përcaktohen me kontratë, e cila do të lidhet ndërmjet Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe shfrytëzuesit.

Në bazë të dispozitave ligjore të përmendura në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe dokumentacionit përkatës të lëndës,
u vendos si në dispozitiv të këtij propozimi.

Iu dërgohet:

- Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, dhe
- Qendrës për shërbime me qytetarë.

Kryetari i Komunës

Përparim Rama



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësiror dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71914059-06118-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

11-942/03-0005542/26

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

13.01.2026 - 13:24

Komuna / Opština / Municipality:

PRISHTINË / PRISHTINA / PRISHTINE

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Prishtinë / Prishtina / Prishtine

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

PRISHTINË / PRISHTINA / PRISHTINE

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Pëshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71914059-06118-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL.	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	382	1-1996.R.F.P.174/2014	31.10.2014	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
REXHEP LUÇI			31.10.2014	

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m ²)
1	Tokë Tjetër/Ostalo Zemijste/Other Land	Jo Pjellore/Neplodno/Unproductive		382

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Prishtinës	600340707	/ / /		UÇK	1/1	1-1996	03.11.2014



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedistit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71914059-06119-3

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

11-942/03-0005542/26

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

13.01.2026 - 13:24

Komuna / Opština / Municipality:

PRISHTINË / PRIŠTINA / PRISHTINË

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Prishtinë / Priština / Prishtinë

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

PRISHTINË / PRIŠTINA / PRISHTINË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71914059-06119-3	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	298	201-1997.R.F.P.174/2014	31.10.2014	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
STARA CENTRALA			31.10.2014	



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta korisjenja parcele Parcel Type Of Use	Shtfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno korisjenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area (m ²)
1	Infrastruktura/Infrastruktura/Infrastructure	Rruge/Put/Road		298

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi posttal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	P.SH. RRUGË KK.PRISHTINA	KCID1917539	PRISHTINË / PRISHTINA / PRISHTINË /		19	1/1	201-1997	03.11.2014



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PRISHTINË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Prishtinë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71914059-06118-1	Parcelë / Parcela / Parcel	382



Shkalla/Razmera/Scale: 1:372



Punoi/Obradio/Created: Drenusha Shala

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 13.01.2026

Koha/ Vreme/ Time: 01:26:34




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PRISHTINË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Prishtinë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m ²
P-71914059-06119-3	Parcelë / Parcela / Parcel	298



Shkalla/Razmera/Scale: 1:427

Punoi/Obradio/Created: Drenusha Shala

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 13.01.2026

Koha/ Vreme/ Time: 01:27:03

Zona Kadastrale: Prishtinë

1. Numri i parcelës: P-71914059-06118-1

Sipërfaqja totale : 382m²

Pjesë e parcelës me nr.6118-1 me sip.37m² e kërkuar nga Termokosi

Pronar: Komuna e Prishtinës

2. Numri i parcelës: P-71914059-06119-3


Sipërfaqja totale : 298m²

Pjesë e parcelës me nr.6119-3 me sip.98m² e kërkuar nga Termokosi

Pronar: P.SH. Rrugë KK Prishtinë

Lagjja/Fshati: Prishtinë


Adresa: Lokacioni i kërkuar nga Termokosi te Stadiumi Fadil Vokrri



— -Kufiri i parcelave sipas planeve kadastrale
— -Lokacioni i kërkuar për Stacion pompues nga Termokosi

Punoi:
Sokol Gashi -zyrtar për gjeodezi

Prishtinë, 22.09.2025





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008"), nenit 21 të Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10/2019"), nenit 5, paragrafi 1, pika 1.2, lidhur me nenin 24 dhe nenin 25 të Rregullores (QRK) nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së Paluajtshme të Komunës, kërkesës me nr. 13-353/01-20510/26, dt. 6.2.2026, nenit 34, paragrafi 34.1, pika (d) e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më , merr këtë

VENDIM

Për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim NP "Termokos", SHA.

1. Miratohet vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës NP "Termokos", SHA;
2. Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim sipas pikës 1 të këtij vendimi është:
 - Pjesa e parcelës kadastrale, me nr. P-71914059-07090-21, në sipërfaqe prej 18.m².
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën 2 të këtij vendimi, është dhënia në shfrytëzim e pronës komunale e cila është kërkuar nga NP "Termokos", SHA, për ndërtim të Stacionit pompues për projektin Solar 4 Kosova;
4. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 2 të këtij vendimi, është në afat për 10 vjet, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike;
5. Prona e paluajtshme sipas pikës 2 të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim;
6. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të objektit do të caktohen me kontratë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit.

7. Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës;
8. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës;
9. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:
 - Kërkesa,
 - Kopja e planit dhe certifikata e pronës.
10. Ky Vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

Arsyetim

N.P. "Termokos" Sh.A, Prishtinë, përmes shkresës me numër 13-353/01-20510/26, të datës 6.2.2026, ka kërkuar nga Drejtoria e Pronës që të procedohet me dërgimin e propozimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, konkretisht:

- pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-71914059-07090-21, në sipërfaqe prej 18 m².

Në Zonën Kadastrale Prishtinë, për qëllim të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në favor të N.P. "Termokos" Sh.A., Prishtinë.

Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është dhjetë (10) vjet, duke ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste të veçanta. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës do të përcaktohen me kontratë, e cila do të lidhet ndërmjet Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe shfrytëzuesit.

Në bazë të dispozitave ligjore të përmendura në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe dokumentacionit përkatës të lëndës, u vendos si në dispozitiv të këtij propozimi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PROPOZIM

Në bazë të nenit 58, shkronjës h të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr.10/03 prill 2019), nenit 26, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 të Rregullores QRK nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 52 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, dhe kërkesës me nr.13-353/01-20510/26, dt. 06.02.2026, në cilësi të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, më 19.3.2026, i

PROPOZ O J

I. Kuvendit të Komunës së Prishtinës, propozim-miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, në shfrytëzim NP “Termokos”, SHA.

II. Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim, e cekur në pikën I të këtij propozimi, është:

1. Pjesa e parcelës kadastrale me nr. **P-71914059-07090-21**, në sipërfaqe prej **18.m²** .

III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është dhënia në shfrytëzim e pronës Komunale e cila është kërkuar nga NP “Termokos”, SHA, për ndërtim të Stacionit pompues për projektin Solar 4 Kosova.

IV. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është në afat për 10 vjet, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike.

V. Prona e paluajtshme e cekur në pikën II të këtij propozimi jepet në shfrytëzim pa kompensim.

VI. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të objektit, do të caktohen me kontratë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit.

VII. Ky propozim hyn në fuqi në ditën e nesërme nga dita e marrjes së tij.

A r s y e t i m

NP “Termokos”, SHA, Prishtinë, përmes shkresës me numër 13-353/01-20510/26, të datës 6.2.2026, ka kërkuar nga Drejtoria e Pronës që të procedohet me dërgimin e propozimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, konkretisht:

- **pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-71914059-07090-21, në sipërfaqe prej 18 m².**

Në Zonën Kadastrale Prishtinë, për qëllim të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në favor të NP “Termokos” SHA, Prishtinë.

Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është dhjetë (10) vjet, duke ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste të veçanta. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës do të përcaktohen me kontratë, e cila do të lidhet ndërmjet Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe shfrytëzuesit.

Në bazë të dispozitave ligjore të përmendura në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe dokumentacionit përkatës të lëndës, u vendos si në dispozitiv të këtij propozimi.

Iu dërgohet:

- Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, dhe
- Qendrës për shërbime me qytetarë.

Kryetari i Komunës

Përparim Rama

Për:	Z. Brahim Mehmetaj – Drejtor i Drejtorisë së Pronës pranë Komunës së Prishtinës
Kopje:	Z. Perparim Rama - Kryetar i Komunës së Prishtinës Z. Shkëmb Manaj - Nënkyetar i Komunës së Prishtinës
Nga:	Z. Kastriot Billaca -U.d. Kryeshef Ekzekutiv i NQ Termokos Z. Naim Bujupi – Kryesues i Njësisë Zbatuese
Referencë:	Kërkesë për shfrytëzim të një pjese të pronës së komunës brenda parcelës kadastral nr. 7090-21. Zona Kadastrale Prishtinë
Subject:	Kërkesë për shfrytëzim të pronës komunale/ndërtim të stacionit shtytës pompues për projektin Solar4Kosovo _LOT2 afër Shkolles “Naim Frasheri” Prishtinë.
Date:	05.02.2026



KËRKESË

Plotësim I Lëndës – Shfrytëzim I Pronës Komunale



PËR PLOTËSIM TË LËNDËS

Me këtë shkresë bëjmë plotësimin e lëndës me numër **13-353/01-142581/25**, të datës **17.09.2025**, lidhur me kërkesën për marrje në shfrytëzim të pronës komunale, përkatësisht një pjesë të parcelës kadastrale me numër **7090/21**, me sipërfaqe prej **100 m²**, në **Zonën Kadastrale Prishtinë**.

Hapësira e lartcekur është identifikuar si e përshtatshme nga konsulenti i projektit për ndërtimin e një **stacioni shtytës pompues**, i cili do të shërbejë për rregullimin e disniveleit të rrjetit dhe për përmirësimin e furnizimit me energji termike për **lagjen e Muhagjerëve**, si pjesë e zgjerimit të rrjetit të N.P. “Termokos” Sh.A., në kuadër të projektit “Solar4Kosovo II”.

Stacioni shtytës pompues, me përmasa përafërsisht **4.4 m x 4.2 m x 4.0 m**, do të akomodojë pompa, valvula, tubacione dhe pajisje elektrike të domosdoshme për funksionimin e rregullt dhe të sigurt të sistemit të ngrohjes qendrore.

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

N.P. “Termokos” Sh.A. është duke implementuar projektin zhvillimor “Solar4Kosovo II”, i financuar nga institucionet financiare ndërkombëtare **KfW** dhe **BERZH**, si dhe nga vetë N.P. “Termokos” Sh.A. Projekti parashih ndërtimin e një impianti termik diellor dhe integrimin e


tij në sistemin ekzistues të ngrohjes qendrore, duke përfshirë edhe zgjerimin e rrjetit të ngrohjes deri në **50 MW** në disa lagje të qytetit të Prishtinës.

Në kuadër të këtij zgjerimi, është planifikuar edhe përfshirja e **lagjes së Muhagjerëve** në sistemin e ngrohjes qendrore. Për realizimin e këtij qëllimi, është paraparë shfrytëzimi i hapësirës pranë aneksit të shkollës “**Naim Frashëri**”, për ndërtimin e stacionit shtytës pompues.


Andaj, kërkojmë nga **Drejtoria e Pronës** që të na mundësojë shfrytëzimin e kësaj hapësire për qëllime të realizimit të projektit të lartcekur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Bashkëngjitur gjeni edhe **skicën e punuar nga gjeodeti** për parcelën e lartcekur, për të cilën kërkojmë marrjen në shfrytëzim, për nevojat e banorëve të lagjes së Muhagjerëve.

Skica ne DWG (pjesa e pompave e nenvizuar me te kalter)



Lokacioni I stacionit pompues (nenvizuar me te kalter dhe te verdhe):



Sokol.F.Gashi

From: Sevdat Ramaj
Sent: 12 February, 2026 15:59
To: Sokol.F.Gashi
Subject: FW: S4K - Kerkese

Me respekt,

Sevdat Ramaj
Zyrtar i Pasurisë
Drejtoria e Pronës
Komuna e Prishtinës
Tel : +383(0)44 218 509

From: drita.desku@termokos.org <drita.desku@termokos.org>
Sent: Thursday, February 12, 2026 2:36 PM
To: Sevdat Ramaj <Sevdat.Ramaj@rks-gov.net>
Cc: 'naim.bujupi' <naim.bujupi@termokos.org>; 'Fatmir KELMENDI' <f.kelmendi@ic-ces.at>
Subject: FW: S4K - Kerkese

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

I nderuar Sevdat,

Te bashkangjitur meposhte ne email I gjeni kordinatat e derguara nga gjeodeti.

Parcel Number: 07090-23

Building Number: 07090-01-655-0

Coordinates of the required space for the Booster Pump Station_MEM:

Point	Y / East	X / North
1	7513683.554	4724389.834
2	7513675.629	4724390.425
3	7513678.889	4724390.483
4	7513683.277	4724390.156
5	7513679.202	4724394.671
6	7513683.590	4724394.344

Linku per qasje:


[260210 TER BoosterPumpStation MEM Layout coordinates](#)

Me respekt

Drita





Stacioni pomues me linjen transmisionit:



View from the street

Zona Kadastrale Prishtinë
Pjesë e parcelës me nr.7090-21
me sip.18m²



Kordinatat		
Nr	Y	X
1	7513679.202	4724394.671
2	7513683.590	4724394.344
3	7513683.277	4724390.156
4	7513678.889	4724390.483

Lokacioni i kerkuar nga Termokosi per vedndosjen e pompes



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministristvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71914059-07090-21


Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 11-942/03-0020278/26
Data dhe koha e tëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 06.02.2026 - 09:53
Komuna / Opština / Municipality: PRISHTINË / PRISHTINA / PRISHTINE
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Prishtinë / Prishtina / Prishtinë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: PRISHTINË / PRISHTINA / PRISHTINË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-71914059-07090-21	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Prinë shqiptare / Druzhovena Imovina / Socially owned Land	Urban	117277	F44-2004, R.F.P.126/2016	19.12.2016	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
QENDRA SHKOLORE	0		19.12.2016	



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta korisçenja parcelë Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno korisçenje parcelë Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet Class	Sipërfaqja Površina Area	(m ²) (m ²) (m ²)
1	Tokë Tjetër/Ostalo Zemljiste/OtherLand	Jo Pjellore/Neplodno/Unproductive		117277	

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosni adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posëdim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Prishtinës	600340707	///		UÇK	1/1	F44-2004	19.12.2016



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PROPOZIM

Në bazë të nenit 58, shkronjës h të ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr.10/03 prill 2019), nenit 26, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 të Rregullores QRK nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 52 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01.Nr. 110-391, dt. 25.02.2010, dhe kërkesës me nr.13-353/01-20510/26, dt. 06..02..2026, në cilësi të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, me datën: 19.03.2026,

PROPOZOJ

I. Kuvendit të Komunës së Prishtinës, propozim miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, në shfrytëzim N.P “Termokos” Sh.A.

II. Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim, e cekur në pikën I të këtij propozimi, është:

1. Pjesa e parcelës kadastrale me nr. P-71914059-07090-21,në sipërfaqe prej 18.m² .

III.Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është dhënia në shfrytëzim e pronës Komonale e cila është kërkuar nga N.P. “Termokos” Sh.A, për ndërtim te Stacionit pompues për projektin Solar 4 Kosova.

IV.Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është në afat për 10 vite, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike.

V.Prona e paluajtshme e cekur në pikën II të këtij propozimi jepet në shfrytëzim pa kompensim.

VI. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të objektit, do të caktohen me kontratë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit.

VII. Ky propozim hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e marrjes së tij.

A r s y e t i m

N.P. "Termokos" Sh.A, Prishtinë, përmes shkresës me numër 13-353/01-142581/25, të datës 17.09.2025, ka kërkuar nga Drejtoria e Pronës që të procedohet me dërgimin e propozimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, konkretisht:

- pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-71914059-07090-21. Në sipërfaqe prej 18 m².

Në Zonën Kadastrale Prishtinë, për qëllim të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në favor të N.P. "Termokos" Sh.A., Prishtinë.

Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është dhjetë (10) vjet, duke ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste të veçanta. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës do të përcaktohen me kontratë, e cila do të lidhet ndërmjet Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe shfrytëzuesit.

Në bazë të dispozitave ligjore të përmendura në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe dokumentacionit përkatës të lëndës,
u vendos si në dispozitiv të këtij propozimi.

Iu dërgohet:

- Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, dhe
- Qendrës për shërbime me qytetarë.

Kryetari i Komunës

Përparim Rama



Prishtinë, 19.03.2026

Në bazë të Vendimit nr. prot. 630, të datës 17.03.2026, për formimin e Komisionit me qëllim të vlerësimit dhe rishikimit të çmimeve të shërbimeve të varrimit, të paraqitura në Shtojcën A të Rregullores nr. 01.nr.110-67041, dt. 24.03.2014, si dhe në përputhje me nenin 31 të kësaj Rregulloreje, Komisioni ka analizuar nivelin e tarifave në komunat tjera, si dhe faktorët ekonomikë dhe operacionalë që ndikojnë në përcaktimin e tarifave, dhe paraqet këtë:

Propozim-Vlerësim

(për rishikimin e çmimeve të shërbimeve të varrimit)

Komisioni i formuar me nr.prot.630 dt.17.03.2026 në përputhje me detyrat e përcaktuara me vendim, ka shqyrtuar çmimet e shërbimeve të varrimit të përcaktuara në Shtojcën A të Rregullores nr. 01.nr.110-67041, dt. 24.03.2014.

Gjatë shqyrtimit është konstatuar se çmimet aktuale të shërbimeve të varrimit nuk janë rishikuar që nga miratimi i tyre fillestar. Konkretisht, kjo çmimore është miratuar nga Komuna e Prishtinës me vendimin nr. 01.Nr.031-462, të datës 20.09.2006, dhe më pas është pranuar në ndërmarrje me nr. prot. 2087, të datës 22.09.2006. E njëjta çmimore është bartur pa ndryshime dhe i është bashkangjitur edhe Rregullores për varrezat vitit 2014, përkatësisht në Shtojcën A, duke mbetur në fuqi deri më sot.

Si rezultat, konstatohet se çmimet në fjalë nuk janë ndryshuar për një periudhë mbi 19-vjeçare.

- Vlerësimi i çmimeve aktuale

Nga analiza e listës aktuale të çmimeve, komisioni konstaton se:

Çmimet për shërbimet bazë (p.sh. hapja dhe mbyllja e gropes së varrimit – 46.00€ është dukshëm nën nivelin e kostove reale;

Shërbime të tjera si zhvarrosja-57.50€- dhe rezervimi - 55.20€ janë të nënvlerësuara në raport me kompleksitetin dhe resurset e nevojshme;

Nuk ekziston një strukturë e diferencuar tarifore sipas nivelit të shërbimit apo kushteve specifike.

Duke pasur parasysh inflacionin e akumuluar ndër vite, rritjen e pagave dhe kostove operative, këto çmime nuk janë më të qëndrueshme financiarisht.

Komisioni vlerëson se që nga viti 2006, Çmimet e karburantit janë rritur ndjeshëm; Kostoja e fuqisë punëtore është rritur disa herë; Shpenzimet për mirëmbajtje dhe pajisje janë rritur; Inflacioni i përgjithshëm ka ndikuar në të gjitha shërbimet publike.

Si rezultat, ekziston një diferencë e madhe ndërmjet tarifave aktuale dhe kostos reale të ofrimit të shërbimeve.

- Krahasimi me komunat tjera

Në bazë të dokumenteve zyrtare të siguruara nga institucionet e komunave të tjera të Kosovës, të cilat ushtrojnë veprimtari të ngjashme, rezulton se në komunat tjera çmimorja është e caktuar në bazë të marrëveshjeve mes komunës dhe bashkësisë fetare. Në Pishtinë, kjo është çështje tjetër, sepse menaxhimin e varrezave e kryen SHMV-ja, përkatësisht NPL "Gjelbër" Sh.A., kurse shërbimet fetare i kryen bashkësia ose institucioni fetar.

Në bazë të dokumenteve zyrtare të komunave të tjera, rezultatet tregojnë:

- 1. Mitrovicë e Jugut:** Nga çmimorja për shërbimet e varrimit, ku përfshihen të gjitha shërbimet e varrimit së bashku me shërbimet fetare, çmimi total është 250–270 euro.
- 2. Pejë:** Nga çmimorja për shërbimet e varrimit, ku përfshihen të gjitha shërbimet e varrimit së bashku me shërbimet fetare, çmimi total është 250 euro.
- 3. Gjakovë:** Nga të dhënat e siguruara përmes emailit, në këtë rajon çmimi i varrimit është 107–127 euro, pa përfshirë shërbimet fetare.
- 4. Ferizaj:** Bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Ferizajit të vitit 2023, çmimi për shërbimin e varrimit është 320 euro, për të gjithë qytetarët.

Nga analiza shihet se çmimi konkurrues në tregun rajonal varion nga 107 deri në 320 euro, në varësi të përfshirjes së shërbimeve fetare dhe nivelit të shërbimeve të ofruara.

- Faktorët që Ndikojnë në Përcaktimin e Çmimore

Gjatë analizës, Komisioni ka marrë në konsideratë një sërë faktorësh thelbësorë që ndikojnë drejtpërdrejt dhe tërthorazi në përcaktimin e tarifave për shërbimet e varrimit, si në vijim:

- 1. Kostoja operative e ndërmarrjes** – përfshin të gjitha shpenzimet që lidhen me ofrimin e shërbimeve, si: karburanti, mirëmbajtja e automjeteve dhe pajisjeve, pagat dhe përfitimet e personelit, amortizimi i aseteve, si dhe shpenzimet administrative dhe logjistike. Rritja e vazhdueshme e këtyre kostove ka ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të ndërmarrjes.
- 2. Rreziqet e punës në varreza** përfshijnë ekspozim ndaj kushteve të pafavorshme, si kundërmimi i erës së kufomës, rrezikun e infektimit gjatë zhvarrosjes, ekspozimin ndaj kushteve të pakëndshme mjedisore, si dhe ngarkesën emocionale të natyrës së punës. Këta faktorë imponojnë nevojën për masa të shtuara sigurie, pajisje mbrojtëse, trajnim të specializuar dhe kompensim adekuat të stafit.
- 3. Kushtet atmosferike dhe natyra emergjente e shërbimeve:** shërbimet e varrimit ofrohen pa ndërprerje dhe pa mundësi planifikimi të plotë të orarit, duke u realizuar në çdo kohë dhe në kushte

të ndryshme atmosferike, përfshirë reshje, temperatura ekstreme dhe terrene të vështira. Kjo kërkon gatishmëri të vazhdueshme operative, fleksibilitet të stafit dhe angazhim shtesë teknik dhe njerëzor si dhe punë të pandërprerë edhe gjatë vikendit dhe festave zyrtare.

4. Qëndrueshmëria financiare dhe cilësia e shërbimit – përcaktimi i çmimeve duhet të sigurojë jo vetëm mbulimin e kostove, por edhe mundësinë për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve, investime në pajisje dhe zhvillim të kapaciteteve njerëzore.

- Rekomandimi i Komisionit

Duke marrë parasysh analizën e tregut rajonal, rritjen e kostove operative ndër vite, si dhe nevojën për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, Komisioni propozon rishikimin e çmimeve të shërbimeve të varrimit si në vijim:

Nr.	Shërbimet e NPL "Gjelbër" Sh.a	Çmimi Aktual nga viti 2006	Çmimi i propozuar 2026
1	Hapja dhe mbyllja e gropes së varrit	46.00 €	200 €
2	Piramidat informuese për të varrosurin në varreza	59.80 €	78 €
3	Zhvarrosja	57.50 €	750 €
4	Rezervimi i vendit për hapjen e gropes së varrimit	55.20 €	200 €

- Përfundim

Në bazë të analizës së kryer, Komisioni vlerëson se çmimet aktuale të shërbimeve të varrimit janë të vjetruara dhe nuk reflektojnë më realitetin ekonomik dhe kostot faktike të ofrimit të këtyre shërbimeve, pasi çmimet kanë mbetur të pa ndryshuara që nga viti 2006.

Mosrishikimi i tyre për një periudhë mbi 19-vjeçare ka krijuar një mospërputhje të theksuar ndërmjet tarifave ekzistuese dhe shpenzimeve reale operative, duke ndikuar negativisht në qëndrueshmërinë financiare dhe në cilësinë e shërbimeve të ofruara nga njësia e varrezave të NPL "Gjelbër" Sh.a.

Duke marrë parasysh specifikat e Prishtinës si Kryeqytet dhe bazuar në analizën e tregut rajonal, rritjen e kostove operative, faktorët e rrezikut dhe natyrën specifike të shërbimeve si dhe nevojën për përmirësim të cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve

Komisioni rekomandon miratimin e çmimeve të propozuara, si një zgjidhje e balancuar që siguron njëkohësisht përbalueshmërinë për qytetarët e Kryeqytetit dhe qëndrueshmërinë funksionale të ndërmarrjes.

Bazuar në të lartëcekurat i propozojmë Kryetarit të Komunës së Prishtinës që, në përputhje me kompetencat e tij, të bëjë rishikimin e çmimit në fjalë dhe të miratojë çmimet e rekomanduara nga Komisioni i NPL "Gjelbër" Sh.A.

Përgatitur nga Komisioni vlerësues i NPL "Gjelbër" Sh.A:

1. Ilir Miftari – Kryesues

2. Agon Shala - Anëtar

3. Arbërore Azemi – Anëtare

Të i dërgohet:

Kryetari të Komunës së Prishtinës Z.Përparim Rama.

Arkivës



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



RR E G U L L O R E

PËR
MENAXHIMIN E VARREZAVE DHE OBJEKTIT KOMEMORATIV
NË KOMUNËN E PRISHTINËS

Prishtinë, shkurt 2015

Në mbështetje të dispozitave të nenit 12, paragrafi, 12.2, pika c dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika a të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) të neneve 20 dhe 34, paragrafi 34.1, pika c të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 24.06.2014, miratoi këtë

RR E G U L L O R E

PËR MENAXHIMIN E VARREZAVE TË QYTETIT DHE OBJEKTIT KOMEMORATIV TË PRISHTINËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1.

1. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave dhe objektit komemorativ të Prishtinës.
2. Rregullimi, mirëmbajtja e varrezave dhe varrimi, janë veprimtari komunale të interesit të përgjithshëm.

Neni 2.

Asnjë person i vdekur nuk do të mbetet i pavarrosur për shkak të mungesës së rregullativës ligjore, ose procedurave të tjera administrative.

Neni 3.

1. Përgjegjëse për varrosjen e personave të vdekur në varrezat e qytetit, është NPL "Hortikultura" SH.A. (në tekstin e mëtejshëm *shërbimi për menaxhimin e varrezave - SHMV*).
2. Varrosjen e personave të vdekur në fshatra e bëjnë:
 - a) personat të cilët kanë trashëguar një pjesë ose të gjithë pasurinë e personit të vdekur;
 - b) personat të cilët janë të ngarkuar me testament të personit të vdekur;
 - c) të afërmit, sipas renditjes së afërsisë së gjakut, deri në shkallën e katërt;
 - d) të afërmit, sipas renditjes së gjinisë së krushqisë, deri në shkallën e dytë;
 - e) kujdestari, ose institucioni që e ka pasur në përkujdesje;
 - f) i adoptuari ose adoptuesi dhe
 - g) personat që duhet të varrosen në vende të caktuara, sipas vendimit të gjykatës.

II. OFRIMI I SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 4.

Personat e vdekur, të cilët nuk janë të përfshirë sipas nenit 3, do të varrosen nga ndërmarrja për menaxhimin e varrezave - SHMV-ja.

Neni 5.

1. Me ofrimin e shërbimeve të varrimit, nënkuptojmë të gjitha punët që kanë të bëjnë me varrimin e personave të vdekur, siç janë:

- a) caktimi i vendit për varrosjen e kufomës;
- b) leja për të punuar ose rregulluar varrezat;
- c) transporti i personave të vdekur nga vendi ku merret, deri te vendi i varrimit;
- d) hapja e varrit, vendosja e kufomës dhe mbulimi i varrit;
- e) ofrimi i shërbimeve për furnizim me material të nevojshëm për kufomë dhe varrim;
- f) ofrimi i shërbimeve për rregullimin e varrit, gurëve të varrit, pllakave, busteve, përmendoreve dhe simboleve të tjera;
- g) veprime të tjera që kanë të bëjnë me ruajtjen e përkohshme të kufomës në objektin komemorativ ose vende të tjera të posaçme, si dhe rregullimi i kufomës;
- h) procesi i zhvarrimit të eshtrave të mbetur të personave të vdekur më parë, sipas vendimeve meritore, në varrin ose varret e caktuara.

Neni 6.

Varrimi i trupit të personit të vdekur mund të bëhet vetëm në varrin e caktuar për të, sipas planit të varrezave në përdorim dhe sipas renditjes së varreve, të caktuar nga ndërmarrja për menaxhimin e varrezave SHMV-ja.

Neni 7.

Varrezat janë tokat prona të Komunës, të cilat janë të përcaktuara me planin rregullues urban ose me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës për varrimin e personave të vdekur, në të cilat gjenden objektet përcjellëse dhe infrastruktura.

Neni 8.

Punët e shërbimeve të varrimit në qytetin e Prishtinës i kryen SHMV-ja, sipas vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 353 - 44629, të datës 4.12.2012. Në rast se varrimi bëhet me ceremoni fetare, shërbimet e ceremonisë së varrimit (ritet fetare) i kryejnë bashkësitë fetare, në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit me SHMV-në.

Neni 9.

Punët e shërbimeve dhe ceremonisë së varrimit nëpër fshatra i kryen komuniteti i fshatit, përkatësisht të afërmit, por mund ta kryejë edhe SHMV-ja.

1. Varrimi

Neni 10.

Me procesin e varrimit nënkuptojmë:

- a) vendosjen në tokë, në thellësi të caktuar, dhe mbulimin me dhe të trupit të personit të vdekur (kufomës) në lokacionin e varrezave; lejohen edhe mbulesa tjera të varrit, nëse i përmbushin standardet higjienike - sanitare;
- b) vendosjen në tokë dhe mbulimin me dhe të eshtrave të personave të vdekur më parë;
- c) vendosjen në tokë dhe mbulimin me dhe të hirit të kufomës së djegur dhe
- d) thellësia e varrit duhet t'i përmbush standardet higjienike - sanitare, në mënyre që mos të vijë deri te kontamimi i zonës përreth.

Neni 11.

Lejen për varrimin e personit të vdekur të vendbanimit tjetër në varrin e caktuar, e jep SHMV - ja, përkatësisht bashkësia lokale e fshatit, në bashkëpunim me bashkësitë fetare.

Neni 12.

1. Varrimi mund të bëhet vetëm pasi të jetë konstatuar vdekja e personit.
2. Konstatimin e vdekjes së personit mund ta bëjë mjeku ose Instituti i Mjekësisë Ligjore, për raste të caktuara.

Neni 13.

Ndërmarrja për kryerjen e shërbimeve të varrimit duhet të lajmërohet së paku 10 orë para se të bëhet varrimi. Preferohet të lajmërohet menjëherë pas vdekjes së personit.

Neni 14.

SHMV- ja është e obliguar që të sigurojë kryerjen e shërbimeve nga neni 5; pika a, b, c, d, g, h, si dhe personelin e mjaftueshëm për kryerjen e shërbimeve të varrimit, për çdo ditë (edhe ditëve të fundjavave dhe ditëve të festave).

Neni 15.

Varrimi i kufomës (përkatësisht eshtrave të mbetur), parimisht, bëhet në varrezat e vendbanimit të personit të vdekur, për të cilin nuk është i obliguar të nxjerrë leje për varrosje.

Neni 16.

Varrimi i kufomës mund të bëhet edhe në vendin, të cilin personi e ka rezervuar gjatë kohës sa ka qenë i gjallë, ose në vendin ku dëshiron ta varrosë familja e të vdekurit, me pagesën e tarifës për rezervim dhe me leje të organit kompetent për menaxhimin e varrezave.

Neni 17.

Transportin e kufomës (eshtrave të mbetur) mund ta bëjë:

- a) komuniteti fetar i qytetit – fshatit,
- b) ndërmarrja për menaxhimin e varrezave ose
- c) kompania e licencuar.

Neni 18.

Kufoma mund të ruhet në morg deri në kohën e varrimit.

Neni 19.

Deri në momentin e varrimit, kufoma mund të ruhet edhe në xhami, kishë, apo ndonjë objekt tjetër fetar, në kushte të caktuara dhe me lejen e bashkësisë fetare të komunitetit.

Neni 20.

Kufoma e personit të caktuar, me leje të organeve të Komunës, në kohën para varrimit, mund të vendoset në një vend të caktuar për t'i shprehur nderimet ndaj të vdekurit.

Neni 21.

1. Nderimet e fundit ndaj të vdekurit mund të shprehen në sallën për nderimet ndaj të vdekurit (vendi i tubimit), apo pranë varrit të tij.
2. Gjatë varrimit mundë të kryhen ceremonitë fetare që janë në pajtim me rregullat e komunitetit fetar.

Neni 22.

1. Djegia e kufomës ose eshtrave, mund të bëhet vetëm në krematorium.
2. Djegia e kufomës ose eshtrave, bëhet vetëm nëse i vdekuri gjatë jetës ka lënë testament të vlefshëm juridikisht që kufoma e tij të digjet.
3. Djegia e kufomës së personit që ka vdekur në mënyrë jo të natyrshme (rrethana të dyshimta), mund të bëhet vetëm pasi të jetë marrë leja nga organet gjyqësore.

Neni 23.

Hiri i kufomës së djegur duhet të vendoset në enë prej materialit të qëndrueshëm dhe të mbyllur hermetikisht, pastaj mund të mbulohet në varrin e caktuar, ose të vendoset në objekte të caktuara për ruajtje.

Neni 24.

Kufoma ose eshtrat e mbetur të kufom/ës - ave, mund të zhvarrosen dhe të barten në varrin tjetër, vetëm me lejen e organit përgjegjës kompetent qendror ose lokal, si dhe lejen e Inspeksionit sanitar.

2. Varrezat

Neni 25.

1. Varreza mund të ketë çdo vendbanim.
2. Dy ose më shumë vendbanime, mund të kenë varreza të përbashkëta.

Neni 26.

Varrezat e qytetit që janë në përdorim, nevojitet të kenë:

- a) objektin komemorativ, personelin dhe mjetet e punës,
- b) rrethojat e varrezave,
- c) hyrje - daljet e varrezave dhe rrugët, përkatësisht shtigjet për këmbësorë,
- d) hapësira të mjaftueshme për caktimin e vendeve të varrimit.

Neni 27.

Kuvendi i Komunës mund të marrë vendim që:

1. varrezat të mbeten jashtë përdorimit;
2. të ndalohet varrimi i mëtutjeshëm, i përkohshëm ose i përhershëm, i kufomave në varreza të caktuara;
3. sipërfaqja e tokës së varrezave të shpallura jashtë përdorimit, të përdoret për qëllime të tjera sipas planit rregullues urban;
4. pronat e varrezave të përdoren vetëm për qëllime të varrimit;
5. eshtrat e të vdekurve të varrosur në varreza, të zhvarrosen dhe të vendosen në një lokacion të ri, për qëllime të përgjithshme të Komunës apo për shkak të ndryshimeve në planin rregullues urban.

Neni 28.

Organi mbikëqyrës kompetent apo SHMV - ja, në bashkëpunim me bashkësitë fetare, mund ta ndalojë përkohësisht varrimin e kufomave në një pjesë të caktuar të varrezave, nëse konstatohet se nuk ka vend të mjaftueshëm, ose paraqiten pengesa të tjera të varrimit.

Neni 29.

Hapësira që shfrytëzohet për varreza, duhet të ndahet në parcela, sipas planit të nxjerrë nga Komuna, në bashkëpunim me bashkësitë fetare, brenda të cilave do të renditen vendet për varre.

Neni 30.

Varri është vendi ku vendoset dhe mbulohet kufoma ose eshtrat e mbetur të personit të vdekur.

Neni 31.

1. Çmimorja e pagesës për kryerjen e shërbimeve të varrimit dhe shërbimeve të tjera, është në shtojcën A.
2. Shtojca A mund të ndryshohet me vendim të veçant nga Kryetari i Komunës.

3. Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, me vendim të veçantë, do të vendosë për lirim nga pagesa për kryerjen e shërbimeve të varrimit dhe shërbimeve të tjera të caktuara në pikën 1 të këtij neni.

III. RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E VARREZAVE

Neni 32.

Me mirëmbajtje të varrezave nënkuptojmë:

- a) ndërtimin dhe mirëmbajtjen e varrezave, pllakave, përmendoreve etj.;
- b) mirëmbajtjen e gjelbërimit dhe luleve në varreza;
- c) mirëmbajtjen e rrethojës së varrezave;
- d) ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve dhe shtigjeve pranë varrezave;
- e) mbajtjen e pastërtisë në varreza;
- f) mirëmbajtjen e infrastrukturës (rryma, uji, kanalizimi, ndriçimi, objekti etj.);
- g) mirëmbajtjen e objektit komemorativ dhe
- h) pastrimin e shtigjeve dhe largimin e borës dhe akullit nga to.

Neni 33.

Varrezat rregullohen dhe mirëmbahen sipas traditave dhe zakoneve të atij lokaliteti - vendbanimi, që ka të bëjë me respektin dhe nderimet ndaj të vdekurve.

Neni 34.

Përmbajtja ose mesazhi i shenjave, simboleve ose mbishkrimeve që mund të vendosen në gurë të varreve, pllaka përkujtimore ose përmendore, nuk duhet të jetë i tillë që të lëndojë ndjenjat patriotike, fetare ose nacionale të komuniteteve të tjera.

Neni 35.

Ndërtimi, renovimi, ngritja apo heqja e pllakës përkujtimore ose përmendores pranë varrit, duhet të bëhet me lejen e organit kompetent ose të ndërmarrjes publike lokale, sipas normave dhe standardeve.

Neni 36.

Rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave e bën SHMV-ja, por mund ta kryejnë edhe bashkësitë fetare, në bashkëpunim me bashkësitë lokale nëpër fshatra.

Neni 37.

1. Në varreza mund të kryhen edhe punë ndërtimore - vendosja e lapidarit, por me lejen e SHMV-së apo komunitetit nëpër fshatra.
2. Për ndërtime të tjera nevojitet leje nga Drejtoria e Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 38.

Në varreza mund të vendosen lule dhe kurora lulësh, ndërkaq SHMV-ja ose komuniteti i fshatit është i obliguar që t'i largojë lulet e thara dhe mbeturinat e tyre.

Neni 39.

SHMV-ja apo komuniteti në fshatra, ka për obligim që të përkujdeset për mbrojtjen e varrezave nga dëmtimi, rrëzimi apo shkatërrimi i tyre.

Neni 40.

Kuvendi i Komunës, me vendim të veçantë, mund të vendosë për caktimin e lokacionit për varreza të dëshmorëve, veteranëve të luftës ose viktimave civile dhe të merren në përkujdesje.

Neni 41.

Me vendim të organeve kompetente qendrore ose lokale, një ose disa varre mund të shpallen si monumente kulturore ose historike me rëndësi të veçantë dhe të merren në përkujdesje.

Neni 42.

Evidencën dhe shënime të tjera për varreza, varrime, varre të posaçme, objekte përkujtimore, përmendore, pllaka përkujtimore, shërbime për varrosjen e personave të vdekur, numrin e tyre, renditjen dhe shënime të tjera, i mbanë SHMV - ja ose komuniteti i fshatit.

Neni 43.

Vizitorët e varrezave janë të obliguar që në lokalitetin e varrezave, të sillen në mënyrë korrekte, me qëllim dhe në shenjë nderimi dhe respekti ndaj të vdekurve.

Neni 44.

Fëmijët nën moshën 10 vjeç kanë të drejtë të marrin pjesë në varrime ose të vizitojnë varrezat, vetëm në përcjellje të personave të rritur.

Neni 45.

1. SHMV-ja dhe komuniteti fetar vendosin orarin se kur mund të vizitohen varrezat.
2. SHMV-ja mund të marrë vendim të arsyetuar për ndërprerjen e përkohshme të vizitave në varreza.

Neni 46.

Në varreza është e ndaluar:

- a) të nxirren nga varri kufomat jashtë normave të përcaktuara me ligj;
- b) varrimi i personave të vdekur në hapësirat publike ose hapësira të tjera pa leje;
- c) të dëmtohen, vidhen, keqpërdoren ose shkatërrohen varret, gurët e varrezave, shenjat, simbolet, pllakat përkujtimore, përmendoret, objektet përcjellëse, rrethojat, mjetet e punës etj.;
- d) prishja e qetësisë shpirtërore, siç është: gjestet që nuk kanë të bëjnë me ceremoni varrimi;
- e) hyja në objektin komemorativ pa lejen e SHMV-së;
- f) kryerja e punëve të ndryshme pa leje;

- g) kërkimi i lëmoshës brenda hapësirës së varrezave;
- h) dëmtimi ose shkatërrimi i gjelbërimit, siç janë: fidanët e mbjellë, lulet, gjelbërimi i ulët, bari etj.;
- i) mbjellja e fidanëve ose lule pa lejen e SHMV-së ose komunitetit të fshatit;
- j) futja e shtazëve ose shpezëve shtëpiake brenda lokacionit të varrezave, me qëllim të shfrytëzimit të kullosës dhe
- k) hedhja e mbeturinave në lokacionin e varrezave.

IV. OBJEKTI KOMEMORATIV

Neni 47.

1. Shfrytëzimi dhe menaxhimi i objektit komemorativ, në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës, i është besuar SHMV-së.
2. Destinimi i objektit është i përcaktuar me projektin në bazë të cilit është ndërtuar, pa të drejtë tjetërsimi te personi i tretë.
3. Mënyra dhe kushtet tjera më të përafërta të shfrytëzimit dhe menaxhimit të këtij objekti, do të përcaktohen me marrëveshje të veçantë të lidhur në mes të Komunës dhe SHMV-së.

Neni 48.

1. Në objektin komemorativ mund të kryhen këto shërbime:
 - a) pastrimi i kufomave,
 - b) ruajtja e kufomave për kohë të caktuar,
 - c) shfrytëzimi i hapësirave për ngushëllime nga qytetarët që nuk kanë lokacion tjetër për këtë qëllim.

V. FINANCIMI

Neni 49.

Shpenzimet për kryerjen e shërbimeve të varrimit i bartin personat përgjegjës për varrosje, sipas neneve 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje.

Neni 50.

1. SHMV-ja do të financohet nga shërbimet që i kryejnë qytetarët dhe institucionet.
2. Komuniteti (fetar) nëpër fshatra, mjetet financiare për rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave i sigurojnë prej shërbimeve të varrimit që iu kryhen qytetarëve.
3. Mjetet financiare për rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve dhe varrezave përkujtimore, sigurohen nga buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës.

VI. MBIKËQYRJA

Neni 51.

1. Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset DSHPMSH-ja.
2. Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të kësaj rregulloreje do ta bëjë Inspeksioni komunal i Drejtorisë së Inspeksionit.

Neni 52.

Për të metat e paraqitura lidhur me zbatimin e kësaj rregulloreje, Inspeksioni komunal është i obliguar që të marrë këto masa:

- a) Varrimi i kufomave të bëhet sipas normave sanitare, duke respektuar ligjin dhe këtë rregullore, në përputhje me rregullat dhe zakonet e komunitetit fetar;
- b) Të përcjellë dhe të marrë masa adekuate për realizimin e planit për rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave;
- c) Të urdhërojë kryerjen e punëve dhe detyrave të caktuara nga aspekti i rregullimit, mirëmbajtjes së varrezave ose respektimit të rregullave ose procedurave të caktuara për varrim;
- d) Të ndalojë përkohësisht varrimin e kufomave për arsye sanitare, obduksionit të kufomës, identifikimit, procedurës gjyqësore, fatkeqësive në komunikacion ose fatkeqësive elementare natyrore, trazirave publike etj.;
- e) Të urdhërojë që, për shkak të parregullsive ose pengesave të ndryshme, varrimi të kryhet përkohësisht në një pjesë të caktuar të varrezave;
- f) Që punëkryesi të ndërpres punën në heqjen ose vendosjen e pllakës përkujtimore ose ndonjë objekt tjetër, nëse nuk kryhet sipas normave dhe rregullave të parapara, ose të urdhërojë që kjo punë të bëhet sipas rregullave dhe standardeve;
- g) Të shqiptojë masa ndëshkuese (gjoba) ndaj personave që bien në kundërshtim me ligjin dhe këtë rregullore.

7. MASAT NDËSHKIMORE

Neni 53.

1. Personi juridik (SHMV), i cili bie në kundërshtim me pikat **a - m** të nenit 46 dhe nenit 54, do të gjobitet për kundërvajtje me gjobë prej 300 - 1000 €.
2. Personi fizik i cili bie në kundërshtim me pikat **a - m** të nenit 46, do të gjobitet për kundërvajtje me gjobë prej 200 - 500 €.
3. Personi fizik i cili bie në kundërshtim me nenet 22, 34, 35 dhe pikën **f** të nenit 52, do të gjobitet me gjobë 50 - 150 €, të cilën e shqipton Inspeksionin komunal, ndërsa personi juridik në rast se vepron në kundërshtim me nenet 39 dhe 42 të kësaj rregulloreje, gjobitet me gjobë prej 300 €.

III. DISPOZITAT KALIMTARE, SHFUQIZUESE DHE TË FUNDIT

Neni 54.

1. SHMV-ja nxjerr orarin për vizitat dhe aktivitetet të tjera në varreza.
2. SHMV-ja ose komuniteti nëpër fshatra, është i obliguar rregullat dhe orarin ta shkruajnë dhe ta vendosin në hyrje të varrezave, në vend të dukshëm për vizitorët.

Neni 55.

Çdo gjë tjetër që nuk është paraparë me këtë rregullore, Kuvendi i Komunës mund ta rregullojë me vendim të veçantë, të cilin e zbaton SHMV-ja, në bashkëpunim me DSHPMSH-në dhe Inspeksionin komunal të Drejtorisë së Inspeksionit.

Neni 56.

Në të gjitha rastet kur kjo rregullore bie në kundërshtim me ligjet në fuqi, do të zbatohet ligji në fuqi.

Neni 57.

Është obligim i çdo qytetari të komunës së Prishtinës, që të respektojë rregullat e kësaj rregulloreje, që me punën dhe sjelljet e tij të mos bie në kundërshtim me rregullat e kësaj rregulloreje.

Neni 58.

1. SHMV-ja duhet të kryejë shërbimet në harmoni me ligjin dhe Rregulloren komunale për menaxhimin e varrezave dhe objektit komemorativ, dhe nuk lejohet tejkalimi i kompetencave të veprimtarisë që është paraparë me këtë rregullore.

2. Në rastet e tejkalimit të kompetencave ose keq menaxhimit, ndaj SHMV-së duhet të pasojë gjoba sipas raportit të Inspeksionit komunal, e që është deri në 1000 €, dhe në rastet e përsëritjes, do të pasojë shkëputja e njëanshme e kontratës.

Neni 59.

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për sigurimin dhe mirëmbajtjen e varrezave 01. nr. 352 - 157/1, dt. 30.5.2006.

Neni 60.

Kjo rregullore hynë në fuqi 8 ditë pas publikimit të saj në tabelën e shpalljeve dhe ueb - faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 110 - 67041, më 24.03.2014

KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.

SHTOJCA A:

1. Çmimorja e pagesës për kryerjen e shërbimeve të varrimit dhe shërbimeve të tjera, e ofruar nga SHMV-ja është si më poshtë:

a) Hapja dhe mbyllja e gropës së varrimit	46.00 €;
b) Bartja e kufomës në lokal	11.50 €;
c) Transporti i jashtëm i qytetit për çdo km të kaluar	0.57 €;
ç) Piramidat informuese për të varrosurin në varreza	59.80 €;
d) Bartja e kufomës me vendim të gjykatës	28.75 €;
dh) Arkivoli	69.00 €;
e) Zhvarrosja	57.50 €;
ë) Rezervimi i vendit për hapjen e gropës së varrimit	55.20 €.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008"), nenit 21 të Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/2019"), nenit 5, paragrafi 1, pika 1.2, lidhur me nenin 24 dhe nenin 25 të Rregullores (QRK), nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë, me nr. prot. 01-887 të datës 5.5.2025, nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më _____, merr këtë

VENDIM

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës për rastet e veçanta.

1. Miratohet vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për “Muzeun e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë Luftës në Kosovë”, i themeluar dhe menaxhuar nga “Fondacioni Jahjaga”.
2. Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim sipas pikës 1 të këtij vendimi është:
3. Objekti në pronësi të Komunës së Prishtinës, nr. 6343-1-29-0, i ndërtuar në parcelën me numër kadastral: P-71914059-06343-0, e cila evidentohet në emër të PSH, KK Prishtina ½ dhe PSH ZAD, në hapësirën prej 183,66 m², e cila hapësirë ndahet nga hapësirat e tërësishme të objektit.
4. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, bëhet me qëllim të garantimit të funksionimit të “Muzeut të të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale Gjatë Luftës në Kosovë”, i cili është themeluar dhe menaxhuar nga “Fondacioni Jahjaga”.
5. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, është për periudhën afatshkurtër 15 vjet (pesëmbëdhjetë vjet).
6. Prona e paluajtshme sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, i jepet “Muzeut të të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë Luftës në Kosovë”, i themeluar dhe menaxhuar nga “Fondacioni Jahjaga”, pa kompensim.

7. Prona e paluajtshme sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi e dhënë në shfrytëzim, nuk e ndërron titullarin juridik dhe pronare e objektit mbetet Komuna e Prishtinës, e cila pronë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
8. Autorizohet Kryetari i Komunës që të përcaktojë me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësisë e Komunës së Prishtinës dhe “Fondacionit Jahjaga”.
9. Obligohet Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës të bëjë evidentimin në librat kadastralë të Komunës, pronën e paluajtshme të dhënë në shfrytëzim për rastet e veçanta, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi.
10. Ky Vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të Komunës;
- Drejtorisë e Kadastrit;
- Ministrisë së Drejtësisë;
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe
- Qendrës për shërbim me qytetarë.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Nr. prot. _____

Data: ____/____/2026

Për: Kryesuesin dhe Anëtarët e Kuvendit të Kryeqytetit

Lënda: Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për rastet e veçanta, për “Muzeun e të Mbijetuarave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës në Kosovë”, sipas kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë

I nderuar Kryesues,

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Kryeqytetit,

Në përputhje me përgjegjësitë ligjore po ju adresoj kërkesën për shqyrtim dhe miratimin për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim për rastet e veçanta, sipas kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë për “Muzeun e të Mbijetuarave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës në Kosovë”, i themeluar dhe menaxhuar nga “Fondacioni Jahjaga”. Kjo nismë që ka marrë përkrahje të plotë institucionale nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës, e cila është prezantuar përmes kërkesës zyrtare nr. 01-882, datë 05.05.2025, adresuar Komunës së Prishtinës.

Ky muze përfaqëson një nga iniciativat më të rëndësishme të drejtësisë tranzicionale dhe kujtesës kolektive në vendin tonë, dhe synon të ofrojë një hapësirë publike të qëndrueshme për fuqizimin e të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës, si dhe për edukimin e brezave të rinj për të kaluarën historike dhe vlerave të drejtësisë dhe dinjitetit njerëzor.

Korniza ligjore: Kërkesa për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës mbështetet në në dispozitat ligjore si vijon:

- Neni 21 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, që mundëson dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për rastet e veçanta;
- Nenin 24 i Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për Procedurat për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i cili rregullon rastet e veçanta të dhënies në shfrytëzim për interes të përgjithshëm publik.

Duke iu referuar legjislacionit në fuqi, në veçanti dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për Procedurat për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Ministria e

Drejtësisë ka paraqitur kërkesën zyrtare nr. 01-882, datë 05.05.2025, drejtuar Komunës së Prishtinës, për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për rastet e veçanta për “Muzeun e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë Luftës në Kosovë”.

Arsyetimi i kërkesës: Në cilësinë e Kryetarit të Kryeqytetit dhe duke vepruar në përputhje me nenin 25 të Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për Procedurat për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, pas pranimit të kërkesës zyrtare nga Ministria e Drejtësisë për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për rast të veçantë për “Muzeun e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë Luftës në Kosovë” i cili është themeluar dhe menaxhohet nga “Fondacioni Jahjaga”, e adresoj këtë kërkesë për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Kryeqytetit.

“Muzeu i të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë Luftës në Kosovë”, do të jetë një hapësirë që:

- Ruan kujtesën kolektive dhe dëshmitë autentike të të mbijetuarve;
- Shërben si vend edukimi për të rinjtë dhe qytetarët mbi pasojat e dhunës, luftës dhe padrejtësisë;
- Përforcon angazhimin e institucioneve për të drejtat e njeriut;
- Promovon vlerat demokratike dhe përpjekjet për drejtësi e pajtim të qëndrueshëm.

Duke marrë parasysh se dhuna seksuale gjatë luftës në Kosovë ka qenë një ndër format më çnjerëzore të dhunës ndaj popullsisë civile gjatë luftës, dhe se mijëra gra e burra u bënë viktime të saj, është detyrim institucional të kontribuojmë në ruajtjen e së vërtetës historike dhe në ofrimin e hapësirave që përforcojnë drejtësinë dhe respektin për të mbijetuarit, si mesazh i fuqishëm i përkushtimit ndaj së vërtetës dhe kujdesit ndaj të mbijetuarve.

Prandaj, ofrimi i mbështetjes sonë përbën një veprim konkret të përgjegjësisë publike, duke i dhënë kuptim parimeve të solidaritetit, respektit për viktimat dhe ndërtimit të një shoqërie që përballë me dinjitet padrejtësitë historike.

Së bashku me këtë kërkesë, bashkëngjitur i përcjellë për shqyrtim edhe materialet përcjellëse të kërkuara sipas rregullores, përfshirë:


- Dokumentacionin pronësor të pronës komunale;
- Kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë me arsyetimin për interes të përgjithshëm publik;
- Projekt-vendimin për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi i Kryeqytetit.

Me besim në përkrahjen tuaj dhe me konsideratë të lartë për rëndësinë e kësaj nisme, ju ftoj t’a mbështesim këtë kërkesë dhe t’a konkretizojmë përkushtimin tonë institucional ndaj drejtësisë shoqërore dhe kujtesës historike.

Me Respekt,

Përparim RAMA

Kryetar i Komunës së Prishtinës



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice
Kabineti i Ministres të Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Datë: 05/05/2025

Për: z. Përparim Rama
Kryetar i Komunës së Prishtinës

Lënda: Kërkesë për përkrahje për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për Muzeun e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë Luftës në Kosovë

I nderuar Kryetar z. Rama,

Duke marrë parasysh rëndësinë e përkrahjes dhe mbështetjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë dhe me qëllim të ruajtjes së historisë kombëtare që pasqyron të vërtetën, ju drejtohem me këtë kërkesë për përkrahje për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për Muzeun e të Mbijetuarëve të Dhunës Seksuale gjatë Luftës në Kosovë, i cili është themeluar dhe menaxhohet nga Fondacioni Jahjaga.

Muzeu i të Mbijetuarëve të Dhunës Seksuale gjatë Luftës në Kosovë përfaqëson një iniciativë jetike me rëndësi të thellë për interesin publik dhe adreson nevojën urgjente për edukim, ruajtje të historisë dhe shërim shoqëror në Kosovë. Ky muze do të shërbejë si një platformë e fuqishme për rrëfim të së vërtetës, duke ofruar një paraqitje autentike dhe dinjitoze të përvojave të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.

Përmes ngritjes së vetëdijes dhe promovimit të një kuptimi më të thellë të ndikimit afatgjatë të dhunës seksuale, muzeu do të kontribuojë ndjeshëm në edukimin publik dhe dialogun qytetar. Ai do të sfidojë stigmën, do të nxisë ndjeshmëri dhe do të angazhojë të gjitha gjeneratat në luftën e vazhdueshme kundër dhunës me bazë gjinore.

Gjithashtu, muzeu përveç se luan një rol thelbësor në ruajtjen e historisë kombëtare, do të sigurojë që zërat e të mbijetuarve të dokumentohen, të respektohen dhe të mos harrohen, duke pasuruar kujtesën kolektive dhe narrativën historike të Kosovës. Kështu, forcon bazën për drejtësi dhe pajtim afatgjatë.

Në thelb, ky muze nuk është vetëm një hapësirë për kujtim, por një mjet transformues, që edukon publikun, nderon të mbijetuarat/it dhe kontribuon në vlerat demokratike dhe parimet e të drejtave të njeriut që janë thelbësore për të ardhmen e Kosovës.

Kërkesa bazohet në Nenin 21 të Ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Nenin 24 të Rregullores (QRK) - Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Me respekt,

Pes
Albulena HAXHIU

Ministre në detyrë e Drejtësisë

Alba Hondozi

From: Alba Hondozi
Sent: Tuesday, April 29, 2025 1:57 PM
To: Alba Hondozi
Subject: FW: Kërkesë - Fondacioni Jahjaga

From: Egzona Bexheti <egzona@jahjagafoundation.org>
Sent: Friday, March 28, 2025 11:40 AM
To: Anita Kalanderi <Anita.Kalanderi@rks-gov.net>
Subject: Kërkesë - Fondacioni Jahjaga

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

E nderuar Anita,

Shpresoj që kjo email t'ju gjejë mirë.

Në emër të themelueses dhe kryesues të Bordit, Presidentes Jahjaga si dhe të Fondacionit Jahjaga, dëshiroj t'ju shpreh mirënjohjen tonë të sinqertë për takimin e djeshëm dhe gadishmërinë për mbështetjen tuaj. E vlerësojmë shumë mundësinë për të diskutuar përpjekjet dhe vizionin tonë për Muzeun e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë Luftës në Kosovë.

Siç ju njoftuam, Fondacioni Jahjaga me një lejepëlqim nga Drejtoria për Shërbime Publike, Komuna e Prishtinës, është vendosur në hapësirat e NPL Sport Marketing, Rruga Sylejman Vokshi, Nr.21, pronë kjo e Komunës së Prishtinës.

Në Nëntor të vitit 2024 në të njejtat hapësira ne kemi lancuar edhe muzeun, duke pasur parasysh rëndësinë e mbikëqyrjes së duhur të muzeut dhe menaxhimit nga ana e Fondacionit Jahjaga per disa vite, dëshirojmë të kërkojmë zyrtarisht mbështetjen tuaj për sigurimin e hapësirës për një periudhë më të gjatë, duke pasur parasysh angazhimin tonë të përbashkët në këtë kauzë. Konkretisht, shpresojmë të marrim në përdorim këto hapësira për një periudhë 15-vjeçare, në mënyrë që të ruajmë dhe mbrojmë këtë ambient të rëndësishëm, i cili i kushtohet historive dhe kujtesës së të mbijetuarve.

Do të ishim shumë mirënjohës për shqyrtimin e kësaj kërkesë dhe presim udhëzimet tuaja për hapat e mëtejshëm.

Ju falënderojmë edhe një herë për kohën dhe mbështetjen tuaj.

Me respekt,

Egzona

Drejtoreshë Ekzekutive / Executive Director
Fondacioni Jahjaga/ Jahjaga Foundation
Add. RR. " Sylejman Vokshi" . Nr.21, Prishtinë

